



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 27 regjistër (JR)
Datë 18.07.2024

Nr. 26 i vendimit
Datë 03.04.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

- shpalli në seancë gjyqësore publike, më datë 03.04.2025, ditën e enjte, në orën 09:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Arjela Vllaçaj, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 27/2024 (JR), datë 18.07.2024, që i përket:

ANKUESE: Komisionerja Publike Irena Nino.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 754, datë 05.04.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Mishgjoni.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtoi pretendimet e ngritura në ankim nga Komisionerja Publike Irena Nino, si dhe parashtrimet e bisedimet përfundimtare të paraqitura nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme Altin Dumani, të cilët kërkuan ndryshimin e vendimit nr. 754, datë 05.04.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Mishgjoni, shqyrtoi parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, e cila, përfundimisht, kërkoi lënien në fuqi të

vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Mirela Mishgjoni (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë dhe, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “AKSIK”) dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).

2.1. ILDKPKI-ja, në zbatim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi kreu procedurën e kontrollit të hollësishëm të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar pranë Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë¹, me konstatimet se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive*; (iii) *ka mosdeklarim të pasurisë ndër vite*; (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

2.2. AKSIK-u, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pas përfundimit të procedurave të kryera nga Grupi i Punës për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, në raportin e përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 22.09.2023, të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Mirela Mishgjoni*.

2.3. KLGj-ja, pas rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura, sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport² të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, me vendimin nr. 754, datë 05.04.2024, në bazë të nenit 4, pika 2, nenit 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pasi konkludoi se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, vendosi: *Konfirmimin në*

¹ ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 03.03.2021, ka përcjellë në Komision, “Aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Mirela Mishgjoni, me funksion gjyqtare, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë”.

² KLGj-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 17.12.2019, ka përcjellë në Komision “Raportin për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Mirela Mishgjoni”.

detyrë të subjektit të rivlerësimit Mirela Mishgjoni, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

4. Komisioni e ka mbështetur vendimin e mësipërm në konkluzionet e arritura mbi të tria kriteret e rivlerësimit, duke konkluduar për secilin prej tyre, si vijon.

4.1. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë³: Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën e rivlerësimit pasuritë e saj dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të saj. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit Mirela Mishgjoni nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohesh parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Mirela Mishgjoni ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

4.2. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës⁴: Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni i rezulton se subjekti i rivlerësimit Mirela Mishgjoni arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

4.3. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale⁵: Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLGj-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit. Në përfundim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

5. Komisionerja Publike Irena Nino (në vijim “Komisionerja Publike”), në mbështetje të rekomandimit⁶ për paraqitje të ankimit, nënshkruar nga tri vëzhgues ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim “ONM”), ka paraqitur ankimin nr. {***}

³ Paragrafi 50 i vendimit të Komisionit.

⁴ Paragrafi 57 i vendimit të Komisionit.

⁵ Paragrafët 68-69 të vendimit të Komisionit.

⁶ Ankimi i KP-së dhe Rekomandimi i ONM-së nr. {***} prot., datë 28.06.2024, në faqen zyrtare në internet të KP-së: <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://ikp.al/wp-content/uploads/2024/07/Ankim-kund%C3%ABr-vendimit-nr.-754-dat%C3%AB-5.04.2024-t%C3%AB-KPK-s%C3%AB-p%C3%AB-sr-znj.-Mirela-MishgjoniRekomandim-p%C3%ABr-vendimin-e-KPK-s%C3%AB.pdf>

prot., datë 10.07.2024, kundër vendimit nr. 754, datë 05.04.2024, të Komisionit, i cili konfirmoi në detyrë subjektin e rivlerësimit, znj. Mirela Mishgjoni.

5.1. Në pretendimet e parashtruara në ankim, Komisionerja Publike ka kundërshtuar vendimin e Komisionit në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, pasi nga shqyrtimi i vendimit të Komisionit dhe akteve shoqëruese të tij ka konstatuar se ky vendim është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'iu paraqitur juridiksionit kontrollues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”).

5.2. Komisionerja Publike ka konsideruar se vendimi i Komisionit nuk është në pajtueshmëri të plotë me gjendjen e fakteve dhe provave të administruara në fashikull, për krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë, në kuptim të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

Bazuar në nenet Ç, D, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, Kreun VI, nenin 4, pika 2, si dhe nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, Komisionerja Publike ka kërkuar që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, të vendosë: *Ndryshimin e vendimit nr. 754, datë 05.04.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Mirela Mishgjoni.*

6. Shkaqet e ankimit të Komisioneres Publike paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

6.1. Për pasurisë “apartament me sipërfaqe 111,6 m², në Vlorë”, subjekti i rivlerësimit edhe pas kalimit të barrës së provës nuk arriti të provojë të kundërtën, lidhur me pamundësinë financiare për kryerjen e pagesave për blerjen e kësaj pasurie, duke u gjendur në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi:

6.1.1. Komisioni në mënyrë të gabuar ka marrë në konsideratë të ardhurat e përfituara nga z. B. V. nga shitja e shoqërisë “{***}” S.N.C., ndërkohë që rezulton se detyrimet tatimore lidhur me këto të ardhura kanë nisur të paguhesh me vonë dhe për efekt të procesit të rivlerësimit dhe, si të tilla, nuk duhet të përfshihen në analizën financiare.

6.1.2. Nga punësimi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në Itali, rezulton se të ardhurat e llogaritura nga Komisioni janë në vlerën 67.319 euro, të cilat përveçse, sikurse dhe vetë Komisioni ka arsyetuar, nuk përfaqësojnë të ardhurën *neto*, janë të ndryshme dhe nga të ardhurat e bashkëshortit, sipas vërtetimit të Institutit Kombëtar të Sigurimeve Shoqërore të shtetit italian, që rezultojnë në vlerën 36.822 euro.

6.1.3. Të ardhurat e personit të lidhur nga aktiviteti “ristorator”, gjatë periudhës 2005-2011, deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në shumën rreth 5.400.000 lekë, nuk duhet të përfshihen në analizën financiare.

6.1.4. Të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga personi i lidhur, nga aktmarrëveshja e shitjes së pjesës takuese në fabrikën e përpunimit të ullirit në Vlorë, nuk duhet të përfshihen në analizën financiare dhe nuk duhen marrë në konsideratë në vlerësim tërësor.

6.2. Për pasurinë “likuiditetet në *cash*”, subjekti i rivlerësimit, edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme.

6.3. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me shumën 17.000 euro dhënë hua znj. E. G. dhe si rezultat ka kryer deklaram të pasaktë dhe të

pamjaftueshëm të pasurisë automjet tip “Daimler Chrysler C270 CDI”, të deklaruar me burim krijimi kthimin e kësaj huaje.

6.4. Pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme e konstatuar nga vetë Komisioni, por e konsideruar pa efekt penalizues në këtë proces, afekton jo vetëm kursimet *cash*, por edhe pasuritë e tjera të krijuara deri në vitin 2009, përfshirë edhe huan në shumën 3.000.000 lekë, deklaruar si burime krijimi për pasurisë “apartament me sipërfaqe ndërtimi 134,5 m², ndodhur në Tiranë”.

6.5. Për pasuritë “tokë bujqësore “arë””, në pronësi të personit të lidhur, rrethanat e konstatuara lidhur me këto pasuri e vendosin subjektin e rivlerësimit para një deklarimi të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe në kushtet e konfliktit të interesit, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

6.6. Komisioni nuk ka administruar akte të tjera në drejtim të vlerësimit të aktivitetit të një organizate jofitimprurëse, në të cilën bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit është në cilësinë e anëtarit themelues.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

7. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, që ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisioneres Publike, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

b) Legjitimimi i ankuesit

8. Komisionerja Publike legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

9. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për të garantuar zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, çështja objekt gjykimi u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, në prani të palëve, të cilat u zhvilluan në datat 13.03.2025, 19.03.2025 dhe 03.04.2025. Trupi gjykues i Kolegjit, për shkak të mbarimit të mandatit kushtetues të Komisionerëve Publikë, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe nenit 199/2 të Kodit të Procedurës Civile, në seancën gjyqësore publike të datës 13.03.2025, vendosi kalimin procedural të palës “Komisionerët Publikë” te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

9.1. Në seancën gjyqësore publike të datës 13.03.2025, në vijim të kërkesës së subjektit të rivlerësimit për marrjen në cilësinë e provës të akteve shpresore të depozituara së bashku me

parashtrimet e saj⁷, pasi dëgjoi edhe Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme lidhur me këtë kërkesë, në bazë të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 45 dhe 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të lejojë marrjen e tyre në cilësinë e provës, për sa ato lidheshin me shkaqet e ankimit dhe nevojën e subjektit të rivlerësimit për t'i prapësuar, në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë. Këto akte iu nënshtruan debatit gjyqësor dhe u vlerësuan nga Kolegji në raport me vendimin objekt shqyrtimi dhe shkaqet e ankimit të Komisioneres Publike.

9.2. Në seancën gjyqësore publike të datës 19.03.2025, në konkluzionet përfundimtare, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke u qëndruar shkaqeve të ankimit të Komisioneres Publike, kërkoi nga Kolegji ndryshimin e vendimit nr. 754, datë 05.04.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Mishgjoni. Subjekti i rivlerësimit, në konkluzionet përfundimtare, i kërkoi Kolegjit lënien në fuqi të vendimit të sipërcituar.

10. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues vlerësoi shkaqet e ngritura në ankimin e Komisioneres Publike, qëndrimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe subjektit të rivlerësimit në parashtrime dhe konkluzionet përfundimtare, si dhe analizoi e vlerësoi të gjitha provat që gjendeshin në dosjen e hetimit administrativ të Komisionit, si dhe ato të cilat u morën gjatë procesit gjyqësor në Kolegj, duke arsyetuar e konkluduar si vijon.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit në lidhje me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

11. Komisionerja Publike, bazuar dhe në rekomandimin e ONM-së, ka parashtruar shkakun e ankimit që i adresohet kontrollit të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë “apartament me sipërfaqe 111,6 m², në Vlorë”, duke pretenduar se *subjekti i rivlerësimit, edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk arriti të provojë të kundërtën, lidhur me pamundësinë financiare për kryerjen e pagesave për blerjen e kësaj pasurie, duke u gjendur në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.*
12. Trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”) konstatoi se aktet në dosjen gjyqësore për pasurinë “apartament me sipërfaqe 111,6 m², në Vlorë”, paraqesin situatën faktike, sa më poshtë.

12.1. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar: *Apartament banimi me sipërfaqe 111,6 m², (120,7 m²), ndodhur në lagjen “{***}”, Vlorë, blerë më 03.05.2006. Vlera: 60.000 euro. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: Të ardhura nga aktiviteti si shef kuzhine i bashkëshortit dhe aktiviteti si avokate i deklarueses.*

12.2. Të njëjtin deklaram, subjekti i rivlerësimit e ka bërë edhe në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, dorëzuar në ILDKPKI në datën 05.03.2009⁸.

12.3. Origjina e pasurisë “apartament” regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë (në vijim “ZVRPP”), më datë 14.10.2013, në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe z. B. V., në pjesë takuese 50%, rrjedh nga kontrata e kaparit nr. {***} rep.,

⁷ Aktet shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Mirela Mishgjoni, me parashtrimet, në datat 06.03.2025 dhe 11.03.2025, përveç vendimeve të Këshillit të Ministrave që mund të aksesohen drejtpërdrejt nga burime të hapura nga vetë trupi gjykues.

⁸ Deklarim i bërë nga subjekti i rivlerësimit pas rikthimit në detyrën e gjyqtarës.

nr. {***} kol., datë 03.05.2006, lidhur ndërmjet shoqërisë "{***}" ShPK dhe subjektit të rivlerësimit dhe kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.10.2013, e lidhur ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe z. B. V. në cilësinë e palës blerëse dhe shoqërisë "{***}" ShPK në cilësinë e palës shitëse, në shumën 60.000 euro.

Në kontratën e shitblerjes së apartamentit, në paragrafin me titull "Çmimi dhe mënyra e pagesës" përcaktohet se pagesat për blerjen e kësaj pasurie janë likuiduar nga pala blerëse, me këste, si më poshtë.

Kësti i parë në shumën 25.000 euro është likuiduar nëpërmjet Bankës Popullore më datë 22.12.2005 (referuar mandatin bankar të Bankës Popullore, datë 22.12.2005, me derdhje *cash* të shumës së sipërcituar nga subjekti i rivlerësimit për llogari të shoqërisë "{***}" ShPK., me përshkrimin "Pagesë për prenotim apartamenti");

Kësti i dytë në shumën 10.000 euro është likuiduar nëpërmjet Bankës Popullore, më datë 03.05.2006 (referuar mandatin bankar të Bankës Popullore, datë 03.05.2006, me derdhje *cash* të shumës së sipërcituar nga subjekti i rivlerësimit për llogari të shoqërisë "{***}" ShPK., me përshkrimin "Pagesë për prenotim apartamenti");

Kësti i tretë në shumën 19.000 euro është likuiduar nëpërmjet Bankës Popullore më datë 23.08.2006 (referuar mandatin bankar të Bankës Popullore, datë 23.08.2006, me derdhje *cash* të shumës së sipërcituar nga subjekti i rivlerësimit për llogari të shoqërisë "{***}" ShPK., me përshkrimin "Pagesë kësti i tretë");

Kësti i katërt në shumën 4.864 euro është likuiduar me pagesë në *cash* në arkën e shoqërisë "{***}" ShPK, më datë 05.06.2007 (referuar mandatar-këtimin nr. {***}, datë 05.06.2007, me përshkrimin "Kësti i fundit").

Diferenca e mbetur në shumën 1.136 euro është likuiduar me këste të vogla për kryerje punimesh (referuar citimit në kontratën në fjalë).

13. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ për pasurisë objekt kontrolli, ka arsyetuar në vendim⁹ se: *Komisioni ka kryer një analizë financiare për blerjen e apartamentit nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, nga ku rezulton se kanë pasur pamundësi në kryerjen e pagesave të apartamentit me të ardhura të ligjshme në vlerën (-) 3.626.738 lekë. [...] Komisioni çmon se në vlerësimin e tij lidhur me pasojat e diferencës negative në krijimin e kësaj pasurie merr në konsideratë faktin se burimi i krijimit të saj janë të ardhurat e personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit, të cilat edhe pse nuk kalojnë testin e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nuk mund të jenë penalizuese në procesin e rivlerësimit të subjektit, pasi janë krijuar kohë më parë se ata të fillonin jetën bashkëshortore, janë të ardhura të provuara nëpërmjet akteve noteriale, nuk janë produkt i një veprimtarie të paligjshme, si dhe subjekti nuk ka qenë në dijeni të përdorimit të të ardhurave, për të cilat nuk ishin shlyer detyrimet tatimore. Për pasojë, kjo pamundësi do të vlerësohet në vlerësimin tërësor të pasurisë. [...] Në mungesë të ndonjë të dhëne që të bën të dyshosh se subjekti i vlerësimit me deklarin e të ardhurave të tilla ka synuar të mashtrojë organet e rivlerësimit ose ka deklaruar qëllimisht ndryshe në mënyrë të rreme, trupi gjykues çmon se pasuria e deklaruar ka si burim të ardhurat e bashkëshortit, të krijuara kohë më parë se ata të fillonin bashkëjetesën ligjore. Këto të ardhura rezultojnë nga burime të ligjshme, të dokumentuara me akte juridike dhe transaksione bankare, ku i vetmi element që nuk përmbush kushtet e nenit D, pika 3, është pagesa e tatimeve gjatë procesit të rivlerësimit. Kjo situatë faktike nuk është e drejtë të konsiderohet si një mangësi apo defekt, i cili të prodhojë pasojë për subjektin e rivlerësimit, vendosjen e masës së*

⁹ Paragrafët 29.12.1-29.13 dhe 43-44, të vendimit të Komisionit.

shkarkimit të tij nga detyra. Kjo mangësi, duke qenë se është e vetmja e konstatuar lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit dhe, e vendosur në kontekstin e mësipërm, nuk vlerësohet se mund të prodhojë në mënyrë proporcionale vendosjen e masës së shkarkimit nga detyra, si një masë e nevojshme për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj për rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. [...] Në përfundim, për sa më sipër, Komisioni çmon se mungesa e burimeve të ligjshme që rezulton nga analiza financiare e kryer, duke mos përfshirë të ardhurat e bashkëshortit nga shitja në vitin 2004 të shoqërisë “{***}”, nuk duhet të konsiderohet si një rrethanë që e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

14. Komisionerja Publike, në ankim¹⁰, ka kundërshtuar si të pabazuar arsyetimin dhe konkluzionin e mësipërm të Komisionit, pasi vëren se pasuritë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, dorëzuar në ILDKPKI në datën 05.03.2009, janë krijuar gjatë bashkëjetesës së saj me personin e lidhur, ndërkohë që kishte ushtruar për disa vite funksionin e gjyqtarës.

14.1. Komisionerja Publike, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni në vendimin e tij, ndan qëndrim të ndryshëm dhe vlerëson se pamjaftueshmëria e rezultuar nga analiza financiare, bën që subjekti të mos arrijë një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, për efekt të këtij procesi. Komisionerja Publike vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe pas kalimit të barrës së provës nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme të konstatuar nga Komisioni, me pretendimin se për pasurinë “apartament me sipërfaqe 111,6 m², në Vlorë” (në vijim “pasuria apartament”) nuk duhen konsideruar si burime të ligjshme për efekt të procesit të rivlerësimit të subjektit:

- (i) të ardhurat e personit të lidhur nga shitja e shoqërisë “{***}” S.N.C., në Itali;
- (ii) të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit si ristorator për periudhën 2005-2011;
- (iii) të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur nga marrëveshja nr. {***} rep., datë 01.02.1997, për shitjen e pjesës takuese në fabrikën e përpunimit të ullirit, Vlorë, pasi këto të ardhura nuk përmbushin kriteret e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës; dhe
- (iv) të ardhurat e personit të lidhur nga paga në emigracion në Itali, pasi nuk rezulton mundësi kursimi nga këto të ardhura.

15. Trupi gjykues, fillimisht, mori në analizë pretendimin e Komisioneres Publike, që kundërshton argumentin në të cilin Komisioni ka mbështetur tërësinë e konkluzioneve të arritura në vendim, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

15.1. Komisionerja Publike, në ankim, ka pretenduar se pasuritë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, dorëzuar në ILDKPKI, në datën 05.03.2009, janë krijuar gjatë bashkëjetesës së saj me personin e lidhur, ndërkohë që kishte ushtruar për disa vite funksionin e gjyqtarës.

15.2. Të njëjtin qëndrim mbajti edhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare.

15.3. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në prapësimin e shkakut të ankimit dhe qëndrimit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, parashtroi se nga ankuesit pretendohet të

¹⁰ Paragrafi 15.19 i ankimit të Komisioneres Publike.

mos përfshihet në analizën financiare një shumë e konsiderueshme të ardhurash, të krijuara nga personi i lidhur, kryesisht gjatë periudhës 1996-2004, periudhë në të cilën nuk ka qenë e martuar, por nuk ka bashkëjetuar, pasi personi i lidhur, deri në vitin 2005, ka qenë në Itali. Këto të ardhura, sipas subjektit të rivlerësimit, janë përfituar nga personi i lidhur në mënyrë të ligjshme dhe provohen me dokumentacion të kohës. Periudha në të cilën personi i lidhur i ka realizuar këto të ardhura ka qenë përtej kohës kur ai dhe subjekti ishin në bashkësi ligjore, si dhe kur ata vepronin në autonomi të plotë financiare. Gjithashtu, këto të ardhura, por edhe pasuritë objekt ankimi, janë krijuar në një kohë kur subjekti i rivlerësimit nuk ushtronte detyrën e gjyqtarës dhe në një kohë shumë më të vonshme se ndërprerja e detyrës së gjyqtarës në vitin 2002. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se gjatë gjykimit në Kolegj nuk u ngritën dyshime lidhur me krijimin e këtyre të ardhurave nga personi i lidhur nga aktivitete të kundërligjshme, për pasojë ajo nuk ka qenë në kushtet e dijenisë dhe pranimi të përdorimit të të ardhurave të tilla, situatë kjo që do bënte të cenueshëm besimin e publikut. Sipas subjektit të rivlerësimit, vetëm pagesa me vonesë e detyrimeve tatimore, si i vetmi ves i të ardhurave të personit të lidhur, nuk është e mjaftueshme, si shkak objektiv dhe proporcional për të ngarkuar drejtpërdrejt atë me masë disiplinore.

15.4. Në analizë të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues, nga aktet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, konstatoi se:

15.4.1. Subjekti i rivlerësimit, në periudhën 1995–2002 ka punuar si ndihmëse gjyqtare dhe gjyqtare. Në vitin 2002, me vendimin nr. {***}, datë 15.07.2002, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Prej vitit 2002, subjekti i rivlerësimit ka ndjekur procedurat e ankimit të vendimit të sipërcituar në Gjykatën e Lartë, Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në përfundim të të cilave në datën 28.02.2009 ka filluar të ushtrojë sërish detyrën e gjyqtarës, si dhe ka përfituar me vendim gjyqësor pagat si gjyqtare për periudhën 12.01.2002 – 01.03.2009;

15.4.2. Në përgjigje të pyetësorit standard të drejtuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nga viti 2005 e në vijim kam jetuar me bashkëshortin B. V. dhe shpenzimet e jetesës kanë qenë kontribut i përbashkët;

15.4.3. Të ardhurat e realizuara nga personi i lidhur për periudhën 1996 – 2004, një pjesë e të cilave kanë vijuar të përfitohen edhe në vitet në vijim deri në vitin 2008, janë deklaruar si burim kryesor i financimit të pasurive të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit. Gjithashtu, si burim krijimi të këtyre pasurive, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar dhe kursimet e saj nga paga si gjyqtare [para dhe pas rikthimit në detyrë], si dhe të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit të avokatisë.

- 16.** Faktet e mësipërme, trupi gjykues i lexoi dhe shqyrtoi në harmoni me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur në deklaratën e rivlerësimit dhe deklaratën e interesave para fillimit të detyrës¹¹, si dhe me parashikimet e nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 e 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, të cilët përcaktojnë detyrimin e subjektit të rivlerësimit për justifikimin e të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e pasurive. Nën dritën e këtyre parashikimeve, si dhe të jurisprudencës së Kolegjit¹², trupi gjykues arsyeton se objekt i kontrollit në funksion të këtij procesi janë të gjitha pasuritë e burimet e krijimit të

¹¹ Deklarim i bërë nga subjekti i rivlerësimit pas rikthimit në detyrën e gjyqtarës.

¹² Shih vendimin e Kolegjit nr. 2/2019 (JR), datë 04.02.2019, paragrafi 34; vendimin nr. 11/2022 (JR), datë 27.04.2022, paragrafët 30.8-30.9; vendimin nr. 19/2023 (JR), datë 26.04.2023, paragrafët 66-68; vendimin nr. 20/2023 (JR), datë 03.05.2023, paragrafi 17.2; etj.

tyre të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të e të deklaruar si të tilla në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit. Gjithashtu, trupi gjykues nënvizon se, në mbështetje të kuadrit ligjor të sipërcituar, nevoja për verifikimin dhe kontrollin e pasurisë dhe të burimit të krijimit të saj shtrihet në kohë edhe përpara qenies në detyrën e magjistratit. Kuadri ligjor për vlerësimin e pasurisë nuk kufizon as kohën dhe as cilësinë që subjektet e rivlerësimit kanë pasur në momentin e krijimit të tyre.

16.1. Sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se organet e rivlerësimit kanë qenë krejtësisht të legjitimuar të kontrollojnë pasuritë në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, si dhe burimet financiare të krijimit të tyre, në përmbushje të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore që normojnë procesin e rivlerësimit.

- 17.** Lidhur me pretendimin e Komisioneres Publike, sipas së cilit të ardhurat e z. B. V. nga shitja e shoqërisë “{***}” S.N.C. në Itali, nuk duhet të përfshihen në analizën financiare, trupi gjykues konstatoi dhe analizoi si më poshtë.

17.1. Komisioni, në vendim¹³, në verifikim dhe kontroll të burimeve financiare të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e pasurisë “apartament”, ka arsyetuar se: [...] *Trupi gjykues çmon se në rastin konkret këto të ardhura nuk i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Por, pavarësisht kësaj, në analizë të vlerësimit të mësipërm, në mungesë të keqbesimit të bashkëshortit, kohës së gjatë të krijimit të këtyre të ardhurave, para lidhjes së martesës, si dhe mungesës së keqbesimit nga ana e subjektit, pavarësisht se ato nuk mund të përfshihen në analizën financiare, trupi gjykues çmon se duhet të vlerësohen jopenalizuese në procesin e rivlerësimit të subjektit, pavarësisht vlerës së këtyre të ardhurave. Këto fakte do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit.*

17.2. Komisionerja Publike, në ankim, ka kundërshtuar arsyetimin dhe konkluzionin si më sipër, me pretendimin se Komisioni në mënyrë të gabuar ka marrë në konsideratë të ardhurat e përfituara nga z. B. V. nga shitja e shoqërisë “{***}” S.N.C., ndërkohë që rezulton se detyrimet tatimore lidhur me këto të ardhura kanë nisur të paguhen me vonesë dhe për efekt të procesit të rivlerësimit dhe, si të tilla, nuk duhet të përfshihen në analizën financiare.

17.3. Gjatë gjykimit në Kolegj, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, në mbështetje dhe në vijim të pretendimit të Komisioneres Publike, shtoi se këto të ardhura nuk duhet të përfshihen në analizën financiare, pasi një pjesë e tyre janë përfituar pas kryerjes së pagesave të pasurisë “apartament” e, si të tilla, nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi për shlyerjen e këtyre pagesave, si dhe nuk u provua pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nga shitja e shoqërisë “{***}” S.N.C., bashkëshorti i saj ka përfituar 80% të vlerës së shitjes.

17.4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, kundërshtoi shkakun e ankimit të Komisioneres Publike të konfirmuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke mbajtur të njëjtin qëndrim si në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë në vëmendje të Kolegjit se provohet me dokumentacion të plotë ligjor dhe justifikues se personi i lidhur i ka krijuar këto të ardhura, ndërsa sa i përket detyrimeve tatimore, në kontratën e shitjes së restorantit në Itali, qartësohet se këto detyrime janë paguar

¹³ Paragrafi 29.7 i vendimit të Komisionit.

dhe në këto kushte personi i lidhur nuk kishte si të dinte që ato nuk ishin paguar. Këto detyrime nuk i janë komunikuar personit të lidhur në shtetin italian dhe nga ana e institucioneve tatimore të këtij shteti nuk është ndërmarrë asnjë veprim për të ekzekutuar këtë detyrim. Gjatë procesit të rivlerësimit, personi i lidhur është paraqitur për të marrë një konfirmim nga ana e organeve tatimore të shtetit italian, nga ka rezultuar se kishte një detyrim tatimor të papaguar, si dhe kamatëvonesa. Sapo është vënë në dijeni të këtij detyrimi, bashkëshorti i saj ka lidhur një marrëveshje me shtetin italian për shlyerjen me këste të këtyre detyrimeve. Të gjitha këto fakte provojnë që personi i lidhur nuk ka qenë në keqbesim. Për rrjedhojë, pagesa e detyrimeve tatimore me vonesë nuk mund të konsiderohet si shmangie nga shlyerja e këtyre detyrimeve. Për më tepër, pagesa e detyrimeve tatimore në shtetin italian nuk i përket juridiksionit të rivlerësimit, për sa kohë bëhet fjalë për tatime në një shtet tjetër, të cilat, për më tepër, nuk shuhet asnjëherë. Këto rrethana, sipas subjektit të rivlerësimit, dëshmojnë se ajo nuk gjendet në asnjë nga kushtet e parashikuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe, për sa më sipër, të ardhurat e personit të lidhur duhet të përfshihen në analizën financiare, pasi rezultojnë të provuara që ato janë përfituar prej tij. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar që këto të ardhura duhet të konsiderohen në vlerën 80% të vlerës së shitjes së aktivitetit, e provuar kjo me deklaratimet përpara noterit të z. B., por edhe me mandatet e tërheqjes së kambialeve nga personi i lidhur, të cilat qartësojnë se ai ka përfituar këtë vlerë. Pavarësisht se shoqëria është krijuar me kontribut të barabartë të dy ortakëve B. dhe V., gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit, personi i lidhur veçoi edhe në cilësinë e shefit të kuzhinës, impenjim ky që ishte dhe faktori i rritjes së vlerës së biznesit, si dhe nuk paguhej me pagë mujore, rrethana këto që justifikuan përfitimin e vlerës më të madhe nga shitja e aktivitetit. Përfitimi i kësaj shumës prej 80% të vlerës së shitjes së shoqërisë, sipas subjektit të rivlerësimit, vërtetohet nga konfirmimi i këtij fakti nga z. B. përpara noterit publik, si dhe nga kambialet e paraqitura, sipas së cilave z. V. ka përfituar shumën prej 33.045 euro që korrespondon me vlerën 80% të shumës totale të kambialeve në vlerën 41.573 euro. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni u provua se të ardhurat e përfituara nga shitja e shoqërisë “{***}” S.N.C. plotësojnë kërkesat e ligjit për t’u konsideruar të ardhura të ligjshme në kuadër të këtij procesi dhe 80% e tyre duhet të përfshihen si të ardhura të ligjshme të përfituara nga personi i lidhur.

18. Trupi gjykues analizoi faktet dhe rrethanat e konstatuara gjatë hetimit administrativ në Komision, lidhur me të ardhurat objekt kontrolli, sipas së cilave rezultoi si më poshtë.

18.1. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, personi i lidhur, z. B. V., ka deklaruar: *Të ardhura nga emigracioni në Itali 1992-2005, të ardhura të siguruara nga punësimi në mënyrë të ligjshme, punësimi si punonjës i pasiguar, si dhe nga shitja e një restoranti në Itali në vitin 2004. Vlera: rreth 123.000 euro.*

Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, dorëzuar në ILDKPKI, në datë 05.03.2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Bashkëshorti B. V., të ardhura nga kambialet. Janar - 06.02.2009. Vlera: 1.385,76 euro.*

Në të njëjtin formular deklarimi, z. B. V. ka deklaruar: *Kursime dhe kambiale. Vlera: 70.000 euro. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i krijimit: Të ardhura nga aktiviteti privat dhe shitja e një restoranti të ndodhur në Itali.* Ndërsa në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, në lidhje me pasurinë “Kursime dhe kambiale”, z. B. V. ka referuar se bashkëlidhur deklaratës gjendet fotokopje e dokumentit të noterizuar: *“Datë 15.07.2004. Noter L. Z., {***}, Firenze, Itali. Monte dei Paschi di Siena”.*

18.2. Në përgjigje të pyetjeve të drejtuara nga Komisioni në pyetësin nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: Kontributi im në krijimin e kësaj pasurie (apartamenti në Vlorë) është 11.000 euro, ndërsa investimi i bashkëshortit është 49.000 euro. [...] Bashkëshorti B. V. ka jetuar në Itali, gjatë periudhës 1992-2005. Bashkëshorti ka qenë dhe vazhdon të jetë me profesion shef kuzhine dhe në vitin 2002, së bashku me shtetasin V. B., ka krijuar shoqërinë “{***}” S.N.C., me objekt të ushtrimit të aktivitetit “restaurant”, në {***}, Itali. Sipas dokumentacionit dhe marrëveshjes mes tyre, shoqëria ka pasur kapital në vlerën 2.000 euro. Pjesa takuese e secilit prej ortakëve ka qenë 50%. [...] Në datën 30.09.2002, kanë blerë nga shoqëria “{***}” S.A.S., në shumën 87.798 euro, aktivitetin, licencat dhe pajisjet e kësaj shoqërie me objekt ushtrimi të aktivitetit “restaurant”, me vendndodhje në {***}, Itali. Sipas kontratës, pagesa e kësaj shume do të kryhej me 50 kështe mujore, duke filluar nga data 24.01.2003. Në vitin 2004, bashkëshorti kishte vendosur të kthehej në Shqipëri dhe, si rrjedhojë, ka vendosur të shiste aktivitetin. [...] Në datën 15.07.2004, është realizuar kontrata përfundimtare e shitjes ndërmjet B. V. dhe V. B., ortakë të shoqërisë “{***}” S.N.C. dhe shtetasit V. D., ortak i shoqërisë “{***}” S.A.S. Në këtë kontratë është përcaktuar, që pasi është kryer pagesa e shumës 68.427 euro në favor të shoqërisë “{***}” S.A.S. (shuma e mbetur e pashlyer ortakëve të shoqërisë “{***}” S.A.S. nga shuma e blerjes prej 87.798 euro), pagesë e kryer sipas përcaktimeve të kontratës paraprake të shitjes, vlera përfundimtare e shitjes së aktivitetit, licencave përkatëse dhe pajisjeve është përcaktuar 135.000 euro, nga të cilat 41.573 euro do të paguheshin gjatë periudhës 14.07.2004-30.09.2009, nëpërmjet urdhërshirimeve, në vlerën 1.385,76 euro secili urdhërshirim, ndërsa pjesa tjetër u është dorëzuar shitësve. [...] Ndarja e të ardhurave të realizuara nga shitja u ra dakord që 80% t’i shkonte bashkëshortit dhe 20% ortakut tjetër.

Mënyra e likuidimit të saj ka qenë si më poshtë: Në momentin e shitjes, në vitin 2004, ortaku i bashkëshortit, shtetasi V. B. mori 27.000 euro dhe bashkëshorti B. V. mori 66.427 euro. Pjesën e mbetur prej 41.573 eurosh e ka marrë bashkëshorti im gjatë periudhës 2004-2009, nëpërmjet urdhërshirimeve (kambialeve) me vlerën 1.385 euro secili urdhërshirim.

18.3. Në përgjigje të kërkesës së drejtuar nga Komisioni, në pyetësin nr. 3, për të depozituar dokumentacion provues, në lidhje me përfitimin prej z. B. V., të 80% të vlerës së kontratës së shitjes së shoqërisë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: Në funksion të dokumentimit të mëtejshëm të këtij fakti i jam drejtuar noterit që ka përpiluar kontratën e shitjes në Itali, institucioneve bankare ku ka kaluar shuma e shitjes në Itali, si dhe Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë ku ka qenë e regjistruar shoqëria blerëse [...]. Nga faturë shitje e shoqërisë “{***}” S.N.C. te shoqëria “{***}” S.A.S., kontrata e shitblerjes nr. {***}, datë 15.07.2004, vënë në dispozicion nga noteri L. Z., [...] rezulton se shuma e shitjes prej 93.427 eurosh ka kaluar automatikisht brenda 80 ditëve nga data 15.07.2004, nga llogaria bankare e shoqërisë blerëse, llogaria nr. {***}, e ndodhur në Bankën Unicrediti, agjencia {***}, në llogarinë bankare të shoqërisë “{***}” S.N.C. me nr. {***}, e hapur pranë Cassa di Risparmio di Firenze S.P.A., {***}. Për shumën 41.573 euro është rënë dakord të paguhet me kambiale mujore gjatë periudhës 15.09.2004-15.08.2009. [...] Nga certifikata historike e të dhënave identifikuese të shoqërisë “{***}” S.A.S. [...] nxjerrë nga regjistri i sipërmarrjeve të Dhomës së Tregtisë, Industrisë, Artizanatit dhe Agrikulturës, {***}, Itali [...]; nga ekstrakti historik i shoqërisë blerëse [...] dhe nga certifikata historike e të dhënave identifikuese të shoqërisë blerëse, nxjerrë nga regjistri i sipërmarrjeve të Dhomës së Tregtisë, Industrisë, Artizanatit dhe Agrikulturës, {***}, Itali, [...], rezulton se kjo shoqëri ka deklaruar blerjen e shoqërisë “{***}” S.N.C., [...],

me kontratën e shitblerjes nr. {***}, datë 15.07.2004, përpiluar nga noteri L. Z., ka ushtruar aktivitet [...] dhe është regjistruar përfundimisht si shoqëri në vitin 2015, për rrjedhojë e patëm të pamundur të merrnim dokumentacion nga kjo shoqëri. Nga kërkesa për vënien në dispozicion të ekstrakteve të llogarisë bankare të shoqërisë “{***}” S.N.C., nga kërkesa për vënien në dispozicion të ekstrakteve të llogarisë bankare të z. B. V., rezulton se institucionet bankare e kanë të pamundur vënien në dispozicion të ekstrakteve të llogarive bankare [...], për shkak të kalimit të afatit 10-vjeçar të ruajtjes së dokumenteve të kërkuara [...].

18.4. Në pyetësin nr. 6, Komisioni i ka kërkuar subjektin të rivlerësimit të paraqesë dokumentacionin provues për pagimin nga bashkëshorti i saj, të detyrimeve tatimore që rridhnin nga shitja e shoqërisë “{***}” S.N.C., në Itali. Në përgjigje të kësaj kërkesë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: [...] Ju informoj se bashkëshorti ka realizuar një marrëveshje me Agjencinë e Tatimeve për pagesën e detyrimit me këste, detyrim i cili nuk ka përfunduar së shlyeri. Kësti i radhës është shlyer në datën 17.11.2023.

19. Në analizë të fakteve dhe rrethanave të konstatuara si më sipër, në raport me shkakun e ankimit të Komisioneres Publike, qëndrimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në mbështetje të këtij shkakut dhe prapësimeve të subjektin të rivlerësimit për to, trupi gjykues vëren si më poshtë.

19.1. Në referim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer si burim financiar krijimi për pasuritë e deklaruara. Në këtë kuadër, trupi gjykues, në kuptim të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, analizoi fillimisht pretendimin e subjektin të rivlerësimit se shuma e të ardhurave të përfituara nga z. B. V., nga shitja e shoqërisë “{***}” S.N.C., ka qenë në vlerën prej 108.000 eurosh, duke konsideruar në harmoni rrethanat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ në Komision, si vijon.

19.1.1. Shuma prej 108.000 eurosh, sipas pretendimit të subjektin të rivlerësimit, përfaqëson të ardhurën e përfituar nga bashkëshorti i saj si pjesë takuese e 80% të vlerës së shitjes së aktivitetit “restorant”, në shumën prej 135.000 eurosh, paguar nga z. V. D., përfaqësues i shoqërisë blerëse “{***}” S.A.S., kundrejt z. V. B. dhe z. B. V., ortakë të shoqërisë “{***}” S.N.C. Veprimi juridik i shitjes së aktivitetit “restorant” është provuar me anë të aktit “Pranimi dhe transferimi i shoqërisë” nr. {***} rep., datë 15.07.2004¹⁴, nënshkruar nga palët e sipërcituara¹⁵ në prani të noterit L. Z., në {***}, Firenze. Sipas përmbajtjes së këtij akti, ortakët dhe përfaqësuesit e shoqërisë “{***}” S.N.C. i shesin ortakut të përgjithshëm dhe përfaqësuesit

¹⁴ Gjithashtu, veprimi juridik i shitjes provohet edhe nga të dhënat identifikuese në sistemin elektronik të regjistrimit të sipërmarrjeve të Dhomës së Tregtisë, Industrisë, Artizanatit dhe Agrikulturës, {***}, Itali, për shoqërinë “{***}” S.A.S. di V. D., si dhe nga të dhënat e sistemit elektronik të regjistrimit të sipërmarrjeve të Dhomës së Tregtisë, Industrisë, Artizanatit dhe Agrikulturës, {***}, Itali, lidhur me certifikatën historike të së njëjtës shoqëri, nga të cilat rezulton se është regjistruar në regjistrin e sipërmarrjeve, si ortak i përgjithshëm i shoqërisë, z. V. D., më datë 12.01.2004 dhe në datën 16.07.2004 ka hapur njësinë vendore restorant në {***}, sipas regjistrimit në Dhomën e Tregtisë në {***}.

¹⁵ Palët në këtë aktmarrëveshje janë edhe shtetasit Sh. Y., Zh. L., Zh. Y., X. Y., ish-ortakë të shoqërisë “{***}” S.A.S., të cilët deklarojnë se i kanë shitur shoqërisë “{***}” di B. V. e V. B. S.N.C. aktivitetin restorant, në {***}, Itali, me aktin noterial nr. {***}, datë 30.09.2002, dhe çmimi i këtij transferimi ishte caktuar gjithsej 87.798 euro, për t’u paguar me 50 kambiale me skadencë mujore të njëpasnjëshme, duke filluar nga data 24.01.2003. Ish-ortakët e shoqërisë “{***}” S.A.S. deklarojnë se e kanë marrë të gjithë çmimin për shitjen e aktivitetit dhe për këtë arsye lëshojnë një faturë të plotë dhe përfundimtare për bilancin e të gjithë çmimit të lartpërmendur dhe pranojnë se pasuria dhe e drejta e shoqërisë e transferuar me aktin e datës 30.09.2002, i kaloi përfundimisht shoqërisë “{***}” di B. V. e V. B. S.N.C., ndaj së cilës nuk kanë më asnjë pretendim.

ligjor të shoqërisë “{***}” S.A.S. pronësinë e plotë aktuale të shoqërisë, në lidhje me aktivitetin “restaurant”, për të cilin kanë licencat dhe autorizimet e dhëna nga Bashkia {***}, në Itali. Përveç lejeve dhe licencave të mësipërme, transferimi përfshinte emrin e mirë dhe pajisjet, sipas një liste bashkëlidhur këtij akti, duke përjashtuar shprehimisht të gjitha kreditë dhe debitimet e shoqërisë, të cilat mbetën në favor dhe në ngarkim të palës shitëse. Çmimi i shitjes është dakordësuar në shumën prej 135.000 eurosh, nga të cilat: 41.537 euro për emrin e mirë dhe 93.427 euro për pajisjet, çmim që do të paguhej si vijon: 25.000 euro, jo më vonë se 50 ditë nga data 15.07.2004 dhe 68.427 euro jo më vonë se 50 ditë nga data e nënshkrimit të këtij akti. Shuma 41.573 euro do të paguhej përmes kambialeve prej 1.385,76 euro secili, i pari skadonte në datën 15.09.2004 dhe i fundit më 15.08.2009. Sa i përket shumës prej 93.427 eurosh, sipas parashikimeve në aktin e shitjes së aktivitetit, ajo do të paguhej nga shoqëria blerëse brenda afatit 50-ditor nga data 15.07.2004, në llogarinë e shoqërisë “{***}” S.N.C., pranë institucionit bankar Cassa di Risparmio di Firenze S.P.A., {***}, Itali. Efektet juridike dhe ekonomike të këtij transferimi, ashtu siç palët kanë rënë dakord, ishin parashikuar të fillonin më datë 16.07.2004.

19.1.2. Ortaku tjetër në këtë aktivitet, z. V. B., në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.03.2023, pasi përshkruan veprimet juridike të kryera për shitjen e shoqërisë “{***}” S.N.C., ka deklaruar se vlera përfundimtare e shitjes prej 135.000 eurosh është ndarë me dakordësi dhe pa pasur pretendime, z. B. V. në masën 80% dhe ai vetë (z. V. B.) në masën 20%, pasi kontributi i ortakut B. V., falë kapaciteteve të tij si shef kuzhine, dominonte. Z. B. deklaron, gjithashtu, se me marrjen prej tij të vlerës prej 27.000 eurosh si pjesë takuese në vlerë monetare të përfituar nga shitja dhe pas likuidimit prej blerësve të vlerës monetare prej 108.000 eurosh kundrejt z. B. V., ortakëria mes këtij të fundit dhe deklaruesit mori fund dhe ata nuk kanë pasur asnjë pretendim ndaj njëri-tjetrit, për sa i përket përfitimeve nga kjo shoqëri. Në këtë deklaratë, z. B. nuk ka specifikuar kohën se kur ka marrë pjesën e tij takuese prej 27.000 eurosh, por vetë subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të drejtuar nga Komisioni, ka saktësuar këtë moment, duke deklaruar se mënyra e likuidimit të shumës prej 135.000 eurosh nga pala blerëse ka qenë si vijon: në momentin e shitjes, në vitin 2004, ortaku i bashkëshortit, shtetasi V. B. mori 27.000 euro dhe personi i lidhur mori 66.427 euro. Pjesa e mbetur prej 41.573 eurosh është marrë nga personi i lidhur gjatë periudhës 2004-2009, nëpërmjet urdhër xhirimeve (*kambialeve*) me vlerën 1.385 euro secili urdhër xhirim.

19.1.3. Nga verifikimi i formularit të deklaratës së të ardhurave të vitit 2004 të z. V., modeli UNICO, dorëzuar në Agjencinë e Tatimeve të {***}, Itali¹⁶, trupi gjykues vëren se të ardhurat totale të deklaruara nga z. V. për këtë vit kanë qenë në shumën 25.404 euro *bruto*, nga të cilat 23.867 euro janë cilësuar si *të ardhura nga shoqëritë që ushtrojnë veprimtari biznesi* dhe konkretisht nga shoqëria “{***}” S.N.C.”¹⁷. Për rrjedhojë, z. B. V. ka deklaruar për organet tatimore italiane si shumë të përfituar nga shitja e shoqërisë vetëm shumën prej 23.867 eurosh.

¹⁶ Subjekti i rivlerësimit, në datën 19.12.2023, ka depozituar në Komision, ndër të tjera, edhe deklaratat e të ardhurave të z. B. V., lëshuar në datën 01.12.2023 nga Agjencia e Tatimeve të {***}, Itali, për secilin vit tatimor të periudhës 1998-2005, ddokumentacion i paraqitur në formën e kërkuar nga ligji, i legalizuar me vulë apostille, i përkthyer dhe i noterizuar.

¹⁷ Nga deklarata e të ardhurave të z. B. V., formati UNICO, për vitin 2004, rezultoi se të ardhurat totale të z. V. për këtë vit kanë qenë në shumën 25.404 euro bruto, nga të cilat shuma prej 23.867 eurosh është cilësuar si “Të ardhura nga shoqëritë që ushtrojnë veprimtari biznesi”. Gjithashtu, në të njëjtën rubrikë të deklaratës, e emërtuar “Forma RH”, është evidentuar kodi tatimor i shoqërisë, i cili i përket shoqërisë “{***}” di B. V. e V. B. S.N.C., si dhe kuota e pjesëmarrjes 50% e z. V. në këtë shoqëri.

Në fund të deklaratës, detyrimi tatimor për t'u paguar është evidentuar nga autoritetet italiane, në shumën 5.857 euro.

19.1.4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë zhvillimit të hetimit administrativ në Komision, ka paraqitur dokumentin - printim i datës 19.11.2023, nga sistemi elektronik i Agjencisë së Tatimeve të shtetit italian dhe kartelën e situatës debitore të z. B. V., sipas së cilës, ai është debitor për vitin 2004. Referuar të dhënave të kartelës, është parashikuar shlyerja e detyrimit tatimor me këste. Për të provuar shlyerjen e kështit të parë të këtij detyrimi, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur gjatë hetimit administrativ në Komision, një faturë pagese *Postpay*, datë 17.11.2023, në shumën 234,51 euro, kundrejt Agjencisë Italiane të Tatimeve.

19.1.5. Sa i përket pagesës prej shoqërisë blerëse “{***}” S.A.S., të shumës prej 41.573 eurosh, e cila sipas parashikimit kontraktor të aktit “Pranimi dhe transferimi i shoqërisë” nr. {***} rep., datë 15.07.2004, do të paguhej përmes urdhër xhirimeve (*kambialeve*) prej 1.385,76 euro secili, gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në cilësinë e provës urdhër xhirime (*kambiale*) dhe ekstrakte të llogarisë bankare të z. B. V., në bankën Monte dei Paschi di Siena, në Itali, nga të cilat rezultoi se vlera e urdhër xhirimeve të transferuara në llogarinë e z. V. pranë kësaj banke, për periudhën 2006-2008, është në shumën totale prej 21.959 eurosh. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur, gjithashtu, edhe aktin “Fletë garancie nr. {***}, datë 14.07.2004”, e lëshuar nga shoqëria {***} S.P.A., shoqëri ndërmjetësimi financiar, nga të dhënat e të cilit rezulton se shoqëria blerëse “{***} S.A.S.” garantonte pagesën e vlerës 41.573 euro tek ortakët e shoqërisë shitëse “{***}” S.N.C., përgjatë periudhës 14.07.2004-30.09.2009, e cila përbënte pagesën për emrin e mirë të restorantit të blerë. Bashkëlidhur fletë garancisë janë përcjellë kopje të 8 (tetë) urdhër xhirimeve të lëshuara në datën 15.07.2004, secila prej tyre në shumën 1.385,76 euro, të cilat bëheshin të vlefshme për tërheqje pranë Unicredit Bank, në Itali, duke filluar nga data 15.06.2008 deri në datën 15.08.2009.

19.2. Në analizë të të dhënave që u renditën më lart, trupi gjykues vlerësoi se, megjithëse përmes aktit noterial “Pranimi dhe transferimi i shoqërisë” nr. {***} rep., datë 15.07.2004, subjekti i rivlerësimit provoi veprimin juridik të shitjes së shoqërisë “{***}” S.N.C., në të cilën bashkëshorti i saj ishte ortak në masën 50 % të kuotave, por nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor që personi i lidhur të ketë përfituar 80% të vlerës së shitjes së shoqërisë, në shumën prej 108.000 eurosh. Deklarimet e ortakut tjetër të shoqërisë “{***}” S.N.C., z. V. B., në deklaratën noteriale, hartuar në kuadër të procesit të rivlerësimit, me qëllim që subjekti i rivlerësimit të provonte se personi i lidhur, si ortak i shoqërisë së sipërcituar kishte përfituar 80% të vlerës së shitjes së saj, nuk harmonizohen me ndonjë dokumentacion tjetër provues të kohës kur është kryer veprimi juridik, për pasojë, në mbështetje të jurisprondencës së Kolegjit, nuk kapërcejnë nivelin deklarativ për t'u konsideruar me fuqi provuese, në këtë proces. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk gjen mbështetje as në deklarimet e personit të lidhur në deklaratën e rivlerësimit, lidhur me të ardhurat e realizuara prej tij nga emigracioni në shtetin italian në periudhën 1992-2005, të cilat i ka cilësuar në vlerën totale prej 123.000 eurosh. Nëse nga kjo shumë do të zbriteshin të ardhurat e përfituara nga punësimi i ligjshëm i z. V. si emigrant, në shumën 36.822 euro, sipas të dhënave të Institutit Kombëtar të Sigurimeve Shoqërore të shtetit italian (67.000 euro të ardhura *bruto*), si dhe duke mbajtur në konsideratë se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se pjesë e kësaj shume janë dhe të ardhurat nga punësimi si punonjës i pasiguruar, vlera e të cilave nuk mund të evidentohet, diferenca e mbetur, e cila do të përfaqësonte shumën e përfituar nga pjesa takuese e vlerës së

shitjes së shoqërisë “{***}” S.N.C., nuk do të ishte në asnjë rast 108.000 euro, sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit.

Për sa më sipër, trupi gjykues, ashtu si edhe Komisionerja Publike në ankim dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme gjatë gjykimit në Kolegj, vlerësoi se gjendet i pambështetur në prova pretendimi i subjektit të rivlerësimit se personi i lidhur ka përfituar shumë prej 108.000 eurosh nga shitja e aktivitetit të shoqërisë “{***}” S.N.C., në të cilën ishte ortak në masën 50%.

19.3. Sa i përket të ardhurave nga shitja e aktivitetit të shoqërisë “{***}” S.N.C., të përfituara përmes urdhër xhirimeve bankare (*kambialeve*), trupi gjykues, duke e gjetur të drejtë qëndrimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme gjatë gjykimit në Kolegj, vlerësoi se këto të ardhura, në shumën totale prej 21.959 eurosh, referuar transferimeve të urdhër xhirimeve në llogarinë bankare të z. V., për periudhën 2006-2008, nuk plotësojnë kushtet për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme në zbatim të përcaktimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues vëren se ligji italian nr. 917, datë 22.12.1986, “Për tatimin mbi të ardhurat”, sipas normave në fuqi në periudhën 2006-2008, kur është provuar përfitimi i të ardhurave nga këmbimi i urdhër xhirimeve (*kambialeve*) në sistemin bankar italian, në nenin 3, pika 1 të tij¹⁸, parashikonte se: “*1. Tatimi zbatohet për të ardhurat totale të subjektit, të formuara për rezidentët nga të gjitha të ardhurat që posedojnë dhe për jorezidentët vetëm nga ato të prodhuara në territorin e shtetit, [...]*”. Në kuptim të këtij parashikimi ligjor, largimi i z. V. nga Italia në vitin 2005¹⁹ nuk e zhbënte detyrimin e tij për deklarimin dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara në periudhën 2006-2008, si të ardhura të realizuara nga shitja e një aktiviteti të zhvilluar në shtetin italian. Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, për këto të ardhura të përfituara nga personi i lidhur gjatë kohës së bashkëjetesës, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion fiskal për deklarimin e tyre nga personi i lidhur dhe as për pagesën e ndonjë detyrimi tatimor kundrejt tyre, në shtetin italian, për pasojë këto të ardhura nuk mund të përfshihen në analizën financiare.

19.4. Në vijim, trupi gjykues, mbajti një qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, Komisionerja Publike në ankim, si dhe nga qëndrimi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme gjatë gjykimit në Kolegj, për sa i përket të ardhurave në shumën 23.867 euro të deklaruara nga personi i lidhur në Agjencinë e Tatimeve në Itali²⁰, përmes formularit të deklarimit të të ardhurave, sipas modelit UNICO, duke konsideruar këtë shumë si të ardhur të ligjshme, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Ky qëndrim i trupit gjykues u bazua në vlerësim të elementeve të situatës faktike, lidhur me shumën prej 23.867 eurosh, si vijon:

- (i) krijimi i saj nga një burim i ligjshëm - akti noterial “Pranimi dhe transferimi i shoqërisë “{***}” S.N.C., me nr. {***} rep., datë 15.07.2004;
- (ii) krijimi i saj në vitin 2004, para se subjekti i rivlerësimit të kishte filluar bashkëjetesën me personin e lidhur;
- (iii) deklarimi i saj në Agjencinë e Tatimeve në Itali nga personi i lidhur përmes formularit përkatës të deklarimit;
- (iv) gjenerimi i detyrimit tatimor për këtë shumë, para momentit të fillimit të bashkëjetesës së z. V. me subjektin e rivlerësimit;

¹⁸ <https://def.finanze.it/DocTribFrontend/getArticoloDetailFromResultList.do?id={B00CBF13-69D0-4A36-B4242666E588CBC2}&codiceOrdinamento=&idAttoNormativo={31D694E8-4398-4030-873B-FEAF5A6647F9}>

¹⁹ Referuar të dhënave të sistemit TIMS, z. V. është kthyer në Shqipëri, në datën 19.04.2005.

²⁰ Në shtetin italian e njohur si “Agenzia delle Entrate”.

(v) mungesa e provave për ndikimin apo keqbesimin e vetë subjektit të rivlerësimit për mospagimin e detyrimit tatimor lidhur me këtë shumë në kohën e gjenerimit të tij, pra, në mars të vitit 2005; si dhe

(vi) përfitimin e saj në një kohë të afërt me fillimin e pagesave për blerjen e pasurisë “apartament”, objekt kontrolli.

20. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues konkludoi se në analizën financiare për verifikimin e burimeve të krijimit të pasurisë “apartament”, në Vlorë, duhet të përfshihet vlera prej 18.010 eurosh ose prej 2.241.747 lekësh²¹ si e ardhur e ligjshme në kuptim të standardeve kushtetuese e ligjore të këtij procesi, e cila rezulton pas zbritjes së tatimit mbi të ardhurat në shumën 5.857 euro, e evidentuar në formularin e deklarimit të të ardhurave modeli *UNICO*, dorëzuar nga personi i lidhur në Agjencinë Italiane të Tatimeve.

21. Lidhur me pretendimin e Komisioneres Publike, në ankim, sipas së cilit të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në Itali nuk janë përlllogaritur nga Komisioni në vlerën neto, trupi gjykues konstatoi dhe analizoi si më poshtë.

21.1. Komisioni, në vendim²², lidhur me të ardhurat nga paga, përfituar gjatë kohës së emigracionit të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në shtetin italian, ka arsyetuar dhe konkluduar se: *“Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit rezultoi e provuar se bashkëshorti i subjektit ka hyrë në shtetin italian në datën 23.02.1992 dhe ka deklaruar pranë Agjencisë së Tatimeve për periudhën 1998-2005 të ardhura, të cilat janë në vlerën totale 37.423 euro. Në analizë të këtyre provave rezulton se të ardhurat e ligjshme, sipas vërtetimit të INPS Itali (Instituti i Sigurimeve Shoqërore), për periudhën 1996-2005, janë në vlerën totale 67.319 euro. Komisioni kreu analizën financiare të të ardhurave të bashkëshortit dhe ka përfshirë të ardhurat e vërtetuara nga INPS për vitet 1996-1997 dhe 2005, me vërtetim të përcjellë nga subjekti. Për sa i përket të ardhurave në periudhën 1998-2004, subjekti ka përcjellë një dokument, i cili përfaqëson të ardhura si “competenze correnti”, të cilat të përktuara nuk përbëjnë të ardhurën neto, por as atë bruto sipas legjislacionit tatimor italian. Pavarësisht kësaj, Komisioni, në analizë të faktit që kemi të bëjmë me një ndryshim në një vlerë të vogël, i ka përfshirë të gjitha në vlerë totale në analizën financiare. Nga analiza financiare (tabela nr. 5 e rezultateve të hetimit administrativ) rezultoi se bashkëshorti ka pasur mundësi të kursejë vlerën 36.185 euro me të ardhura të ligjshme gjatë qëndrimit të tij në shtetin italian, në periudhën 1996-maj 2005”.*

21.2. Komisionerja Publike, në ankim, ka kundërshtuar arsyetimin dhe konkluzionin si më sipër, me pretendimin se sa i takon të ardhurave nga punësimi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në Itali, rezulton se të ardhurat e llogaritura nga Komisioni janë në vlerën 67.319 euro, që përveçse, sikurse dhe vetë Komisioni ka arsyetuar, nuk përfaqësojnë të ardhurën neto, janë të ndryshme dhe nga të ardhurat e bashkëshortit, sipas vërtetimit të Institutit Kombëtar të Sigurimeve Shoqërore të shtetit italian²³, që rezultojnë në vlerën 36.822 euro. Gjithashtu, Komisionerja Publike ka konstatuar se shpenzimet e jetesës për personin e lidhur në shtetin italian për periudhën e analizuar, nuk janë llogaritur me të njëjtin standard që Komisioni ka llogaritur shpenzimet e jetesës për personin tjetër të lidhur, z. Y. V.. Nëse shpenzimet e jetesës

²¹ Përlllogaritur sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, për periudhën 2004-2005.

²² Paragrafët 29.8.1 -29.8.4. të vendimit të Komisionit.

²³ Në shtetin italian i njohur si Istituto Nazionale di Previdenza Sociale ose INPS.

së personit të lidhur do të llogariteshin sipas të dhënave të *EUROSTAT-it*²⁴, sikurse janë llogaritur dhe për kunatin e subjektit të rivlerësimit, atëherë për të njëjtën periudhë 1996-2005 do të rezultonin në vlerën rreth 57.000 euro. Në vlerësim të Komisioneres Publike, duke konsideruar dhe shpenzimet/investimet e kryera për shoqërinë “{***}” S.N.C., nuk do të rezultonte mundësi kursimi nga të ardhurat e personit të lidhur nga punësimi në Itali.

21.3. Gjatë gjykimit në Kolegj, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, konfirmoi qëndrimin e Komisioneres Publike, në ankim, duke nënvizuar se edhe në variantin sipas së cilit merren në konsideratë të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur, në masën që pretendoi subjekti i rivlerësimit (që përfaqësojnë të ardhurat *bruto*), pas zbritjes së shpenzimeve të jetesës dhe shpenzimeve/investimeve të kryera për shoqërinë “{***}” S.N.C., nuk do të rezultonte mundësi kursimi nga këto të ardhura të realizuara nga punësimi i personit të lidhur në shtetin italian.

21.4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, kundërshtoi shkaku e ankimit të Komisioneres Publike të konfirmuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke mbajtur të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit administrativ, duke pretenduar, në mënyrë të përmbledhur, se ka vënë në dispozicion të Komisionit të dhënat e vërtetuara me dokumentacionin që bashkëshorti i saj ka mundur të sigurojë për të ardhurat e realizuara prej tij nga punësimi gjatë qëndrimit në shtetin italian. Sipas subjektit të rivlerësimit, dokumenti i titulluar “Estratto Conto Previdenziale” lëshuar nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore të shtetit italian, me datë printimi 20.04.2023, pasqyron informacion mbi pagën mbi të cilën janë derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore, por nuk pasqyron pagën *neto* që ka përfituar punëmarrësi, pagë e cila është e pasqyruar saktësisht në deklaratat tatimore. Sa i përket përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nga Komisioni janë mbajtur në konsideratë standardet e *EUROSTAT-it* për një anëtar të familjes, duke i reduktuar ato për shkak të aktivitetit të kryer nga personi i lidhur pranë restoranteve. Shpenzimet e jetesës së kunatit të saj që jeton në Itali, sigurisht që do të ishin më të larta se ato të personit të lidhur, pasi kunati nuk ka jetuar vetëm, por me bashkëshorten e tij që prej vitit 1987. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pretendoi se nga hetimi i kryer nga Komisioni u provua se të ardhurat e ligjshme të përfituara nga personi i lidhur nga punësimi në Itali, për periudhën 1998-2004, janë në vlerën 67.319 euro dhe mundësia për kursim rezulton në shumën 36.185 euro, shumë e cila duhet të përfshihet në analizën financiare si e ardhur e ligjshme.

22. Në shqyrtim të shkakut të ankimit, trupi gjykues analizoi faktet dhe rrethanat e konstatuara nga hetimi administrativ i kryer në Komision dhe vlerësoi në harmoni si vijon.

Së pari: të ardhurat e përfituara nga punësimi në shtetin italian janë deklaruar nga personi i lidhur në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, pa një vlerë konkrete, ndërsa në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës të vitit 2009, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime apo pasuri të ndonjë lloji tjetër që të kishte si burim financiar krijimi të ardhurat e përfituara nga puna si emigrant në shtetin italian;

Së dyti: për të vërtetuar të ardhurat nga punësimi i personit të lidhur në Itali, subjekti i rivlerësimit ka depozituar, në formën e kërkuar nga ligji:

22.1. Kartela të përlllogaritjes së pagës (*bustapaga*) për z. B. V., të lëshuara nga autoritetet italiane, për të ardhurat e përfituara nga punësimi i tij, gjatë periudhës 1996-2001 dhe 2004;

²⁴ Autoriteti zyrtar i statistikave i Bashkimit Evropian.

22.2. Ekstraktin e llogarisë së sigurimeve shoqërore të z. B. V., lëshuar nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore Itali, për periudhën 1996-2005;

22.3. Deklarata tatimore për të ardhurat individuale, modeli 770, për vitet 1998-2004, lëshuar nga Agjencia e Tatimeve, në {***}, Itali, për të ardhurat e përfituara nga z. B. V. nga punësimi në shtetin italian.

22.4. Në vijim të analizës si më sipër e në mbështetje të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në përlllogaritjen e të ardhurave të personit të lidhur nga punësimi në shtetin italian, trupi gjykues vlerësoi të përlllogarisë këto të ardhura në mënyrë të kombinuar, për periudhat në të cilat të dhënat nuk mbivendoseshin, duke konsideruar:

a) të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, për vitet 1996, 1997 dhe për periudhën 01.01.2005-31.05.2005, në masën e rezultuar nga të dhënat e dokumentuara në ekstraktin e llogarisë së sigurimeve shoqërore të z. B. V., lëshuar nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore në Itali. Të ardhurat e pasqyruara në këtë dokumentacion, për vitin 1996 në vlerën 3.953 euro, për vitin 1997 në vlerën 2.653 euro dhe për periudhën 01.01.2005-31.05.2005, në vlerën 580 euro, u konsideruan nga trupi gjykues si të ardhura *neto* të realizuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në vlerë totale prej 7.186 eurosh;

b) të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, për periudhën 1998-2004, në masën e rezultuar nga të dhënat e dokumentuara në deklaratat tatimore për të ardhurat individuale, modeli 770, lëshuar nga Agjencia e Tatimeve, në {***}, Itali, në vlerën totale prej 50.013 eurosh²⁵. Referuar të dhënave të formularit të deklarimit për secilin vit, trupi gjykues i konsideroi këto të ardhura të pasqyruara në vlerë *bruto*, ndaj mbi to u aplikua më së paku zbritja e tatimit mbi të ardhurat, në përqindjen përkatëse për çdo vit dhe, për pasojë, të ardhurat *neto* të përfituara nga personi i lidhur për periudhën objekt analize rezultuan në vlerën totale prej 40.761 eurosh. Në total të ardhurat nga pagat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nga punësimi i personit të lidhur në shtetin italian, të cilat do të konsiderohen nga trupi gjykues në verifikimin e mundësisë së krijimit të kursimeve të pretenduara, janë në shumën prej 47.947 eurosh.

22.5. Sa i përket shpenzimeve të jetesës, trupi gjykues vëren se Komisionerja Publike, në ankim, dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme gjatë gjykimit në Kolegj, i kanë përlllogaritur këto shpenzime, për periudhën 1996-2005, në shumën totale prej 57.000 eurosh bazuar në metodologjinë statistikore të *EUROSTAT-it*²⁶, sipas të ardhurave *neto* mujore, ponderuar masa e shpenzimeve me 60%²⁷. Ndërsa Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, në analizën financiare të kryer për verifikimin e mundësisë së personit të lidhur për të krijuar kursime me burim të ardhurat nga punësimi në shtetin italian, ka përlllogaritur shpenzimet e jetesës në referencë me të dhënat e *EUROSTAT-it* për një individ, në vlerën 38.320 euro ose ponderuar masa e shpenzimeve me 40% të të ardhurave²⁸.

²⁵ Në formularët e deklarimit janë pasqyruar të ardhurat në vlerë bruto: për vitin 1998 në shumën 12.293 euro; për vitin 1999 në shumën 12.269 euro; për vitin 2000 në shumën 6.314 euro; për vitin 2001 në shumën 11.949 euro; për vitin 2002 në shumën 3.418 euro; për vitin 2003 në shumën 2.233 euro dhe për vitin 2004 në shumën 1.537 euro.

²⁶ Chromeextension://efaidnbmnnnibpcajpcgclcfndmkaj/https://ec.europa.eu/eurostat/documents/54431/1966394/Standardised-key-social-variables.pdf

²⁷ Sipas metodologjisë statistikore të *EUROSTAT-it*, përcaktimi i masës së shpenzimeve të jetesës bëhet në varësi të të ardhurave *neto* mujore, të cilat janë klasifikuar në 5 grupe: grupi me të ardhura të ulëta, grupi me të ardhura të ulta deri në mesatare, grupi me të ardhura mesatare, grupi me të ardhura të larta dhe grupi me të ardhura shumë të larta. Në varësi të grupit të të ardhurave përcaktohet edhe masa e shpenzimeve të jetesës, e ponderuar përkatësisht sipas grupit me 20%, 40%, 60%, 60-80%, mbi 80%.

²⁸ Faqja 9-10 e rezultateve të hetimit administrativ të Komisionit.

Trupi gjykues, duke vlerësuar të provuara dhe bindëse pretendimet e subjektit të rivlerësimit se puna e kryer pranë restoranteve nga personi i lidhur gjatë periudhës së emigrimit në Itali ka ndikuar në reduktimin e shpenzimeve, e gjeti të logjikshme dhe të drejtë qasjen e Komisionit analizuar si më sipër, në drejtim të përlogaritjes së shpenzimeve të jetesës të personit të lidhur.

22.6. Në vijim të konkluzioneve të mësipërme, për efekt të verifikimit të mjaftueshmërisë së këtyre të ardhurave për krijimin e kursimeve të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues, në ndryshim nga Komisioni, përfshiu në analizën financiare përveç shpenzimeve të jetesës edhe investimin në masën 1.000 euro kryer nga personi i lidhur për krijimin e kapitalit të shoqërisë “{***}” S.N.C. në të cilën ai ishte mbajtës i 50% të kuotave, si dhe pagesën përkatëse të kryer nga personi i lidhur deri në muajin korrik 2004 për blerjen e aktivitetit “restorant” nga shoqëria “{***}” S.A.S., në shumën 9.685 euro, shpenzime/investime këto të referuara në aktin “Pranimi dhe transferimi i shoqërisë” nr. {***} rep., datë 15.07.2004, i redaktuar nga noteri L. Z., me seli në {***}, Firenze²⁹. Analiza financiare e kryer mbi të dhënat e mësipërme rezultoi me një balancë negative prej (-) 1.058 eurosh, për pasojë, trupi gjykues e gjeti të drejtë pretendimin e Komisioneres Publike dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme se personi i lidhur gjendej në pamundësi për të krijuar kursime, bazuar në të ardhurat e realizuara nga punësimi në shtetin italian.

23. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas së cilit të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga aktiviteti “ristorator” gjatë periudhës 2005-2011, në shumën rreth 5.400.000 lekë, nuk duhet të përfshihen në analizën financiare, trupi gjykues konstatoi dhe analizoi si më poshtë.

23.1. Komisioni, në vendim³⁰, ka vlerësuar: “Në analizë të ligjshmërisë së të ardhurave të bashkëshortit, analiza fillon me vendimin e gjykatës, i cili parashikon detyrimin që kanë punëdhënësit ndaj bashkëshortit të subjektit. Ky vendim rezulton i ekzekutuar në mënyrë të vullnetshme nga punëdhënësit. Rezulton se vendimi i gjykatës është ekzekutuar sipas njoftimit për ekzekutim vullnetar nr. {***} prot., nr. 1259 regj., datë 26.06.2023, përmbarues gjyqësor privat “E. V.” dhe shkresë të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë, sipas së cilës nga verifikimet e kryera në sistemin C@TS ka rezultuar se DRT Vlorë ka ekzekutuar vendimin nr. {***}, datë 07.06.2023. Gjithashtu, subjektet “{***}” ShPK, “E. B.” dhe “P. M.” kanë paguar të gjitha detyrimet në zbatim të vendimit nr. {***}, datë 07.06.2023. Në një vlerësim të peshës që ka ky vendim në procesin e rivlerësimit është e qartë se ky është një vendim që ka dalë gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit, por ky nuk mund të jetë një vendim, i cili ka fuqi detyruese vetëm ndaj palëve në proces. Në kuadër të standardit të vendosur nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, përmbushja e elementeve të ligjshmërisë së të ardhurave nëpërmjet ekzekutimit të këtij vendimi, nuk mund të jetë i shkëputur nga disa fakte të tjera, të cilat rezultuan gjatë hetimit, si:

Bashkëshorti i subjektit ka ushtruar profesionin e shefit të kuzhinës nga viti 1995 e në vijim. Ai ka qenë në padijeni për mospërmbushjen nga punëdhënësi të pagesës së detyrimeve tatimore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, sipas parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003,

²⁹ Sipas aktit noterial të sipërcituar rezulton se kapitali aksionar i shoqërisë “{***}” S.N.C. ka qenë në vlerën 2.000 euro, nga ku vlera e pjesës takuese prej 50% të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit llogaritet në shumën 1.000 euro. Z. V. B. dhe z. B. V., më datë 30.09.2002, kanë blerë aktivitetin “restorant” nga shoqëria “{***}” S.A.S.. Deri më datë 06.02.2004, z. B. dhe z. V. kanë shlyer 19.371 euro ose 9.685 euro secili.

³⁰ Paragrafi 38.8 i vendimit të Komisionit.

*“Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbi masën e pagës së deklaruar nga personi i lidhur, e cila e përjashton atë nga të qenit në kushtet e keqbesimit në raport me sjelljen e palës punëdhënëse. Bashkëshorti i subjektit, përveç faktit se ka punuar në subjektet e mësipërme, në të njëjtën periudhë është përpjekur të hapë një restorant të tij, fakt, i cili provohet me kontratë qiraje nr. {***/{***}, datë 16.10.2007, me palë qiradhënëse shtetasen L. D. (B.) dhe palë qiramarrëse shtetasit F. V. e B. V., me objekt marrjen me qira të një lokali të ndodhur në lagjen “{***}”, me sipërfaqe 400 m², me afat 01.01.2007 - 01.11.2012, me të drejtë përsëritjeje. Subjekti ka deklaruar të ardhurat e bashkëshortit në deklaratën e interesave 2009 e në vijim si shef kuzhine. Kjo provon faktin që këto të ardhura dhe kjo punë është kryer nga ana e personit të lidhur dhe nuk është një deklaram që lidhet me procesin e rivlerësimit. Këto kursime nuk rezultojnë të jenë përdorur nga subjekti për blerjen e ndonjë pasurie për t’u ngritur dyshime për deklaram fiktiv. Vlera e likuiditeteve cash e deklaruar në deklaratën e rivlerësimit është 10.000 euro, për të cilën nga analiza financiare rezultojnë se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e saj”.*

23.2. Komisionerja Publike, në kundërshtimin e vlerësimit të mësipërm të Komisionit, ka argumentuar se të ardhurat e personit të lidhur nga aktiviteti “ristorator”, gjatë periudhës 2005-2011, deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në shumën rreth 5.400.000 lekë, nuk duhet të përfshihen në analizën financiare, pasi:

- (i) nuk u administrua asnjë akt i kohës që të provojë përfitimin e këtyre shumave, kohën e përfitimit dhe shumën përkatëse;
- (ii) në konsideratë të qëndrimit orientues të Kolegjit, pagimi i detyrimeve tatimore nuk mund të shërbejë si një mjet për të provuar krijimin e të ardhurave që nuk provohen me mjete të tjera;
- (iii) lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se bashkëshorti ka ardhur në dijeni vetëm gjatë këtij procesi për mosshlyerjen e detyrimeve tatimore dhe ka kërkuar gjyqësisht që punëdhënësit të zbatojnë detyrimet ligjore, Kolegji ka trajtuar në jurisprudencën e tij, situata të ngjashme, ku përpjekja për të arritur te pagesa e detyrimeve tatimore gjatë procesit është vlerësuar se përfaqëson veprime të kryera për efekt të këtij procesi.

23.3. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, mbi pretendimet e Komisioneres Publike, në konkluzionet përfundimtare, parashtroi, në mënyrë të përmbledhur, se këto të ardhura nuk duhen përfshirë në analizën përfundimtare, pasi edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj nuk u administrua asnjë akt i kohës, si kontratë pune, listëpagesë, kreditim i pagës në llogarinë bankare etj., që të provojë përfitimin faktik të këtyre shumave, kohën e përfitimit ose shumën përkatëse. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit nuk përputhen me sa ka deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe në deklaratat periodike të interesave lidhur me të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur nga aktiviteti “ristorator” në vitet përkatëse dhe as me sa kanë pohuar punëdhënësit e pretenduar gjatë proceseve gjyqësore lidhur me pagesat e detyrimeve tatimore. Sipas Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, këto pretendime të subjektit të rivlerësimit bien ndesh edhe me përmbajtjen e provave të paraqitura prej saj gjatë hetimit administrativ në Komision se personi i lidhur, në vitin 2009, ka marrë me qira një lokal shërbimi ku ka ushtruar aktivitetin “ristorator”, vetëm për dy sezona, por nuk pati rezultat pozitiv.

23.4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, prapësoi shkakun e ankimit të Komisioneres Publike dhe qëndrimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se gjatë hetimit administrativ u provua se bashkëshorti ka ardhur në dijeni të mospërmbushjes së detyrimeve tatimore nga punëdhënësit e tij vetëm gjatë procesit të rivlerësimit dhe me ardhjen në dijeni të këtij fakti ka kërkuar gjyqësisht nga këta punëdhënës të zbatojnë detyrimet ligjore. Vendimi gjyqësor, i cili ka vendosur detyrimin e punëdhënësve të paguajnë në favor të bashkëshortit sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale, është ekzekutuar në mënyrë të detyrueshme nga përbarimi gjyqësor dhe Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë ka vërtetuar se detyrimet tatimore janë paguar nga subjektet tregtare ku ka qenë i punësuar bashkëshorti i saj. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar, gjithashtu, se shuma e përfituar nga aktiviteti “ristorator” i personit të lidhur provohet me vendim gjykatë të formës së prerë, vendim i cili përbën gjë të gjykuar dhe asnjë gjykatë tjetër nuk mund të vërë në diskutim këtë vendim, bazuar në parimin e sigurisë juridike. Në kuadër të qenies ose jo në mirëbesim të bashkëshortit lidhur me pagesat e detyrimeve që lindnin nga paga, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se duhet mbajtur në konsideratë fakti që pagesat janë deklaruar rregullisht në deklaratat periodike, sikundër edhe deklaratat noteriale të punëdhënësve konfirmojnë pagën e pretenduar prej tij, për rrjedhojë bashkëshorti nuk ka qenë në kushtet që të vërë në dyshim se lidhur me pagesat e përfituara nga punësimi i tij nuk ishin shlyer nga punëdhënësi detyrimet me natyrë tatimore ndaj shtetit. Edhe padia e ngritur ndaj punëdhënësve konfirmon bindjen se bashkëshorti nuk ka qenë në keqbesim në raport me sjelljen e palës punëdhënëse. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar që këto të ardhura të merren në konsideratë në analizën financiare.

24. Në shqyrtim të pretendimeve të Komisioneres Publike, në ankim, dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, si dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit e provave të paraqitura prej saj gjatë gjykimit Kolegj, trupi gjykues analizoi sa më poshtë.

24.1. Nga analiza e akteve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, si edhe më parë në deklaratat periodike të interesave, kanë deklaruar se për financimin e pasurive dhe likuiditeteve në bankë, kanë shërbyer të ardhurat që personi i lidhur ka siguruar nga aktiviteti “ristorator”. Në drejtim të të ardhurave të siguruara nga ky aktivitet, trupi gjykues konstatoi se në deklaratën e rivlerësimit, personi i lidhur, z. B. V., ka deklaruar: *Të ardhura nga aktiviteti “ristorator”, aktivitet i zhvilluar në Vlorë gjatë periudhës 2005-2011. Vlera: rreth 5.400.000 lekë*, por nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues për këto të ardhura lidhur me shumën dhe periudhën e pretenduar në deklaram.

Në deklaratën para fillimit të detyrës, dorëzuar në ILDKPKI në datën 05.03.2009, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar: *Bashkëshorti B. V., të ardhura nga aktiviteti privat. Janar-06.02.2009. Vlera: 350.000 lekë.*

Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2009, kanë deklaruar: *Të ardhura viti 2009, bashkëshorti aktiviteti “ristorator”. Vlera: 2.450.000 lekë.*

Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2010 kanë deklaruar: *Të ardhura viti 2010, bashkëshorti aktiviteti “ristorator”. Vlera: 1.400.000 lekë.*

24.2. Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision, për të provuar të ardhurat e siguruara nga aktiviteti “ristorator” i personit të lidhur, ka paraqitur:

24.2.1. Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.03.2023, e z. P. M., Person Fizik, me NIPT {***}, i cili deklaron se është subjekt privat që ushtron aktivitet Bar-Restorant-Hotel, në Vlorë, pa ndërprerje, që nga data 05.05.2003 e në vazhdim. Me qëllim përmirësimit e cilësisë në përgatitjen e menuve dhe asistencën e kuzhinierëve të punësuar pranë restorantit në pronësi të tij, për periudhën 2007-2010, në rast eventesh, ka marrë si specialist kuzhinier z. B. V.. Pagesat, rast pas rasti, kanë qenë *cash* 50.000 lekë për çdo event dhe paguheshin nga ai ose personat e interesuar. Mesatarisht, z. V. ka asistuar në jo më pak se 20 evente në vit;

24.2.2. Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.03.2023, e z. S. A., administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, me NIPT {***}, i cili deklaron se shoqëria “{***}” ShPK është krijuar që në vitin 1995 me aktivitet në fushën e hoteleri-bar-restorant. Nga periudha prill 2006-shtator 2007, ka pasur të punësuar pranë kësaj shoqërie z. B. V., me detyrë shef kuzhine dhe i ka paguar për të gjithë periudhën pagën 120.000 lekë çdo muaj;

24.2.3. Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.03.2023, e z. F. Sh., i cili deklaron se ka punuar në rolin e menaxherit pranë subjektit “E. B.”, regjistruar si person fizik, me NIPT {***}, datë 07.06.2005, në Vlorë, me administrator z. E. B.. Z. B.V. ka punuar si kuzhinier pranë këtij subjekti, që prej muajit qershor 2005 deri në muajin mars 2006 dhe është paguar me 100.000 lekë në muaj.

24.2.4. Për të mbështetur pretendimin se në lidhje me punësimin pranë Person Fizik “E. B.”, shoqërisë “{***}” ShPK dhe Person Fizik “P. M.”, personi i lidhur ka ardhur në dijeni gjatë procesit të rivlerësimit për mospagimin e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat personale, nga këta punëdhënës e, për rrjedhojë, me ardhjen dijeni të faktit, ka kërkuar gjyqësisht që këta punëdhënës të zbatojnë detyrimet ligjore, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision:

- o Vendimin nr. {***}, datë 07.06.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, i cili rezulton të ketë marrë formë të prerë më datë 07.06.2023, pasi nuk është ankimuar. Gjykata ka vendosur:

*Detyrimin e të paditurit person fizik “E. B.”, me NUIS {***}, të kryejë në favor të paditësit B. V. pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, duke përfshirë dhe TAP, për periudhën 01.06.2005-31.03.2006, mbi pagën mujore 100.000 lekë.*

*Detyrimin e të paditurit shoqëria “{***}” ShPK., regjistruar si person juridik me NUIS {***}, të kryejë në favor të paditësit B. V. pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore duke përfshirë edhe TAP, për periudhën e punësimit 01.04.2006-30.09.2007, mbi pagën mujore 120.000 lekë.*

*Detyrimin e të paditurit personit fizik “P. M.”, me NUIS {***}, të kryejë në favor të paditësit pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe TAP, për periudhën e punësimit 01.10.2007-31.12.2010, me shpërblym vjetor 1.000.000 lekë.*

- o Lajmërim për ekzekutim vullnetar nr. {***} prot., nr. {***} regj., datë 26.06.2023, e Përmbaues Gjyqësor Privat “E. V.”, drejtuar: personit fizik “E. B.”, personit fizik “P. M.” dhe shoqërisë “{***}” ShPK.

- o Shkresë nr. {***} prot., datë 20.07.2023, e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë, me lëndë: “Kthim përgjigje”, drejtuar z. B. V., sipas së cilës, nga verifikimet e kryera në sistemin C@TS, ka rezultuar se Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë ka ekzekutuar vendimin nr. {***}, datë 07.06.2023, gjithashtu, subjektet “{***}” ShPK, “E. B.” Person Fizik dhe “P. M.” Person Fizik, kanë paguar të gjitha detyrimet në zbatim të vendimit gjyqësor të sipërcituar.

25. Në vendim, Komisioni, ka çmuar se të ardhurat e bashkëshortit të deklaruar nga puna si shef kuzhine në të tre subjektet të përfshihen në analizën financiare. Në këtë analizë³¹, Komisioni ka përllogaritur, për periudhën 2005-janar 2009, të ardhurat e z. V. nga aktiviteti “ristorator” në Vlorë, në shumën 4.493.334 lekë, për vitin 2009 në shumën 916.667 lekë dhe për vitin 2010, në shumën 1.000.000 lekë. Në total, të ardhurat e z. V. janë përllogaritur në shumën 6.410.001 lekë.
26. Në analizë të fakteve dhe rrethanave të konstatuara si më sipër, trupi gjykues, në fillim të arsyetimit, çmoi të nënvizojë faktin se, sipas parashikimit të nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka në këtë proces barrën e provës për të provuar të gjitha faktet e pretenduara/deklaruar prej saj. Edhe pse personi i lidhur ka deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit se nga aktiviteti “ristorator” në periudhën 2005-2011 ka realizuar të ardhura, ai nuk ka deklaruar asnjë të dhënë lidhur me punëdhënësit dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion justifikues për të provuar këto të ardhura, në përmbushje të detyrimit të përcaktuar në nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, si dhe Urdhrit, datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së. Ndërkohë që personi i lidhur nuk ka pasur të njëjtën qasje për të ardhurat e përfituara nga emigracioni, që i përkasin një periudhe edhe më të hershme, për të cilat ka paraqitur dokumentacionin e plotë justifikues.

26.1. Nga aktet e hetimit administrativ, si dhe nga leximi i përgjigjeve të dhëna përgjatë këtij hetimi, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë krijuar në fund të këtij procesi një tablo me të dhëna kontradiktore rreth të ardhurave të pretenduara se janë përfitur nga personi i lidhur nga aktiviteti “ristorator”, për periudhën 2005-2011.

Ndërsa në deklaratën e rivlerësimit personi i lidhur ka deklaruar se nga aktiviteti “ristorator” ka përfitur për periudhën e sipërcituar të ardhura në shumën 5.400.000 lekë, qëndrim të ndryshëm ka mbajtur subjekti i rivlerësimit në Komision, pasi në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka deklaruar se këto të ardhura kanë qenë në shumën 5.576.666 lekë.

Trupi gjykues vëren, gjithashtu, se me aktet e paraqitura gjatë hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit është përpjekur të provojë të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur nga aktiviteti “ristorator” në subjektet përkatëse tregtare, të cilat për vitin 2009, sipas deklaratës noteriale të Personit Fizik “P. M.” dhe sipas pohimit gjyqësor të tij referuar në vendimin nr. {***}, datë 07.06.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, rezultuan në shumën 1.000.000 lekë, të dhëna këto që zhbëjnë deklarinimin e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur në deklaratën e interesave të vitit 2009, në të cilën ata kanë konfirmuar se të ardhurat nga ky aktivitet kanë qenë në shumën 2.450.000 lekë.

E njëjta situatë evidentohet edhe për vitin 2010, vit në të cilin subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në deklaratën e interesave kanë deklaruar të ardhura nga aktiviteti “ristorator” në shumën 1.400.000 lekë, e cila nuk përputhet me shumën e deklaruar nga Personi Fizik “P. M.”, në deklaratën noteriale të hartuar me kërkesë të personit të lidhur për efekt të procesit të rivlerësimit, si dhe me pohimin gjyqësor të tij referuar në vendimin nr. {***}, datë 07.06.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, sipas së cilit këto të ardhura kanë qenë në shumën 1.000.000 lekë.

26.2. Trupi gjykues vlerësoi të dhënat e përfuara prej këtyre akteve, të analizuara në paragrafin 23 më sipër në këtë vendim, duke konsideruar të pabesueshëm informacionin e përcjellë nga

³¹ Analiza financiare e pasqyruar në faqen 37 të vendimit të Komisionit.

deklaratat noteriale të sipërcituara, pasi duket se janë hartuar për nevojat e shfaqura rishtas përgjatë procesit të rivlerësimit për të justifikuar të ardhurat e deklaruar, si dhe në funksion të mbështetjes së shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, duke përfaqësuar në vetvete një kontradiktë në shpjegimet që ajo ka dhënë përgjatë hetimit administrativ në raport me deklarimet në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe ato periodike. Në këto deklarata, përfshirë edhe atë para fillimit të detyrës³², personi i lidhur nuk ka evidentuar se të ardhurat e deklaruar nga “aktiviteti ristorator”, burojnë nga një marrëdhënie punësimi në restorante të ndryshme, si dhe nuk ka deklaruar subjektet tregtare pranë të cilave ofronte këtë shërbim. Për më tepër, në vlerësimin si të pabesueshme të deklarimeve që subjekti i rivlerësimit ka bërë për punësimin e personit të lidhur në subjektet tregtare Person Fizik “P. M.”, Person Fizik “E. B.” dhe shoqërinë “{***}” ShPK, kontribuojnë edhe shpjegimet e dhëna prej saj në datën 25.02.2015 në ILDKPKI, në të cilat nuk figuron të jetë përmendur në asnjë moment punësimi i bashkëshortit në subjektet e sipërcituara, por vetëm aktiviteti i tij privat, për të cilin ka lidhur kontratën e qirasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.10.2007, për një lokal shërbimi në {***}, në Vlorë, e që nuk rezultoi një aktivitet i suksesshëm, pasi qarkullimi i realizuar në dy sezonet verore të funksionimit nuk arrinte të mbulonte as shpenzimet operacionale. Kjo kontratë qiraje rezulton të jetë akti i vetëm i paraqitur nga subjekti bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, në funksion të dokumentacionit justifikues për të provuar të ardhurat e bashkëshortit të saj nga aktiviteti “ristorator”.

26.3. Në përmbledhje të analizës sa më sipër, si dhe në konsideratë edhe të jurisprudencës së Kolegjit, sipas së cilës kushti i parë mbi të cilin do të duhet të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së të ardhurave është që të provohet bindshëm vetë ekzistenca e këtyre të ardhurave në kohën e krijimit të tyre, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor e financiar, qoftë edhe nëpërmjet të dhënave apo indicieve të kohës ekzistencën e një marrëdhënieje pune të personit të lidhur me subjektet tregtare Personi Fizik “E. B.”, shoqëria “{***}” ShPK dhe Personi Fizik “P. M.”. Në konsideratë të qëndrimit të mbajtur më sipër, trupi gjykues vlerësoi se të ardhurat e pretenduara se janë përfituar nga aktiviteti “ristorator” nuk plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për shkak se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm dhe vlerën e këtyre të ardhurave.

26.4. Trupi gjykues vlerësoi se edhe nëse të ardhurat e pretenduara do të ishin përfituar nga një marrëdhënie punësimi me këto subjekte tregtare, në konsideratë të qëndrimit orientues të Kolegjit³³, analiza do të duhej të vijonte me shqyrtimin e rrethanave të faktit që përcaktonin kushtet e tjera sipas këtij qëndrimi, ato që lidhen me sjelljen e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në raport me mospagimin e detyrimeve tatimore, lidhur me përcaktimin nëse ai ka qenë në mirëbesim apo keqbesim në drejtim të kohës së pagimit të këtyre detyrimeve.

Në kuadër të vlerësimit të qenies apo jo në mirëbesim të punëmarrësit, z. V., lidhur me pagesat e detyrimeve që lindin nga paga, trupi gjykues mbajti në konsideratë përgjigjen e subjektit të rivlerësimit në pyetësit nr. 2, të drejtuar nga Komisioni, në të cilën ka deklaruar se, në pozicionin që kishte bashkëshorti si i punësuar dhe në realitetin e asaj kohe, *ai e ka kërkuar disa herë, por punësimi i tij nuk është deklaruar*. Subjekti i rivlerësimit ka shprehur edhe gatishmërinë se nëse do të jetë e nevojshme ajo dhe bashkëshorti do të ishin të gatshëm për t'i paguar këto detyrime gjatë zhvillimit të hetimit administrativ. Nga sa më sipër, duket se edhe

³² Deklarim i bërë nga subjekti i rivlerësimit pas rikthimit në detyrën e gjyqtarës.

³³ Vendimi i Kolegjit nr. 15/2021 (JR), datë 18.06.2021.

në versionin se këto të ardhura do të ishin përfituar nga një marrëdhënie punësimi, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka qenë në dijeni për faktin që punëdhënësi i tij shmangte detyrimet tatimore dhe ato për sigurime shoqërore e shëndetësore, për rrjedhojë ka qenë në kushtet e keqbesimit sa i përket pagesës së detyrimeve tatimore që rridhnin nga marrëdhënia e punës e pretenduar. Brenda kësaj periudhe, 2005-2010, subjekti i rivlerësimit ka qenë e martuar me personin e lidhur dhe zgjedhja e tij, por edhe e subjektit si zyrtar deklarues sipas ligjit, për të pranuar përfitimin e të ardhurave në shmangie të pagimit të detyrimeve tatimore, i ka vendosur ata në kushtet e keqbesimit në raport me shlyerjen e këtyre detyrimeve.

26.5. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se shuma e përfituar nga aktiviteti “ristorator” i personit të lidhur provohet me vendim gjykate të formës së prerë, vendim i cili përbën “gjë të gjykuar” dhe asnjë gjykatë tjetër nuk mund të vërë në diskutim këtë vendim, bazuar në parimin e sigurisë juridike, trupi gjykues e vlerësoi këtë pretendim si të pabazuar në ligj, sepse të njëjtat fakte mund t’u shërbejnë në mënyrë të pavarur procedimeve të ndryshme, të cilat ndjekin qëllime të ndryshme, sikurse rasti objekt gjykimi. Kontrolli i pasurisë së subjektit të rivlerësimit për efekt të procesit të rivlerësimit autorizohet nga përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ato të ligjit të posaçëm nr. 84/2016, me një metodologji dhe procedurë të posaçme, me qëllim dhe funksion të përcaktuar dhe krejt të ndryshëm nga vlerësimi i gjykatës së juridiksionit të përgjithshëm, e cila ka disponuar për detyrimin e punëdhënësve për pagimin e detyrimeve tatimore nga punëdhënësit e personit të lidhur sipas legjislacionit të zbatueshëm. Procesi i rivlerësimit për shkak të ligjit nr. 84/2016, aplikohet dhe kryhet vetëm një herë dhe vendimmarrja u përket organeve të rivlerësimit. Trupi gjykues vlerësoi se në kontrollin e ligjshmërisë së burimit të pasurive dhe të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur ka vepruar në përputhje të plotë me kompetencën që i ka dhënë neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe neni 4 i ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 6 dhe 10 të Kodit të Procedurës Civile, për kryerjen e procesit të rivlerësimit.

27. Në konkluzion, trupi gjykues, bazuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, vlerësoi se të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti “ristorator” i personit të lidhur, për periudhën 2005-2011, nuk plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, ndaj nuk i përfshiu ato në analizën financiare të burimeve të krijimit të pasurive.
28. Në lidhje me pretendimin e Komisioneres Publike në ankim, se të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga personi i lidhur nga aktmarrëveshja e shitjes së pjesës takuese në fabrikën e përpunimit të ullirit në Vlorë, nuk duhet të përfshihen në analizën financiare dhe nuk duhen marrë në konsideratë në vlerësim tërësor, trupi gjykues konstatoi dhe analizoi si më poshtë.

28.1. Komisioni, në vendim³⁴, ka vlerësuar se: “Komisioni, në analizë të provave të administruara gjatë hetimit dhe deklarimeve në seancë dëgjimore, çmon se: Rezulton e provuar se personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit i ka përfituar këto të ardhura, e provuar kjo me një dokument noterial të kohës së krijimit të këtyre të ardhurave. Në mungesë të dokumentimit të pagimit të tatimeve, Komisioni nuk i ka përfshirë këto të ardhura në analizën financiare. Trupi gjykues çmon se në rastin konkret këto të ardhura nuk i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Por, pavarësisht kësaj, në analizë të vlerësimit të mësipërm, kohës së gjatë të krijimit të këtyre të ardhurave, krijimit para lidhjes së martesës, si dhe mungesës së keqbesimit nga ana e subjektit, pavarësisht se ato nuk mund të përfshihen në analizën financiare, trupi gjykues çmon se duhet të vlerësohen se nuk mund të

³⁴ Paragrafi 29.10 i vendimit të Komisionit.

jetë penalizuese në procesin e rivlerësimit të subjektit, pavarësisht vlerës së këtyre të ardhurave. Këto fakte do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit”.

28.2. Komisionerja Publike, në kundërshtimin e vlerësimit të sipërcituar të Komisionit, ka argumentuar se të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga personi i lidhur nga aktmarrëveshja e shitjes së pjesës takuese në fabrikën e përpunimit të ullirit në Vlorë nuk duhet të përfshihen në analizën financiare dhe nuk duhen marrë në konsideratë në vlerësim tërësor, pasi nuk janë deklaruar në deklaratën e rivlerësimit dhe në deklaratat periodike vjetore si të ardhura apo si burim krijimi, si dhe nuk plotësojnë dhe kriteret e nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës.

28.3. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, gjatë gjyqimit në Kolegj, në parashtrime dhe konkluzionet përfundimtare, ka konfirmuar me të njëjtat argumente shkakun e ankimit lidhur me të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga personi i lidhur nga aktmarrëveshja e shitjes së pjesës takuese në fabrikën e përpunimit të ullirit në Vlorë.

28.4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjyqimit në Kolegj, kundërshtoi shkakun e ankimit të Komisioneres Publike të konfirmuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke mbajtur të njëjtin qëndrim si në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ të Komisionit, duke pretenduar, në mënyrë të përmbledhur, se nga dokumentacioni i kohës rezulton e provuar se personi i lidhur ka përfituar shumë prej 3.381.700 lekësh nga shitja e pjesës takuese në fabrikën e përpunimit të ullirit në Vlorë, në vitin 1997. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se pasaktësia në mosdeklarimin e kësaj shume në deklaratën e rivlerësimit nuk mund ta penalizojë për sa kohë ajo nuk shoqërohet me mungesë burimesh të ligjshme dhe, për më tepër, kjo është një e ardhur e krijuar në mënyrë të ligjshme. Në lidhje me mosdeklarimin e kësaj shume në deklaratat periodike, subjekti i rivlerësimit ka sjellë në vëmendje se personi i lidhur ka deklaruar për herë të parë në ILDKPKI në vitin 2009, ndërkohë që këto të ardhura janë krijuar në vitin e largët 1997 dhe, për rrjedhojë, ai nuk kishte detyrimin ligjor për t'i deklaruar ato për sa kohë në deklaratat periodike kërkohet të deklarohen vetëm të ardhurat aktuale, pra, të atij momenti kur plotësohet deklarata. Në lidhje me pagimin e detyrimeve tatimore, personi i lidhur nuk ka pasur detyrimin për të paguar, pasi nuk bëhet fjalë për një pasuri e cila është regjistruar pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës që më pas të kishte detyrimin për pagimin e tatimit përkatës. Sipas subjektit të rivlerësimit, ajo nuk kishte si të ishte në dijeni të faktit që bashkëshorti i saj në vitin 1997 nuk kishte paguar detyrimet tatimore, pasi bëhet fjalë për të ardhura të krijuara para martesës.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit i kërkoi trupit gjykues të Kolegjit, që të përfshijë në analizën financiare të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i saj nga shitja e pjesës takuese në fabrikën e përpunimit të ullirit, në Vlorë, në vitin 1997, në shumën 3.381.700 lekë, si të ardhura të ligjshme.

- 29.** Në shqyrtim të pretendimeve të Komisioneres Publike dhe të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, pasi analizoi aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi sa më poshtë.

29.1. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, personi i lidhur, z. B. V., nuk ka deklaruar në rubrikën përkatëse përfitimin e të ardhurave nga aktmarrëveshja e shitjes së pjesës takuese në fabrikën e përpunimit të ullirit në Vlorë, në vitin 1997.

Një deklaram të tillë bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk e ka bërë as në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2009 e as në deklaratat periodike të interesave në vijim si burim për krijimin e pasurive të deklaruara.

29.2. Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision, ka paraqitur kopje të aktmarrëveshjes nr. {***} rep., datë 01.02.1997, sipas së cilës z. B. V. dhe z. Xh. B. investuan në makineri dhe ndërtimin e një punishteje vaji, mbi truallin në pronësi të z. Xh. B., në {***}, Vlorë. Kjo fabrikë ishte në bashkëpronësi të z. V. dhe z. B.. Me anë të kësaj aktmarrëveshjeje, z. V. ka hequr dorë nga pronësia mbi këtë punishte, duke ia shitur kapitalin e tij (gjysmën e punishtes së vajit së bashku me gjysmën e vlerës së makinerive) z. Xh. B., kundrejt çmimit prej 1.000.000 lekësh dhe 30.000.000 lireta. Shumat e mësipërme i janë dorëzuar në dorë z. V. nga blerësi, në praninë e noterit publik. Me nënshkrimin e kësaj aktmarrëveshjeje, z. B. bëhej pronar i vetëm i objektit, ku bashkë me të drejtën e pronësisë i kalonin edhe të drejta të tjera si ajo e nëndorësisë, gëzimit dhe disponimit.

29.3. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe shkresën nr. {***} prot., datë 18.03.2024, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, e cila e ka informuar se, pas verifikimit në sistemin multifunksional të regjistrimit, nuk rezulton të ketë objekte të regjistruara në favor z. Xh. B., në fshatin {***}, Vlorë, për rrjedhojë prej këtij verifikimi nuk rezulton të jetë e regjistruar as punishtja e vajit objekt i aktmarrëveshjes së sipërcituar.

30. Në vijim të analizës, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim, ka vlerësuar se të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, të pretenduara se janë përfituar nga shitja e fabrikës së përpunimit të ullirit në vitin 1997, nuk janë përfshirë në analizën financiare, pasi në mungesë të dokumentimit të pagimit të tatimeve, këto të ardhura nuk i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Nga verifikimi i analizës financiare të kryer nga Komisioni e të pasqyruar në vendim³⁵, trupi gjykues konstatoi se Komisioni ka përlllogaritur shumën 4.434.170 lekë në zërin “Të ardhura të bashkëshortit nga shitja e aktivitetit dhe nga paga në emigracion 1992-2005 dhe nga kambialet”, duke mos përfshirë në këtë shumë të ardhurat e përfituara nga shitja e fabrikës së përpunimit të ullirit, në vitin 1997. Edhe në konkluzionin përfundimtar të arritur në vendim për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni ka referuar se të gjitha rrethanat, në mënyrë thelbësore, lidhen me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në Itali dhe shitjen e një aktiviteti në vitin 2004³⁶ dhe në vijim ka çmuar se mungesa e burimeve të ligjshme që rezulton nga analiza financiare e kryer, duke mos përfshirë të ardhurat e bashkëshortit nga shitja në vitin 2004 të shoqërisë “{***}” S.N.C., nuk duhet të konsiderohet si një rrethanë që e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në kushtet kur, sa më sipër rezulton se Komisioni nuk i ka përfshirë në analizë të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, të pretenduara se janë përfituar nga shitja e fabrikës së përpunimit të ullirit në vitin 1997 dhe as në vlerësimin tërësor të kriterit të vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues nuk e gjen të mbështetur në prova pretendimin e Komisioneres Publike në ankim, lidhur me këto të ardhura.

31. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues nuk e gjeti të bazuar as pretendimin e subjektit të rivlerësimit për përfshirjen e këtyre të ardhurave në analizën financiare, pasi:

³⁵ Në faqen 37 të vendimit të Komisionit.

³⁶ Paragrafët 42 dhe 46 i vendimit të Komisionit.

31.1. Personi i lidhur nuk ka deklaruar në deklaratën e rivlerësimit të ardhurat e pretenduara se janë krijuar nga shitja e pjesës takuese në fabrikën e përpunimit të ullirit në vitin 1997, në asnjë formë, në rubrikën e dedikuar kësaj kategorie, si dhe as i ka përmendur ato si burim për krijimin e pasurive. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë vlerën e tyre për herë të parë, në një fazë të avancuar të procesit të rivlerësimit vetëm në përgjigje të pyetësorit nr. 2, gjatë hetimit administrativ në Komision.

31.2. Personi i lidhur nuk ka qartësuar ekzistencën e këtyre të ardhurave, në përputhje me detyrimet e ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin e pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), kur subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarimin e interesave para fillimit të detyrës të dorëzuar në vitin 2009. Trupi gjykues nuk e gjen të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se personi i lidhur nuk kishte detyrimin ligjor për t’i deklaruar të ardhurat e përfituara në vitin 1997, për sa kohë në deklaratën para fillimit të detyrës dhe në ato periode kërkohet të deklarohen vetëm të ardhurat aktuale, pra, të atij momenti kur plotësohet deklarata. Trupi gjykues vlerësoi se në përputhje me detyrimet ligjore dhe kërkesat e formularit të deklarimit para fillimit të detyrës, personi i lidhur (dhe subjekti i rivlerësimit) kishte detyrimin të deklaronte këto të ardhura të pretenduara të përfituara në vitin 1997, si pasuri e akumuluar në vite, në formën e likuiditeteve në *cash* apo si burim krijimi për pasuritë. Këto të ardhura nuk gjenden të deklaruara në asnjë formë, as në deklaratat periodike të interesave, në vitet vijuese.

32. Në kushtet e mësipërme, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të ardhurat e pretenduara në shumën 3.381.700 lekë, përfutur nga personi i lidhur prej shitjes së pjesës takuese në fabrikën e përpunimit të ullirit në Vlorë, në vitin 1997. Këto të ardhura mbetën në nivel deklarativ në drejtim të ekzistencës së tyre si likuiditete në *cash* në momentin e krijimit të pasurive, për shkak të mosdeklarimit të tyre në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës dhe në ato periode në vite dhe vetëm ky fakt është i mjaftueshëm për të mos i përfshirë ato në analizën financiare.

33. Gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, subjekti i rivlerësimit ngriti pretendime lidhur me të ardhurat e realizuara prej saj nga aktiviteti i saj si avokate për periudhën 2004-2006, si dhe kursimet në *cash* të krijuara nga të ardhurat e saj si rrjedhojë e punësimit si gjyqtare për periudhën 1995-2002, për të cilat ka parashtruar se nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni në analizën financiare.

33.1. Në analizë të këtyre pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se Komisioni, në vendim, ka konkluduar se: *29.5.7 Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se rezulton e provuar se subjekti ka ushtruar profesionin e avokatit për periudhën 2004-2006, duke përfutur edhe të ardhura, të cilat i ka deklaruar gjithashtu në deklaratën e interesave të vitit 2004 të ardhura nga avokatia në vlerën 1.000.000 lekë. Por, duke qenë se subjekti e ka ushtruar profesionin e avokatit i paregjistruar në organet tatimore, por vetëm duke pasur një licencë për ushtrimin e profesionit të avokatit, këto të ardhura nuk mund të përfshihen në analizën financiare. [...] 29.10.2. Komisioni hartoi analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për periudhën 1995-2002, për të hetuar mundësinë e saj për të kursyer vlerën 400.000 lekë, të deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 si depozitë kursimi. Nga analiza rezultoi se subjekti ka pasur mundësi të kursejë vlerën 400.000 lekë, të deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2003. [...] 29.11 Komisioni në analizë të provave të administruara gjatë hetimit dhe deklarimeve në seancë dëgjimore, çmon se: Nga*

analiza financiare subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kursimeve cash dhe rrjedhimisht edhe të llogarisë bankare. Kjo llogari bankare është mbyllur në datën 04.04.2006, e cila përkon me pagesën e dytë të apartamentit objekt analize. Subjekti nuk ka kryer asnjë investim tjetër gjatë kësaj periudhe, si dhe në mbështetje të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji vlerëson se pasaktësitë në deklarimet periodike, të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se kursimet cash të subjektit do të mbahen në konsideratë në analizë financiare në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

33.2. Në konkluzionet përfundimtare, subjekti i rivlerësimit argumentoi pretendimet e saj, duke parashtruar se është e vërtetë që nuk ka qenë e regjistruar në organet tatimore, por ndërkohë ka ushtruar profesionin e avokatit, e pajisur me licencën e avokatisë të rinovuar çdo vit dhe i ka vënë në dispozicion Komisionit rreth 167 vendime gjyqësore, të cilat vërtetojnë pjesëmarrjen si avokate e njëres prej palëve në gjykim, për periudhën 2004-2006. Sipas subjektit të rivlerësimit, nëse për secilën çështje gjyqësore llogaritet një shpërblim përfaqësimi minimalisht prej 30.000 lekësh, për periudhën 2004-2006, rezultojnë të ardhura të realizuara prej saj, minimalisht në shumën prej 5.010.000 lekësh. Duke qenë e vetëdijshme për mospagimin e detyrimeve tatimore, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kolegji që të konsiderojë se të gjitha shpenzimet e jetesës për këtë periudhë janë përballuar me të ardhurat nga aktiviteti si avokate.

33.3. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, në konkluzionet përfundimtare, mbajti qëndrimin se të ardhurat e pretenduara se janë realizuar nga aktiviteti si avokate për periudhën 2004-2006, nuk duhen përfshirë në analizën financiare, pasi nuk konfirmohen nga organet tatimore.

33.4. Në analizë të dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues vëren se vendimet gjyqësore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit krijojnë besueshmërinë për ofrimin prej saj të shërbimit të avokatisë dhe, rrjedhimisht, mund të prezumohet dhe përfitimi i të ardhurave, por ajo nuk ka arritur të provojë masën e të ardhurave të përfituara. Ashtu siç edhe vetë subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar, nuk ka paguar detyrimet tatimore për këtë shërbim. Trupi gjykues nuk e vlerësoi relevant pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk kishte paguar detyrimet tatimore për këtë periudhë, për shkak të situatës së veçantë në pritje për t'u rikthyer në detyrën e gjyqtarës, pasi në të njëjtat kushte subjekti i rivlerësimit ndodhej edhe në vitin 2007 kur u regjistrua në organet tatimore dhe filloi të paguante detyrimet përkatëse fiskale për të ardhurat e realizuara nga aktiviteti si avokate. Në këto kushte, trupi gjykues, duke konfirmuar qëndrimin e Komisionit në vendim dhe atë të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme gjatë gjyqimit në Kolegji, vlerësoi se të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, në vlerën prej 5.010.000 lekësh, si të përfituara nga aktiviteti si avokate në periudhën 2004-2006, nuk përmbushin kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, për t'u konsideruar të ardhura të ligjshme në kuadër të këtij procesi. Për rrjedhojë, trupi gjykues nuk e gjeti të drejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit për të konsideruar në analizën financiare se të gjitha shpenzimet e jetesës për këtë periudhë janë përballuar prej saj me të ardhurat e realizuara nga ky aktivitet.

33.5. Sa i përket pretendimit lidhur me kursimet në cash të krijuara nga të ardhurat si rrjedhojë e punësimit si gjyqtare për periudhën 1995-2002, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në

konkluzionet përfundimtare se ajo ka pasur mundësi të kursejë nga të ardhurat nga puna si gjyqtare, shumën prej 1.417.209 lekësh, të dokumentuara në llogarinë bankare në Raiffeisen Bank. Në vijim të pretendimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se ka hapur një llogari bankare në vitin 2003 në shumën 400.000 lekë dhe kjo llogari deri në vitin 2005 ka pasur një vlerë prej 1.417.209 lekësh. Subjekti i rivlerësimit e ka konsideruar si një pakujdesi mosdeklarimin prej saj të kursimeve në *cash*, në vitin 2004, e cila ka ardhur si pasojë e faktit që kishte disa vjet e shkëputur si gjyqtare dhe nuk e kanë orientuar se si duhej bërë deklarimi i pasurisë.

33.6. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, lidhur me pretendimin e mësipërm, në konkluzionet përfundimtare, mbajti qëndrimin se kursimet e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit se janë realizuar nga të ardhurat si gjyqtare për periudhën 1995-2002 nuk duhen përfshirë në analizën financiare, pasi në deklaratat periodike 2003 dhe 2004, ajo nuk ka deklaruar kursime në *cash* me burim këto të ardhura, përveç kursimeve në llogarinë bankare në shumën 400.000 lekë.

33.7. Trupi gjykues, në verifikim të deklarimeve të pasurisë të dorëzuara pranë ILDKPKI-së për vitin 2003 dhe 2004, vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime në *cash* nga të ardhurat nga paga si gjyqtare. Kursimet e vetme të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit janë ato në formën e depozitës bankare të çelur në vitin 2003 në Bankën e Kursimeve, në shumën 400.000 lekë, e cila nga kontrolli i kryer nga Komisioni ka rezultuar se mund të krijohej me burime të ligjshme financiare. Mungesa e deklarimit të gjendjeve në *cash* në deklaratat e pasurisë së vitit 2003 dhe vitit 2004, vlerësohet nga trupi gjykues si një e dhënë që afekton besueshmërinë e krijimit të depozitave bankare në vitin 2005 në vlerën e referuar nga subjekti i rivlerësimit në fund të procesit, me burim financiar krijimi nga gjendjet në *cash* të pretenduara se janë poseduar prej saj si kursime nga pagat si gjyqtare, e që kanë shërbyer për të paguar këstin e dytë për blerjen e pasurisë “apartament”. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjeti të drejtë pretendimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, për të përfshirë në analizën financiare vetëm shumën prej 400.000 lekë, si kursim i deklaruar, i realizuar nga subjekti i rivlerësimit me burime të ligjshme nga të ardhurat si gjyqtare, për periudhën 1995-2002.

34. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, mbi konkluzionet e arritura nga arsyetimi si më sipër, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme pagesat për blerjen e pasurisë “apartament banimi me sipërfaqe 111,6 m²”, në Vlorë dhe shpenzimet e investimet e kryera, për periudhën 2005-2007, në shumën totale prej (-) 7.899.161 lekësh, duke u gjendur në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

35. Në lidhje shkaku ankim, sipas së cilit, *për pasurinë “likuiditetet në cash”, subjekti i rivlerësimit edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme*, trupi gjykues konstatoi dhe analizoi si më poshtë.

35.1. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, personi i lidhur ka deklaruar: *Likuiditete cash në vlerën 10.000 euro (shuma e mbetur pas vjedhjes së banesës në datën 04.08.2016). Pjesa takuese: 100%. Vlera: 52.000 euro dhe 100.000 lekë, e vjedhur në datën 04.08.2016. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: Të ardhura nga aktiviteti privat dhe shitja e një restoranti të ndodhur në Itali në vitin 2004.*

35.2. Nga analizimi i deklarimeve periodike të interesave, trupi gjykues konstatoi se në lidhje me pasurinë objekt kontrolli “gjendje e likuiditeteve në cash”, subjekti i rivlerësimit dhe

personi i lidhur kanë deklaruar, në rubrikën “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, si vijon.

- o Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, dorëzuar në ILDKPKI në datën 05.03.2009³⁷, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: *Kursime dhe kambiale. Burimi i krijimit: Të ardhura nga aktiviteti privat dhe shitja e një restoranti të ndodhur në Itali. Vlera: 70.000 euro. Pjesa takuese: 100%.*

- o Në deklaratat periodike të interesave për periudhën 2009-2012, *nuk janë deklaruar likuiditete në cash.*

- o Në deklaratën e interesave të vitit 2013, personi i lidhur ka deklaruar: *Pakësuar kursimet në vlerën 8.000 euro.*

- o Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kursime nga pagat (gjendje cash) 600.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.*

- o Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2015, *nuk deklarohen likuiditete në cash.*

- o Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2016, personi i lidhur, z. B. V., ka deklaruar: *Pakësuar likuiditeti cash (pas vjedhjes së banesës në datën 04.08.2016). Burimi i krijimit: Të ardhura nga aktiviteti privat dhe shitja e një restoranti të ndodhur në Itali në vitin 2004. Vlera: 52.000 euro. Pjesa takuese: 100%.*

35.3. Në datën 24.02.2015, në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *ka pasur gjendje cash shumë 62.000 euro në fund të vitit 2013 dhe të njëjtën gjendje disponon edhe në momentin e dhënies së këtyre shpjegimeve.*

35.4. Komisioni, për të vlerësuar mbulimin me burime të ligjshme të këtyre kursimeve në cash, ka kryer analizën financiare paraprake, nga ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë qenë në pamundësi financiare në vlerën (-) 13.134.814 lekë, për krijimin e gjendjes së kursimeve në cash, si dhe të pasurive të tjera të deklaruara në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2009, ku përfshihen dhe dy huadhënie, përkatësisht, hua në shumë 17.000 euro dhënë znj. E. G. dhe hua në shumë 3.000.000 lekë dhënë z. M. V..

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, si vijon: “Duket se subjekti i rivlerësimit ka pamundësi financiare në vlerën (-) 13.134.814 lekë, për krijimin e gjendjes së kursimeve në cash të deklaruara në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2009³⁸. [...]. Duket se subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur pamundësi financiare për të krijuar gjendjen e kursimeve në cash prej 70.000 eurosh (ose rreth 9.601.900 lekë) në vlerën totale të tyre, pra (- 9.601.900 lekë), të deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës”.

Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka deklaruar se: *Në lidhje me këtë barrë prove, [...], gjatë këtij hetimi administrativ kam provuar: të ardhurat e bashkëshortit nga punësimi në Itali për periudhën 1996-2005, në vlerën 36.185 euro; të ardhurat e bashkëshortit nga shitja e restorantit në Itali në vlerën 65.800 euro, sikurse pretendon Komisioni dhe në vlerën 104.000 euro, pra 80% të shumës, sikurse pretendohet nga*

³⁷ Deklarim i bërë nga subjekti i rivlerësimit pas rikthimit në detyrën e gjyqtarës.

³⁸ Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ (faqja 36), ka evidentuar se balanca negative ka rezultuar pasi në këtë analizë nuk janë përfshirë: Në këtë analizë nuk janë përfshirë: të ardhurat e përfituara nga marrëveshja nr. {***} rep., datë 01.02.1997, në shumë 3.178.000 lekë; të ardhurat e përfituara gjatë periudhës 2004-2009 nga shitja e aktivitetit në Itali në vlerën totale 65.800 euro; të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit të përfituara nga avokatia në shumë 6.000.000 lekë, pasi ato janë konsideruar në vlerën 4.578.160 lekë; të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit pranë subjektit tregtar P. M. me vlerë totale 3.250.000 lekë gjatë periudhës 01.10.2007-31.12.2010.

ana ime; të ardhurat e bashkëshortit të përfituara nga shitja e pjesës takuese në fabrikën e përpunimit të ullirit, {***}, Vlorë, në vlerën 3.381.700 lekë; të ardhurat e bashkëshortit të përfituara nga bashkëpunimi me Person Fizik “P. M.”, në vlerën 3.250.000 lekë; të ardhurat e bashkëshortit nga punësimi pranë Person Fizik “E. B.” dhe shoqërisë “{***}” ShPK, në vlerën 3.160.000 lekë; të ardhurat nga punësimi i subjektit të rivlerësimit për periudhën 1995 - 2002, të depozituara në llogari bankare në vlerën 1.417.209 lekë; të ardhurat e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit të përfitur nga avokatia për periudhën 2004 - 2006, në shumën 1.000.000 lekë; të ardhurat e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit të përfituara nga avokatia për periudhën 2007 - 2009, në shumën 6.000.000 lekë. Të gjitha këto të ardhura të marra së bashku provojnë se bashkëshorti im ka pasur mundësi për të krijuar kursimet në cash, në shumën 70.000 euro.

35.5. Komisioni, pasi ka shqyrtuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, në vendim, ka arsyetuar se ka llogaritur marzhin e fitimit nga aktiviteti i avokatisë së subjektit të rivlerësimit në masën 90%, si dhe ka konsideruar të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit të deklaruar nga aktiviteti “ristorator” në tri subjektet tregtare, për periudhën 2005-2011, duke i përfshirë në analizën financiare në vlerën 6.410.000 lekë. Në vijim të arsyetimit, Komisioni, në vendim³⁹, ka konkluduar se: [...]në analizën financiare të burimit të ligjshëm të shumës 70.000 euro në vitin 2009 janë të ardhurat nga shitja e aktivitetit të bashkëshortit në Itali, [...] që do të vlerësohen në tërësi lidhur me kriterin e rivlerësimit të pasurisë. Janë pikërisht këto të ardhura që pasqyrojnë pamjaftueshmërinë në analizën financiare, në vlerën totale të likuiditetit.

Lidhur me rezultatet e analizës financiare, Komisioni, ndër të tjera, ka arsyetuar në vendim⁴⁰ se: [...] në përputhje me arsyetimin e bërë në këtë vendim, duke realizuar një analizë financiare, ku të ardhurat e bashkëshortit nga shitja e shoqërisë “{***}” S.N.C., pavarësisht se nuk janë konsideruar nga trupi gjykues si të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, duke qenë se ato nuk mund të jenë penalizuese në procesin e rivlerësimit të subjektit, analiza financiare e subjektit rezulton me një bilanc për periudhën shkurt 2009 – 2016, me vlerë negative (-) 152.147 lekë. Ndërsa, analiza përpara fillimit të deklarimit të vitit 2009 rezulton me pamundësi financiare në vlerën (-) 11.902.960 lekë. [...] mungesa e burimeve të ligjshme që rezulton nga analiza financiare e kryer, duke mos përfshirë të ardhurat e bashkëshortit nga shitja në vitin 2004 të shoqërisë “{***}” S.N.C., nuk duhet të konsiderohet si një rrethanë që e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59, pika 1 të ligjit nr. 84/2016.

35.6. Në kundërshtim të konkluzionit të Komisionit, Komisionerja Publike, në ankim, ka parashtruar se ndan qëndrim të ndryshëm dhe vlerëson se pamjaftueshmëria e rezultuar nga analiza financiare bën që subjekti i rivlerësimit të mos arrijë një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, për efekt të këtij procesi. Komisionerja Publike ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit edhe pas kalimit të barrës së provës nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme të konstatuar nga Komisioni. Komisionerja Publike, në konsideratë të shkaqeve të ankimit lidhur me të ardhurat e pretenduara nga subjekti i

³⁹ Paragrafi 38 i vendimit të Komisionit.

⁴⁰ Paragrafi 40 i vendimit të Komisionit.

rivlerësimit dhe personi i lidhur, ka vlerësuar se pamjaftueshmëria e konstatuar nga vetë Komisioni, por e konsideruar pa efekt penalizues në këtë proces, afekton jo vetëm kursimet *cash*, por edhe pasuritë e tjera.

35.7. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, gjatë gjykimit në Kolegj, konfirmoi qëndrimin e Komisioneres Publike, si sipëranalizuar, duke vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me kursimet në *cash* dhe ndodhet në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

35.8. Subjekti i rivlerësimit, gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj, lidhur me burimet e krijimit të likuiditeteve në *cash* në shumën prej 70.000 eurosh, mbajti të njëjtin qëndrim sikurse gjatë hetimit administrativ në Komision, duke parashtruar se gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, u provuan të ardhurat nga shitja e pasurisë në Vlorë, në vlerën 3.381.700 lekë; të ardhurat nga shitja e shoqërisë “{***}” S.N.C., në vlerën 104.000 euro ose 12.744.160 lekë; të ardhurat nga mundësia për kursim në shumën 36.185 euro ose në vlerën 4.434.109,9 lekë; të ardhurat nga punësimi si “ristorator” në vlerën 5.400.000 lekë; kursimet *cash* të krijuara nga të ardhurat nga punësimi i subjektit të rivlerësimit për periudhën 1995 - 2002, të depozituara në Raiffeisen Bank, në vlerën 1.417.209 lekë; të ardhurat nga avokatia në periudhën 2004 - 2006, në vlerën 1.000.000 lekë ose më së paku të mbulimit të shpenzimeve të jetesës me këto të ardhura; të ardhurat nga avokatia për periudhën 2007 - 2009, në vlerën 4.876.680 lekë. Sipas subjektit të rivlerësimit, analiza financiare e periudhës 1995-01.03.2009 vërteton se ajo dhe bashkëshorti kanë pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, pasi balanca pozitive rezulton në shumën prej 6.723.441 lekësh.

36. Në analizë të shkakut të ankimit, në raport me situatën faktike të konstatuar në lidhje me pasurinë “likuiditetet në *cash* në vlerën 70.000 euro”, të deklaruar pas rikthimit në detyrë në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2009, si dhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit si burim krijimi për pasurinë “likuiditetet në *cash* në shumën 10.000 euro”, trupi gjykues nënvizon përfundimin e arritur më sipër në këtë vendim, sipas së cilit nga të ardhurat e pretenduara të përfituara nga personi i lidhur nga shitja e shoqërisë “{***}” S.N.C. në vitin 2005, vetëm vlera prej 18.010 eurosh ose prej 2.241.747 lekësh plotësoi kushtet për t’u konsideruar si e ardhur e ligjshme në kuptim të standardeve kushtetuese e ligjore të këtij procesi, ndërsa të ardhurat, në shumën totale prej 21.959 eurosh, referuar transferimeve të urdhër xhirimeve në llogarinë bankare të z. V., për periudhën 2006-2008, si pagesa për shitjen e së njëjtës shoqëri, nuk plotësuan kushtet për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme në zbatim të përcaktimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Edhe të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga aktiviteti “ristorator” i personit të lidhur, për periudhën 2005-2011, në vlerësim të trupit gjykues nuk plotësuan kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, ndaj ato nuk u përfshinë në analizën financiare, për verifikimin e mundësisë së krijimit të kursimeve të deklaruar në *cash*, në shumën prej 70.000 eurosh ose 9.601.900 lekësh⁴¹. Në këtë arsyetim, trupi gjykues u ndal në përfundimet e arritura si sipërcituar, referuar burimit financiar të krijimit të likuiditetit në *cash*, të deklaruar nga personi i lidhur pas rikthimit në detyrë të subjektit në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2009, si dhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.

⁴¹ Llogaritur sipas kursit mesatar të këmbimit valutor të Bankës së Shqipërisë, për vitin 2009, të monedhës 1 euro=137.17 lekë.

36.1. Në funksion të verifikimit të mundësisë së personit të lidhur dhe subjektit të rivlerësimit për të financuar me burime të ligjshme pasurinë objekt kontrolli, trupi gjykues kreu analizën financiare për të identifikuar mundësinë e tyre për të kursyer likuiditetet e deklaruar. Në këtë analizë, e cila u krye mbi kontrollin e analizës së kryer prej Komisionit, u reflektuan konkluzionet e sipërcituara, lidhur me të ardhurat e personit të lidhur. Analiza u shtri, ashtu si edhe nga Komisioni, për periudhën 2005- janar 2009. Trupi gjykues nuk konsideroi në këtë analizë: (i) të ardhurat në shumën 3.381.700 lekë, të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit se ishin përfituar nga personi i lidhur prej shitjes së pjesës takuese në fabrikën e përpunimit të ullirit në Vlorë, në vitin 1997; (ii) kursime të personit të lidhur nga puna si emigrant në shtetin italian; si dhe (iii) të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, në vlerën prej 5.010.000 lekësh, si të përfituara nga aktiviteti si avokate në periudhën 2004-2006.

Nga analiza financiare e kryer sipas metodologjisë së mësipërme, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me diferencë negative të mbulimit të investimeve, kursimeve dhe shpenzimeve me të ardhura të ligjshme në shumën (-) 19.008.341 lekë.

37. Në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues arriti në konkluzionin se është i drejtë pretendimi i Komisioneres Publike dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare për të krijuar pasurinë “likuiditet gjendje cash”, në vlerën e plotë prej 70.000 eurosh ose 9.601.900 lekësh. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme, në vlerën e plotë të pasurisë “likuiditet cash në shumën 10.000 euro”, të deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe, për pasojë, gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
38. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas së cilit, Komisionerja Publike ka vlerësuar se *subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me shumën 17.000 euro dhënë hua znj. E. G. dhe si rezultat ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë automjet tip “Daimler Chrysler C270 CDI”, që deklarohet me burim krijimi kthimin e kësaj huaje*, trupi gjykues konstatoi dhe analizoi si vijon.

38.1. Komisioni, në vendim⁴², lidhur me pasurinë objekt shkaku ankimi, ka konkluduar: *Komisioni çmon se, në vlerësimin e tij lidhur me pasojat e diferencës negative në krijimin e kësaj pasurie, merr në konsideratë faktin se burimi i krijimit të saj janë të ardhurat e personit të lidhur, të cilat edhe pse nuk kalojnë testin e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nuk mund të jenë penalizuese në procesin e rivlerësimit të subjektit, pasi janë krijuar kohë më parë se ata të fillonin jetën bashkëshortore, janë të ardhura të provuara nëpërmjet akteve noteriale, nuk janë produkt i një veprimtarie të paligjshme, si dhe subjekti nuk ka qenë në dijeni të përdorimit të të ardhurave për të cilat nuk ishin shlyer detyrimet tatimore. Për pasojë, kjo pamundësi do të vlerësohet në vlerësimin tërësor të pasurisë.*

38.2. Komisionerja Publike nuk ka ndarë qëndrim të njëjtë me Komisionin, lidhur me ligjshmërinë e huas në shumën 17.000 euro, deklaruar si burim krijimi për pasurinë “Automjet tip Daimler Chrysler C270 CDI” (në vijim pasuria “automjet”), duke argumentuar se:

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e vitit 2009, kthimin e huas nga motra e saj në shumën 17.000 euro dhe as burimin e krijimit të pasurisë “automjet”;

⁴² Paragrafi 32.6 i vendimit të Komisionit.

ii. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të provojnë mbulimin me burime të ligjshme të pasurive të krijuara para vitit 2009, përfshirë këtu dhe kursimin e shumë 17.000 euro të deklaruar si të dhënë hua znj. E. G.;

iii. Referuar deklaratës noteriale të datës 02.03.2015, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit dhe motra e saj, ku deklarohet kthimi i huas në shumën 17.000 euro në qershor të vitit 2009, rezulton se kjo deklaratë është hartuar disa ditë mbas mbajtjes së procesverbalit pranë ILDKPKI-së (më 24.02.2015) dhe 6 vite pas kthimit të pretenduar të huas, duke krijuar bindjen se është hartuar gjatë kontrollit nga ILDKPKI-ja, për të provuar se subjekti i rivlerësimit kishte të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë “automjet” për shumën rreth 12.592 euro në datën 24.06.2009.

38.3. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtime ka konfirmuar qëndrimin e Komisioneres Publike dhe në konkluzionet përfundimtare ka parashtuar se edhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e shkakut të ankimit lidhur me mbulimin me burime të ligjshme të kësaj huaje dhe si rezultat mbeti i paprovuar mbulimi me burime të ligjshme edhe i pasurisë “automjet”. Në përfundim, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për pasurinë “automjet”, që deklarohet me burim krijimi kthimin e huasë në shumën 17.000 euro.

38.4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, ka prapësuar shkakun e ankimit, duke mbajtur të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit administrativ, duke parashtuar se ajo dhe bashkëshorti kanë pasur të ardhura të ligjshme për dhënien e huasë znj. E. G.. Mosdeklarimi i kthimit të huasë në deklaratën e interesave të vitit 2009 ka qenë një pakujdesi, pasi ka menduar se duke qenë se ka deklaruar dhënien e huasë nuk ka qenë e nevojshme të deklarohej kthimi i saj. Sipas subjektit të rivlerësimit kjo pakujdesi është korrigjuar prej saj në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së në datën 25.02.2015, kohë përpara miratimit të ligjit nr. 84/2016, si dhe është deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit e, në këto kushte, nuk mund të jetë penalizuese për këtë proces.

- 39.** Në shqyrtim të pretendimeve të Komisioneres Publike e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, prapësimeve të subjektit të rivlerësimit për to, si dhe pasi analizoi aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi sa më poshtë.

39.1. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Autoveturë “Daimler Chrysler, C270 CDI”, blerë më 24.06.2009, 9.100 euro, detyrimi doganor 479.000 lekë. Burimi i krijimit: Me të ardhura të kursyera gjatë viteve, të cilat i janë dhënë hua shtetases E. G. në vitin 2008 dhe kthyer prej saj në vitin 2009. Pjesa takuese: 50%”*.

Bashkëlidhur kësaj deklarate, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 16.03.2009, e nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit dhe znj. E. G., në të cilën kanë deklaruar se kanë hyrë në një marrëdhënie huaje, pasi znj. Mirela Mishgjoni i ka dhënë motrës së saj znj. G. shumën 17.000 euro, në datën 12.07.2008, me qëllim rikonstrukcionin e banesës së kësaj të fundit. Huaja është në mirëbesim, pa interes dhe shlyerja e saj do të kryhej sipas mundësive të huamarrëses.

39.2. Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, dorëzuar në ILDKPKI në datën 05.03.2009⁴³, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Dhënë hua një personi fizik në 12 korrik*

⁴³ Deklarim i bërë nga subjekti i rivlerësimit pas rikthimit në detyrën e gjyqtarës.

2008. Vlera: 17.000 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: Të ardhura nga aktiviteti si avokate dhe aktiviteti ristorator i bashkëshortit”. Ndërsa në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” të së njëjtës deklarate, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Dhënë hua motrës E. G., datë 12.07.2008”.

39.3. Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë “automjet”, por pa deklaruar burimin financiar të krijimit. Në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar as kthimin e huasë nga znj. E. G..

39.4. Në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, sipas procesverbalit të datës 24.02.2015, në lidhje me këtë hua, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] Kam dokument ligjor që provon huadhënien, likuiditet i dhënë në vitin 2008, të cilin po e paraqes. Lekët i mora në vitin 2009 dhe i kam përdorur për blerje automjeti në atë vit dhe nevoja të ndryshme. Do të paraqes edhe deklaratë noteriale që vërteton shlyerjen e detyrimit [...].

39.5. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, për të provuar pretendimet e saj lidhur me huan e dhënë motrës së saj në shumën 17.000 euro, ka paraqitur në Komision dokumentacionin: (i) kontrata në gjuhën gjermane, datë 24.06.2009, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë blerë pasurinë “automjet” në vlerën 9.100 euro; (ii) mandatpagesa e datës 26.06.2009, për pagesën e detyrimeve doganore në vlerën 477.527 lekë; (iii) deklarata noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.03.2009, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit dhe znj. E. G., të cilat deklarojnë se znj. Mirela Mishgjoni i ka dhënë motrës së saj hua pa interes në shumën prej 17.000 eurosh më datë 12.07.2008, me qëllim rikonstrukcionin e banesës së kësaj të fundit; (iv) deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.03.2015, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit dhe znj. E. G., në të cilën deklarueset konfirmojnë se shuma 17.000 euro është likuiduar në qershor të vitit 2009 nga znj. G..

40. Në analizë të shkakut të ankimit dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit për to, dhënë gjatë gjykimit në Kolegj, trupi gjykues u mbështet në konkluzionet e përshkruara më sipër në këtë vendim, në drejtim të burimeve të ligjshme të deklaruara në deklaratën e rivlerësimit se janë përdorur për financimin e shumës prej 17.000 eurosh ose 2.094.103 lekë⁴⁴ dhënë hua znj. E. G., konkretisht të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga aktiviteti si avokate dhe të ardhurat e personit të lidhur nga aktiviteti “ristorator”.

Trupi gjykues kreu analizën financiare për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin e saj për periudhën 2005-12.07.2008, datë e dhënies së huasë, nga e cila rezultoi një balancë negative prej (-) 18.835.540 lekësh, që dëshmon se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kishin mundësi të mbulimit të investimeve, kursimeve dhe shpenzimeve me të ardhura të ligjshme.

41. Në përmbledhje të arsytimit si më lart, në funksion të dhënies përgjigje të pretendimeve të parashtruara në ankim, duke analizuar faktin e mungesës së burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për të justifikuar krijimin e kursimeve e, për pasojë, edhe dhënien e huasë në vlerën e plotë prej 2.094.103 lekësh, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme financiare për blerjen e pasurinë “automjet tip “Daimler Chrysler C270 CDI””, në vitin 2009, në vlerën e plotë të saj prej 12.592 eurosh ose (-) 1.727.245 lekësh, si një pasuri e financuar nga kthimi i huasë. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjeti të drejtë pretendimin e Komisioneres Publike dhe të Drejtuesit

⁴⁴ Vlera e përlllogaritur nga Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ.

të Prokurorisë së Posaçme se për pasurinë “automjet tip “Daimler Chrysler C270 CDI”” subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e saj, në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

42. Sa i përket shkakut të ankimit, sipas së cilit *pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme e konstatuar nga vetë Komisioni, por e konsideruar pa efekt penalizues në këtë proces, afekton jo vetëm kursimet cash, por edhe pasuritë e tjera të krijuara deri në vitin 2009, përfshirë edhe huan në shumën 3.000.000 lekë, deklaruar si burime krijimi për pasurisë “apartament me sipërfaqe ndërtimi 134.5 m², ndodhur në Tiranë, trupi gjykues konstatoi dhe analizoi si vijon.*

42.1. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, personi i lidhur ka deklaruar: *Depozitë, Banka Credins, krijuar më 20.07.2016. Vlera: 9.004,38 euro. Pjesa takuese: 100%. Llogari rrjedhëse në Banka Credins, krijuar në datën 23.01.2017, pas transferimit të llogarisë nga Banka Kombëtare Tregtare, llogari e krijuar në datën 04.05.2016. Vlera: 1.887.300 lekë. Pjesa takuese: 100%.*

Burim krijimi për të dyja llogaritë bankare të mësipërme është deklaruar: Të ardhura të krijuara gjatë viteve të emigracionit, lënë në administrim shtetasit M. V. dhe kthyer prej këtij të fundit.

42.2. I njëjti deklaram është bërë nga personi i lidhur edhe në deklaratën periodike të interesave të vitit 2016.

42.3. Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës të vitit 2009, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, në seksionin “Të dhënat për personat fizikë dhe juridikë, përfshirë edhe personat e besuar”, personi i lidhur ka deklaruar: *“M. Sh. V., i ati. Lloji i interesit: Huadhënie, lagjja “{***}”, Vlorë”.*

42.4. Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2020, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Kontratë sipërmarrje për prenotim apartamenti nr. {***}/{***}, datë 16.06.2020, me sipërfaqe ndërtimi 134,5 m² dhe sipërfaqe e përbashkët 22,2 m², në Tiranë. Vlera: 161.401 euro. Pjesa takuese: 50%. Në funksion të pagesës së këtij apartamenti kemi shlyer në datën 18.06.2020, shumën 13.667.500 lekë (konvertimi i shumës 110.000 euro) për pagesën e së cilës është përdorur depozita e kursimit pranë Credins Bank në shumën 9.765.339 lekë, plus shuma 747.529 lekë (që janë interesa bankare të kësaj depozite gjatë tre viteve), plus shuma 608.553 lekë (që janë konvertimi në lekë i 4.927,56 euro të ndodhura në llogarinë rrjedhëse të bashkëshortit B. V. pranë Credins Bank), plus shuma 2.170.000 lekë (transferuar nga llogaria ime e pagës pranë Tirana Bank,) plus shuma 376.100 lekë (të transferuara nga llogaria në lekë e Personit Fizik “B. V.” pranë Credins Bank). Në datën 22.12.2020, kemi shlyer shumën 20.000 euro për pagesën e së cilës janë përdorur të ardhurat e realizuara nga aktiviteti tregtar i Personit Fizik “B. V.”. Në datën 30.12.2020 kemi shlyer shumën 6.000 euro për pagesën e të cilës janë përdorur të ardhurat nga paga ime”.*

42.5. Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.07.2016, të deklaruesve B., M., Y. dhe Xh. V.. Në këtë akt deklarohet se z. Y. V., znj. Xh. V. dhe bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit kanë qenë në emigrim në Itali dhe të gjitha kursimet e tyre nga emigrimi ia kanë lënë në ruajtje dhe në administrim z. M. V. (babai i z. Y. dhe z. B. V.). Z. M. V. nga kursimet e dy djemve të tij, duke marrë dhe aprovimin e z. B. V., i ka dhënë shumën 3.000.000 lekë z. Y. V. për qëllime shëndetësore dhe për shkollimin e fëmijëve, shumë e cila i është kthyer bashkëshortit të

subjektit të rivlerësimit, në periudha të ndryshme nëpërmjet derdhjes së shumave në llogarinë bankare, si dhe nëpërmjet pagesës *cash* në zyrën e noterit.

42.6. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, në vendim⁴⁵, ka arritur në konkluzionin se bazuar në prova dhe fakte subjekti i rivlerësimit ka kryer një deklaram të saktë lidhur me këtë marrëdhënie huaje.

43. Konkluzioni i mësipërm i Komisionit është kundërshtuar nga Komisionerja Publike, e cila në argumentimin e shkakt të ankimit ka parashtruar se në deklaratën periodike të interesave të vitit 2020⁴⁶, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes për prenotimin e një apartamenti me sipërfaqe ndërtimi 134,5 m² dhe sipërfaqe e përbashkët 22,2 m², në Tiranë (në vijim “apartament në Tiranë”), në vlerën 161.401 euro. Sipas Komisioneres Publike, pjesë e burimeve që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë së sipërcituar është dhe huaja e kthyer nga babai i bashkëshortit në vitin 2016 (rreth 3.000.000 lekë), deklaruar si huadhënie në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2009 [pas rikthimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit], për të cilën sikurse trajtuar më sipër, Komisioni ka konstatuar pamjaftueshmëri.

43.1. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime, konfirmoi qëndrimin e Komisioneres Publike si më sipëranalizuar, ndërsa në konkluzionet përfundimtare shtoi se aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, referojnë të ardhura të realizuara prej saj dhe personit të lidhur përgjatë periudhës 2019-2022 dhe nuk ndikojnë në konstatimin lidhur me huan dhënë z. M. V. në shumën 3.000.000 lekë, deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2009 dhe që pas kthimit të saj ka shërbyer si një nga burimet për krijimin e pasurisë “apartament në Tiranë”. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vlerësoi se, për sa kohë nuk provohet mbulimi me burime të ligjshme i huadhënies në shumën 3.000.000 lekë, nuk mbulohet plotësisht me burime të ligjshme edhe pasuria “apartament në Tiranë”, për të cilën si burim krijimi ka shërbyer dhe huaja e sipërcituar.

43.2. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, pretendoi se e kishte të pamundur të kryente një mbrojtje efektive, pasi nga Komisioni nuk i është kaluar barrë prove lidhur me këtë pasuri, por edhe gjatë gjykimit në Kolegj nuk i janë kërkuar shpjegime dhe nuk është kryer hetim shtesë, si dhe nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme nuk është bërë ndonjë deklaram konkret për këtë pasuri, parë e lidhur me deklaratën e rivlerësimit. Sipas subjektit të rivlerësimit, pasuria “apartament në Tiranë” është krijuar në vitin 2020 dhe, për rrjedhojë, referuar jurisprudencës së Kolegjit nuk mund të jetë pjesë e kontrollit për efekt të procesit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit, edhe pse ka konsideruar se kjo çështje nuk i përket juridiksionit të rivlerësimit për sa kohë nuk ka dyshime për deklaram të pasaktë apo të pavërtetë në deklaratën e rivlerësimit, ka pretenduar se nga Komisioni është verifikuar si huadhënia ashtu

⁴⁵ Paragrafi 39.12 i vendimit të Komisionit.

⁴⁶ Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2020, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Kontratë sipërmarrje për prenotim apartamenti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.06.2020, me sipërfaqe ndërtimi 134,5 m² dhe sipërfaqe e përbashkët 22,2 m², në Tiranë, rruga “{***}”. Vlera: 161.401 euro. Pjesa takuese: 50%. Në funksion të pagesës së këtij apartamenti kemi shlyer në datën 18.06.2020, shumën 13.667.500 lekë (konvertimi i shumës 110.000 euro) për pagesën e së cilës është përdorur depozita e kursimit pranë Credins Bank në shumën 9.765.339 lekë, plus shuma 747.529 lekë (që janë interesa bankare të kësaj depozite gjatë tre viteve), plus shuma 608.553 lekë (që janë konvertimi në lekë i 4.927,56 euro të ndodhura në llogarinë rrjedhëse të bashkëshortit pranë Credins Bank), plus shuma 2.170.000 lekë (transferuar nga llogaria ime e pagës pranë Tirana Bank, plus shuma 376.100 lekë (të transferuara nga llogaria në lekë e Personit Fizik “B. V.” në Credins Bank). Në datën 30.12.2020, kemi shlyer shumën 20.000 euro për pagesën e së cilës janë përdorur të ardhurat e realizuara nga aktiviteti tregtar i Personit Fizik “B. V.”. Në datën 30.12.2020 kemi shlyer shumën 6.000 euro për pagesën e të cilës janë përdorur të ardhurat nga paga ime”.

edhe depozita bankare, të cilat kanë rezultuar të deklaruara saktësisht dhe të bazuara në burime të ligjshme, si dhe ka paraqitur së bashku me parashtrimet të ardhurat financiare të familjes së saj për periudhën 2019-2022⁴⁷, të cilat, sipas pretendimit të saj, provojnë mundësinë për krijimin me burime të ligjshme të pasurisë “apartament në Tiranë”.

44. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues vëren se nëse pretendimet e subjektit të rivlerësimit i shqyrton në raport me shkaqet që kanë çuar Komisioneren Publike dhe Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme drejt verifikimit të pasurisë “apartament në Tiranë”, konstatohet si më poshtë.

44.1. Në llogarinë e personit të lidhur, z. B. V., në Bankën Kombëtare Tregtare, në datën 23.06.2016, transferohet shuma 2.300.000 lekë, me përshkrimin: “S. H. kalon për B. V. pagesë për blerje apartamenti nga D. L. për shitësit Y. dhe Xh. V., sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.05.2016 dhe prokurës bashkëngjitur”. Në prokurën e posaçme, datë 11.05.2016, të nënshkruar nga Y. dhe Xh. V., përcaktohet se shuma 2.300.000 lekë, e përfituar nga shitja e apartamentit, do të kalojë në llogarinë e z. B. V., në Bankën Kombëtare Tregtare. Në datën 11.07.2016, z. B. V. tërheq vlerën 410.000 lekë dhe vlera e mbetur e llogarisë prej 1.887.300 lekësh është mbajtur si depozitë kursimi deri në datën 23.01.2017, e cila më pas është transferuar në llogarinë e tij në Credins Bank⁴⁸, llogari kjo e deklaruar nga personi i lidhur në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.

Në llogarinë e personit të lidhur në Credins Bank, në datën 20.07.2016, është transferuar vlera 9.002,67 euro, nga z. M. V.⁴⁹, llogari e deklaruar nga personi i lidhur në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.

Nga sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se konfirmohet burimi i krijimit i deklaruar nga personi i lidhur për depozitat bankare të disponuara prej tij dhe të deklaruara në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit: *Të ardhura të krijuara gjatë viteve të emigracionit, lënë në administrim shtetasit M. V. dhe kthyer prej këtij të fundit.*

44.2. Në vijim të konkluzioneve të arritura më sipër në vendim, lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme të personit të lidhur për të justifikuar krijimin e kursimeve nga të ardhurat nga emigracioni, në Itali, trupi gjykues arriti në përfundimin se personi i lidhur gjendej në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme financiare për dhënien e huasë në vlerën e plotë të saj prej 3.000.000 lekësh e, për pasojë, krijimin e depozitave në Credins Bank, të deklaruara në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.

44.3. Depozitat bankare në emër të personit të lidhur, në Credins Bank, të sipëranalizuara, janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të interesave të vitit 2020 se kanë shërbyer si burim financimi për pagesën për blerjen e pasurisë “apartament banimi me sipërfaqe 134,5 m²”, në Tiranë. Lidhur me këtë pasuri, gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit

⁴⁷ Me parashtrimet e paraqitura në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka depozituar, ndër të tjera, dhe aktet e poshtëshënuara, të cilat u administruan në cilësinë e provës:

i) vërtetim nr. {***} prot., datë 18.02.2025, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, për fitimin e realizuar nga aktiviteti i Personit Fizik “B. V.”, për periudhën 2019-2022; dhe

ii) vërtetim nr. {***}, datë 18.02.2025, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, sipas së cilit Personi Fizik “B. V.”, nuk ka detyrime tatimore të papaguara.

⁴⁸ Sipas informacionit të përcjellë në Komision nga Credins Bank, me shkresë nr. {***} prot., datë 09.04.2021.

⁴⁹ Nga verifikimi i të dhënave bankare të z. M. V. rezulton se në datën 28.01.2016, në llogarinë bankare, në emër të M. V. ose N. V., në Credins Bank, është kredituar shuma prej 9.000 eurosh nga z. Y. V., me përshkrimin “Derdhje në depozitë, kthim borxhi”. Kjo shumë, në datën 20.07.2016, është transferuar në depozitën e z. B. V., pranë së njëjtës bankë.

i është përgjigjur pyetjeve/kërkesave të drejtuara nga Komisioni, në pyetësin standard dhe në pyetësin nr. 3⁵⁰. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet drejtuar Komisionit, ka listuar në mënyrë analitike pagesat e kryera për blerjen e kësaj pasurie, duke deklaruar se në datën 18.06.2020 ajo dhe personi i lidhur kanë likuiduar shumën 13.667.500 lekë (ose 110.000 euro) dhe në harkun kohor 22.12.2020-27.12.2022, shumën 51.400 euro. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni, pasi ka përshkruar deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar se nuk rezultuan problematika në lidhje me këtë pasuri. Në vendim⁵¹, Komisioni e ka përmendur pasurinë “apartament në Tiranë”, në kuadër të analizës lidhur me kontrollin e depozitave bankare në Credins Bank, të deklaruara nga personi i lidhur në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, duke konfirmuar se ato kanë shërbyer si burim krijimi për blerjen e pasurisë së paluajtshme, në datën 18.06.2020. Komisionerja Publike, në kuadër të ushtrimit të së drejtës së ankimit, nuk është pajtuar me qëndrimin e Komisionit lidhur me këto pasuri që derivojnë nga njëra-tjetra, duke e konsideruar këtë si një çështje që duhet t’i nënshtrohet gjykimit dhe vlerësimit të Kolegjit, por pa qenë nevoja e çeljes së hetimit, pasi situata faktike ka qenë e qartë dhe e konstatuar drejt nga Komisioni.

Në kushtet kur gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka dhënë deklaratime dhe ka paraqitur të dhëna lidhur me këtë pasuri, ndonëse Komisioni nuk e ka evidentuar këtë situatë si në shkelje të detyrimeve ligjore që burojnë nga ligji nr. 84/2016, Komisionerja Publike e ka renditur atë të shkaktojë që kanë shërbyer për kërkimin në ankim të vendosjen së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Subjektit të rivlerësimit nuk i është pamundësuar mbrojtja efektive për këtë shkak ankimi, pasi pretendimet e ngritura nga Komisionerja Publike lidhur me burimin e shumës prej 3.000.000 lekë kanë qenë të qarta e të bazuara në akte të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision dhe të njohura prej subjektit të rivlerësimit. Qëndrimi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme lidhur me pasurinë “apartament”, derivon nga konkluzioni i Komisionit për ligjshmërinë e të ardhurave për shumën 3.000.000 lekë, të depozituara në llogaritë bankare në Credins Bank dhe të deklaruara në deklaratën e rivlerësimit. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar.

44.4. Trupi gjykues e gjeti të pambështetur edhe pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se pasuria “apartament në Tiranë” është krijuar në vitin 2020 dhe, për rrjedhojë, referuar jurisprudencës së Kolegjit, nuk mund të jetë pjesë e kontrollit për efekt të procesit të rivlerësimit. Trupi gjykues sjell në vëmendje se Kolegji ka interpretuar në jurisprudencën e tij se analiza e shpenzimeve të kryera pas dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit mund të kishte relevancë për këtë proces në rrethana specifike. Konkretisht, nëse një subjekt rivlerësimi do të justifikonte kryerjen e shpenzimeve pas vitit 2016, me të ardhura të padeklaruara apo të pretenduara të akumuluar deri në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit, do të ishte e arsyeshme analiza nga Komisioni ose Kolegji, në kushtet kur krijohet dyshimi për deklaratim të pasaktë dhe të pavërtetë në deklaratën e rivlerësimit⁵².

45. Në rrethanat konkrete, në vijim të arsyetimit si më sipër, trupi gjykues, duke gjetur të drejtë pretendimin e Komisioneres Publike dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e depozitave në Credins Bank, të deklaruara në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, të cilat kanë shërbyer si

⁵⁰ Përgjigjja e pyetjes nr. 2, të drejtuar nga Komisioni, në pyetësin nr. 3.

⁵¹ Paragrafi 30 i vendimit të Komisionit.

⁵² Vendimi i Kolegjit nr. 8/2021 (JR), datë 09.03.2021, paragrafi 26.3.

burim krijimi për pasurinë “apartament banimi me sipërfaqe 134,5 m², në Tiranë” dhe gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

46. Për sa i përket shkakut të ankimit, sipas së cilit, *për pasuritë “tokë bujqësore “arë”” në pronësi të personit të lidhur, rrethanat e konstatuara lidhur me këto pasuri e vendosin subjektin e rivlerësimit para një deklarimi të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe në kushtet e konfliktit të interesit, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konstatoi si vijon.*

46.1. Lidhur me verifikimin e burimit të krijimit të pasurive “tokë bujqësore “arë””, Komisioni, në vendim⁵³, ka konkluduar: *“Komisioni, në vlerësim të të gjithë provave dhe fakteve të analizuara, çmon se nuk lindin dyshime lidhur me çmimin e parashikuar në kontratën e shitjes, i cili rezulton më i ulët se ai i referencës. Së pari, nga hetimi nuk rezultuan indicie për konflikt interesi me shitësit e tokave. Së dyti, çmimi i referencës është vendosur si një çmim për efekt llogaritjeje tatimi, e provuar kjo si një praktikë e noteres. Së treti, ekzistenca e kunatit të subjektit si përfaqësues i pronarëve të tokës nuk mund të jetë një element që të çon në një deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, mbi të cilin mund të ngrihen dyshime për vlerën reale të saj. Kunati ka marrë prokurat respektive kohë më parë se të lidheshin kontratat e shitjes, me përjashtim të njëres prej tyre. Kjo pronë ka qenë e pazhvilluar, e pargjijstruar dhe nuk ka asnjë indicie që vlera reale e këtyre pronave nuk ka qenë sa ajo e shitjes, por ka qenë sa ajo e referencës fiskale apo edhe më shumë se referenca fiskale. Parashikimi i çmimit është dhënë në një kontratë, ku fuqia ligjore e saj është e bazuar ligjërish dhe nuk mund të vihet në diskutim si e tillë. Lidhur me konfliktin e interesit, shpjegimet e dhëna nga subjekti janë bindëse dhe mosdeklarimi i shkakut të dorëheqjes nuk përbën fshehje, pasi fakti nuk përbën një nga shkaqet për dorëheqje, duke pasur gjithashtu parasysh që vendimmarrja është shumë kohë më pas lidhjes së kontratës së shitjes, bazuar kjo në ligjin nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe në jurisprudencën e Kolegjit. Në përfundim, Komisioni çmon se këto pasuri janë deklaruar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me ligjin dhe subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e tyre”.*

46.2. Në kundërshtim të këtij konkluzioni të Komisionit, Komisionerja Publike, në argumentimin e shkakut të ankimit, sipas paragrafit 28 më sipër në këtë vendim, ka parashtruar se në të gjitha kontratat e shitblerjes, shitësit e këtyre pasurive të paluajtshme janë përfaqësuar nga bashkëshorti i motrës së subjektit të rivlerësimit, z. S. G.. Ky i fundit, me cilësinë e përfaqësuesit të palës shitëse, i ka shitur pasuritë te bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, disa prej të cilave vetëm disa ditë më pas nga data e aktit të përfaqësimit/prokurës së posaçme, me palën shitëse. Në prokurat e lëshuara me përfaqësues ligjor, z. S. G., specifikohet se shitësit kanë marrë vlerën e shitjes, por kjo vlerë nuk është referuar në dokument. Mbetet e paqartë sesi janë kryer këto transaksione, sepse nuk ka asnjë akt që të provojë këto pagesa. Komisioni nuk ka administruar asnjë akt për të provuar çmimin real të shitjes së tokave bujqësore tek z. G., i cili më vonë ia shiti bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Sipas Komisioneres Publike, Komisioni nuk duket të ketë administruar informacion nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për të verifikuar vlerën e këtyre pasurive pas shitjes. Në të gjitha kontratat e shitblerjes së këtyre pasurive të paluajtshme janë përcaktuar dy vlera, vlera e çmimit të referencës dhe vlera e blerjes/çmimi i paguar nga bashkëshorti i subjektit. Vlera totale e pasurive “tokë bujqësore

⁵³ Paragrafët 36.11-36.12 të vendimit të Komisionit.

“arë””, sipas çmimit minimal të referencës fiskale (mbi të cilin do të paguheshin tatimet), llogaritet në 6.367.356 lekë, ndërsa rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit i ka blerë këto pasuri në shumën 1.061.600 lekë, që është një çmim disa herë më i ulët se çmimi i referencës. Komisionerja Publike, referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni, si dhe bazuar dhe në Rekomandimin e ONM-së, vëren se nëse në analizën financiare të viteve kur janë blerë këto pasuri, do të përfshihej si investim çmimi i referencës i cituar në kontratat e shitblerjes së këtyre pasurive, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur do të rezultonin me mungesë burimesh të ligjshme për vitet 2010 dhe 2012 dhe, si pasojë, konkluzioni në lidhje me këto pasuri do të ishte i ndryshëm nga ai i arritur nga Komisioni në vendim. Sipas Komisioneres Publike, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e rivlerësimit dhe në deklaratat periodike të interesave ekzistencën e kësaj marrëdhënie të përdorimit të tokave bujqësore nga z. A. B., në formën e një interesi privat, si dhe nuk rezulton as të jenë deklaruar shpenzime/investime apo të ardhura të realizuara lidhur me këto pasuri, ndërkohë që referuar deklarimeve të vetë subjektit, duket se janë krijuar të ardhura, më së paku, në natyrë, për subjektin dhe personin e lidhur.

46.3. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, gjatë gjykimit në Kolegj, duke i qëndruar shkakut të ankimit të Komisioneres Publike me parashtrimet, konfirmoi argumentet e përdorura në ankim, lidhur me pasuritë objekt kontrolli.

46.4. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare gjatë gjykimit në Kolegj, mbajti të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit administrativ në Komision, duke prapësuar shkakun e ankimit, në mënyrë të përmbledhur, si vijon. Çmimet e ndryshme të pasqyruara në kontratat e shitblerjes së këtyre pasurive vijnë si rezultat i procedurës së noterit, pasi sipas Udhëzimit nr. 9/2008, i ndryshuar, të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë, kishte detyrimin të vinte palët në dijeni të çmimit të referencës, mbi të cilin do të paguheshin tatimet dhe ta pasqyronin këtë çmim në kontratë. Pagesa është kryer sipas çmimit real të përcaktuar në kontratë dhe jo sipas çmimit të referencës. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nuk ka pasur asnjë arsye për të fshehur apo deklaruar një çmim të ndryshëm për këto toka bujqësore, pasi ky ka qenë çmimi i dakordësuar midis palëve. Të gjitha procedurat e regjistrimit, përfshirë dhe pagesën e detyrimeve tatimore janë paguar nga personi i lidhur, fakt që ka ndikuar në çmimin e blerjes. Ekzistenca e bashkëshortit të motrës si përfaqësues i pronarëve të tokës nuk mund të jetë një element që të çon në një deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për këto pasuri, mbi të cilin mund të ngrihen dyshime për vlerën reale të tyre. Kunati i subjektit të rivlerësimit ka marrë prokurat respektive kohë më parë se të lidheshin kontratat e shitjes me përjashtim të njëjës prej tyre. Tokat kanë qenë të pazhvilluara, të paregjistruara dhe nuk ka asnjë indicie se vlera reale e tyre nuk ka qenë sa ajo e shitjes, por ka qenë sa ajo e referencës fiskale apo edhe më shumë. Parashikimi i çmimit është dhënë në një kontratë të bazuar ligjërisht dhe nuk mund të vihet në diskutim si e tillë. Sipas subjektit të rivlerësimit, edhe aktualisht, interesi për të blerë toka të ngjashme vazhdon të jetë shumë i ulët dhe në mënyrë të vazhdueshme, me vendimet përkatëse, Këshilli i Ministrave ka ulur çmimin e referencës në këtë zonë. Në ndryshim nga sa ka pretenduar Komisionerja Publike, Komisioni ka administruar prova se në këto prona nuk është investuar në asnjë lloj forme, nuk ka plan zhvillimor, si dhe janë administruar fotografi të pronave që vërtetojnë se janë toka të painvestuara. Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka administruar dokumentacion që provon se z. A. B. është i regjistruar si person fizik, me objekt të ushtrimit të aktivitetit për prodhim dhe shumëzim fidanësh hardhie dhe prodhim dhe tregtim me pakicë të verës dhe rakisë. Vetë z. A. B., nëpërmjet një deklarate

noteriale, ka konfirmuar se nga mbjellja me hardhi e parcelave, që i janë dhënë në përdorim nga personi i lidhur, i jep këtij të fundit 10% të verës që prodhohet. Sipas subjektit të rivlerësimit, këto fakte dëshmojnë se nga bashkëshorti i saj nuk është kryer investim në këto toka bujqësore, si dhe nuk janë deklaruar të ardhura nga kjo marrëdhënie, për shkak se nuk ka të tilla, pasi vera që përfitohet përdoret vetëm për konsum personal dhe jo biznes. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nuk ka pasur detyrim për të deklaruar dhënien në përdorim të këtyre pasurive z. A. B., për sa kohë nuk ka përfituar të ardhura dhe në deklaratën e rivlerësimit nuk ka asnjë seksion ku të deklarohet një fakt i tillë, e megjithatë ajo ka sqaruar këtë marrëdhënie kur është pyetur nga Komisioni, për shkak të vlerësimit të maksimal për procesin e rivlerësimit.

46.5. Për të provuar këto pretendime, gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit paraqiti aktet e administruara në seancën gjyqësore të datës 13.03.2025, të analizuara në vijim.

46.5.1. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 187, datë 06.03.2013, “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë”, sipas së cilit çmimi i referencës për tokën bujqësore në fshatin {***}, Vlorë, nga 406,6 lekë/m² i përcaktuar me vendimin nr. 139, datë 13.02.2008 është ulur në 390 lekë/m²;

46.5.2. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 30.07.2014, “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë”, sipas së cilit çmimi i referencës për tokën bujqësore në fshatin {***}, Vlorë, është ulur në 281 lekë/m²;

46.5.3. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 03.02.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas së cilit çmimi i referencës për tokën bujqësore në fshatin {***}, Vlorë, është ulur në 204 lekë/m²;

46.5.4. Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.02.2025 dhe deklarë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.02.2025, e deklaruesve L. dhe F. Xh., të cilët kanë deklaruar se në vitet 2009 dhe 2011 i kanë shitur z. S. G., tokat “arë” me sipërfaqe 2.500 m² dhe 4.300 m² në fshatin {***}, Vlorë. Meqenëse tokat ishin të paregjistruara dhe ata nuk ishin pajisur me certifikatë pronësie, kanë rënë dakord që z. G. të nënshkruante në emër të tyre dhe ata t’i shisnin parcelat e tokës për çmimin 50 lekë/m², duke mos paguar asnjë detyrim për regjistrimin dhe as pagesën e tatimit. Sipas deklaruesve, që në momentin e nënshkrimit të prokurës, paratë për tokën e shitur ua ka dhënë z. S. G..

46.5.5. Të njëjtën përmbajtje kanë edhe deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.02.2025, e deklaruesve M. dhe A. Xh. dhe deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.02.2025, e deklaruesve H. dhe A. H., të cilët konfirmojnë se i kanë shitur në vitet 2009 dhe 2012, në të njëjtat kushte, z. G., përkatësisht tokën arë me sipërfaqe 1.000 m² dhe 4.560 m², në fshatin {***}, Vlorë.

46.5.6. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe kartelat e pasurive “tokë bujqësore “arë””, për të provuar se mbi këto pasuri nuk është kryer asnjë investim, për sa kohë nga këto kartela rezulton se nuk ka ndërtesa.

46.6. Në konkluzionet përfundimtare, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme theksoi se subjekti i rivlerësimit edhe gjatë gjykimit në Kolegj nuk arriti të shpjegojë bindshëm arsyen e blerjes së këtyre tokave me çmim disa herë më të ulët se çmimi i referencës fiskale. Vlera totale e pasurive “tokë bujqësore “arë””, sipas çmimit minimal të referencës fiskale rezulton në vlerën 6.367.356 lekë, ndërsa bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit i ka blerë këto pasuri në vlerën 1.061.600 lekë. Sipas Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti gjatë

gjykimit në Kolegj akte noteriale të kohës apo transaksionet financiare për të provuar sa ka qenë çmimi i blerjes së këtyre tokave nga kunati i saj në vitet respektive. Deklaratat noteriale të disa prej shitësve janë hartuar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe, për këtë arsye, duhen marrë me rezervë për sa deklarohej në to. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti shpjegime bindëse se përse kunati i saj në cilësinë e përfaqësuesit të palës shitëse i ka shitur këto pasuri të bashkëshortit i subjektit, një prej të cilave vetëm një ditë pas hartimit të aktit të përfaqësimit me palën shitëse. Sipas Drejtuesit të Prokurorisë, referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni, nëse në analizën financiare të viteve kur janë blerë këto pasuri, do të përfshihej si investim çmimi i referencës i cituar në kontratat e shitblerjes, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur do të rezultojnë me mungesë burimesh të ligjshme për vitin 2010, në vlerën (-) 2.265.425 lekë dhe në vitin 2012, në vlerën (-) 3.001.912 lekë. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti akte për të provuar sa është vlera e investimit/shpenzimit për krijimin e vreshtarisë në tre prej këtyre tokave bujqësore dhe nga kush është kryer ky investim, duke mbetur në nivel deklarativ pretendimi i saj se ky investim është kryer nga z. A. B.. Sipas Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e rivlerësimit dhe në deklaratat periodike të interesave ekzistencën e marrëdhënies së përdorimit të këtyre pasurive nga z. A. B., në formën e një interesi privat, si dhe shpenzimet/investimet apo të ardhurat e realizuara lidhur me këto pasuri, për sa kohë, duket se janë krijuar të ardhura më së paku në natyrë, duke u ndodhur kështu në kushtet e një deklarimi të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 33, shkronja 5, pika “a” e ligjit nr. 84/2016.

47. Në analizë të shkakut të ankimit të Komisioneres Publike dhe pretendimeve të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, trupi gjykues vëren se nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, situata faktike, lidhur me krijimin e këtyre pasurive, paraqitet si vijon.

47.1. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar:

*“Tokë bujqësore, sipërfaqe 4.560 m², në {***}, Vlorë, blerë me kontratën nr. {***}/{***}, datë 16.04.2012. Burimi i krijimit: Kursime. Vlera: 273.600 lekë. Pjesa takuese 100%.*

*Tokë bujqësore, sipërfaqe 4.300 m², në {***}, Vlorë, blerë me kontratën nr. {***}/{***}, datë 16.04.2012. Burimi i krijimit: Kursime. Vlera: 258.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.*

*Tokë bujqësore sipërfaqe 1.000 m², në {***}, Vlorë, blerë me kontratën nr. {***}/{***}, datë 16.03.2010. Burimi i krijimit: Me të ardhura të kursyera. Vlera: 60.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.*

*Tokë bujqësore, sipërfaqe 3.200 m², në {***}, Vlorë, blerë me kontratën nr. {***}/{***}, datë 17.03.2010. Burimi i krijimit: Me të ardhura të kursyera. Vlera: 320.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.*

*Tokë bujqësore, sipërfaqe 2.500 m², në {***}, Vlorë, blerë me kontratën nr. {***}/{***}, datë 16.03.2010. Burimi i krijimit: Me të ardhura të kursyera. Vlera: 150.000 lekë. Pjesa takuese 100%”.*

47.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit dhe nga dokumentacioni i administruar nga ILDKPKI-ja⁵⁴ si rezultat i hetimit të zhvilluar nga ky organ për efekt të procesit të rivlerësimit, për secilën prej pasurive të sipërcituara, rezultoi të jenë kryer veprimet juridike, në rend kronologjik, si vijon.

47.2.1. Për pasurinë “tokë bujqësore me sipërfaqe 4.560 m², ndodhur në {***}, Vlorë”:

⁵⁴ Sipas informacionit të përcjellë në ILDKPKI nga ZVRPP-ja Vlorë, me shkresën nr. {***} prot., datë 04.01.2017.

Origjina e kësaj pasurie rrjedh nga AMTP nr. {***}, datë 25.10.1993, sipas së cilit z. H. H., nga fshati {***}, në cilësinë e kryefamiljarit, ndër të tjera, ka përfituar edhe 4.560 m² tokë bujqësore në {***}.

Në datën 06.12.2010, z. H. H. dhe z. E. H., me anë të prokurës së posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.12.2010, kanë emëruar si përfaqësues të tyre ligjor, z. S. G., duke i dhënë të drejtë: të paraqitet pranë çdo institucioni shtetëror për të kërkuar dokumente që lidhen me pasurinë deri në marrjen e certifikatës së pronësisë për pasurinë tokë arë me sipërfaqe 4.560 m²; të marrë certifikatën e pronësisë; të paraqitet pranë zyrës noteriale për të firmosur në emër dhe për llogari të tyre kontratën e shitblerjes së pasurisë; dhe të ndjekë në vazhdimësi regjistrimin e pasurisë në emër të blerësit të ardhshëm.

Në këtë prokurë, të përfaqësuarit deklarojnë se nuk kanë asnjë të drejtë mbi pasurinë e sipërcituar, pasi kanë marrë prej z. S. G. edhe vlerën e shitjes.

Pasuria është regjistruar në ZVRPP-në Vlorë më datë 20.01.2011 dhe më datë 05.05.2011, në emër të bashkëpronarëve H. dhe E. H. është lëshuar certifikata për vërtetim pronësie për pasurinë tokë arë me sipërfaqe 4.560 m².

Referuar të dhënave të kartelës së pasurisë në rubrikën “Përshkrim i veçantë”, për këtë pasuri, është bërë rivlerësimi në vlerën 1.894.756 lekë, i konfirmuar më datë 16.02.2012.

Më datë 16.04.2012, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, me kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.04.2012, ka blerë nga z. H. dhe z. E. H., të përfaqësuar nga z. S. G., pasurinë “tokë arë me sipërfaqe 4.560 m², në {***}, Vlorë”. Në paragrafin e kontratës me emërtim “Çmimi dhe Likuidimi” parashikohet se: *Palët kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së kësaj sipërfaqe toke arë të jetë 1.894.756 lekë (çmimi nga rivlerësimi për efekt tatimi). Pala blerëse, z. B. V., në marrëveshje të plotë me palën shitëse e ka blerë këtë sipërfaqe tokë arë, me vlerën prej 273.600 lekësh. Likuidimin e shumës së mësipërme, palët në kontratë e kanë realizuar jashtë zyrës noteriale.*

Sipas formularit “Pasqyrë llogaritëse e tatimit për kalimin e së drejtës së pronësisë” të ZVRPP-së Vlorë, aplikuesi B. V. ka aplikuar për regjistrimin e pronësisë mbi pasurinë tokë arë me sipërfaqe 4.560 m², me aplikimin nr. {***}, datë 10.05.2011. Në këtë formular rezultojnë të jenë plotësuar rubrikat si vijon.

Vlera e kontratës aktuale të shitjes 1.894.756 lekë; vlera në shitje e pasurisë (sipas udhëzimit nr. 9, datë 26.02.2008 ndryshuar me udhëzimin nr. 21, datë 26.02.2009) 1.854.096 lekë; rivlerësimi 1.894.756 lekë; tatimi për t’u paguar 0 (zero) lekë.

47.2.2. Për pasurinë “tokë bujqësore me sipërfaqe 4.300 m², ndodhur në {***}, Vlorë”:

Origjina e kësaj pasurie rrjedh nga AMTP nr. {***}, datë 25.10.1993, sipas së cilit z. L. Xh., nga fshati {***}, në cilësinë e kryefamiljarit ka përfituar, ndër të tjera, 4.300 m² tokë arë.

Në datën 26.01.2011, z. L. Xh., znj. F. Xh., znj. A. Xh. dhe z. H. Xh., me anë të prokurës së posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.01.2011, kanë emëruar si përfaqësues të tyre ligjor, z. S. G., duke i dhënë të njëjtat të drejta si ato të pasqyruara në deklaratën noteriale të analizuar në paragrafin 47.2.1. këtij vendimi. Në këtë prokurë, të përfaqësuarit deklarojnë se nuk kanë asnjë të drejtë mbi pasurinë e sipërcituar, pasi kanë marrë prej z. S. G. edhe vlerën e shitjes.

Pasuria është regjistruar në ZVRPP-në Vlorë më datë 23.03.2011 dhe më datë 04.05.2011, në emër të familjes L. Xh., është lëshuar certifikata për vërtetim pronësie për pasurinë arë me sipërfaqe 4.300 m². Referuar të dhënave të kartelës së pasurisë në rubrikën “Përshkrim i veçantë”, për këtë pasuri, është bërë rivlerësimi në vlerën 1.748.380 lekë, i konfirmuar më datë 16.02.2012.

Më datë 16.04.2012, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. B. V., me kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.04.2012, ka blerë nga L., F., A. dhe H. Xh., të përfaqësuar nga z. S. G., pasurinë tokë arë me sipërfaqe 4.300 m², në {***}, Vlorë. Në paragrafin e kontratës me emërtim “Çmimi dhe Likuidimi” parashikohet se: *Palët në kontratë kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së kësaj sipërfaqe toke arë të jetë 1.748.380 lekë (çmimi nga rivlerësimi për efekt tatimi). Sipërfaqja që shitet është 4.300 m². Pala blerëse z. B. V., në marrëveshje të plotë me palën shitëse e ka blerë këtë sipërfaqe tokë arë, me vlerën prej 258.000 lekësh. Likuidimin e shumës së mësipërme, palët në kontratë e kanë realizuar jashtë zyrës noteriale.*

Sipas formularit “Pasqyrë llogaritëse e tatimit për kalimin e së drejtës së pronësisë” të ZVRPP-së Vlorë, aplikuesi B. V. ka aplikuar për regjistrimin e pronësisë mbi pasurinë tokë arë me sipërfaqe 4.300 m², me aplikimin nr. {***}, datë 10.05.2011. Në këtë formular rezultojnë të jenë plotësuar rubrikat si vijon.

Vlera e kontratës aktuale të shitjes 1.748.380 lekë; vlera në shitje e pasurisë (sipas udhëzimit nr. 9, datë 26.02.2008 ndryshuar me udhëzimin nr. 21, datë 26.02.2009) 1.748.380 lekë; rivlerësimi 1.748.380 lekë; tatimi për t’u paguar 0 (zero) lekë.

47.2.3. Për pasurinë “tokë bujqësore me sipërfaqe 1.000 m², ndodhur në {***}, Vlorë”:

Origjina e kësaj pasurie rrjedh nga AMTP nr. {***}, datë 25.10.1993, sipas të cilit z. M. Xh., nga fshati {***}, në cilësinë e kryefamiljarit ka përfitur 1.000 m² tokë arë.

Në datën 12.10.2009, z. M. Xh., znj. A. Xh., znj. L. Xh., me anë të prokurës së posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12. 10.2009, kanë emëruar si përfaqësues të tyre ligjor, z. S. G., duke i dhënë të njëjtat të drejta si ato të pasqyruara në deklaratën noteriale të analizuar më sipër në këtë vendim. Në këtë prokurë, të përfaqësuarit deklarojnë se nuk kanë asnjë të drejtë mbi pasurinë e sipërcituar, pasi kanë marrë prej z. S. G. edhe vlerën e shitjes.

Pasuria është regjistruar në ZVRPP-në Vlorë më datë 04.03.2010 dhe më datë 15.03.2010, në emër të familjes M. Xh., është lëshuar certifikata për vërtetim pronësie për pasurinë arë me sipërfaqe 1.000 m².

Më datë 16.03.2010, bashkëshorti i subjektit, z. B. V., me kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.03.2010, ka blerë nga z. M. Xh., znj. A. Xh., znj. L. Xh., të përfaqësuar nga z. S. G., pasurinë tokë arë me sipërfaqe 1.000 m², në {***}, Vlorë. Në paragrafin e kontratës me emërtim “Çmimi dhe Likuidimi” parashikohet se: *Palët në kontratë kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së kësaj sipërfaqe toke arë të jetë vetëm për efekt tatimi 406.600 lekë. Pala blerëse z. B. V. e ka blerë këtë sipërfaqe tokë arë, me vlerën 60.000 lekë. Likuidimin e shumës së mësipërme, palët në kontratë e kanë realizuar jashtë zyrës [...] noteriale.*

Sipas formularit “Pasqyrë llogaritëse e tatimit për kalimin e së drejtës së pronësisë” të ZVRPP-së Vlorë, aplikuesi B. V. ka aplikuar për regjistrimin e pronësisë mbi pasurinë tokë arë me sipërfaqe 1.000 m², me aplikimin nr. {***}, datë 09.04.2010. Në këtë formular rezultojnë të jenë plotësuar rubrikat si vijon.

Vlera e kontratës aktuale të shitjes 406.600 lekë; vlera në blerje e pasurisë 141.000 lekë; tatimi për t’u paguar 26.560 lekë.

47.2.4. Për pasurinë “tokë bujqësore me sipërfaqe 3.200 m², ndodhur në {***}, Vlorë”:

Me prokurat e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.03.2010; nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.03.2010 dhe nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.03.2010, anëtarët e familjes Xh. kanë emëruar si përfaqësues të posaçëm ligjor z. S. G., duke i dhënë të njëjtat të drejta si ato të pasqyruara në deklaratën noteriale të analizuar në paragrafin 47.2.1. të këtij vendimi, si dhe të ndjekë në vazhdimësi regjistrimin e pasurisë në emrin e blerësit të ardhshëm

z. B. V. dhe të paguajë detyrimet ligjore që u takojnë për këtë qëllim. Në këto prokura anëtarët e familjes Xh. deklarojnë se nuk kanë asnjë të drejtë mbi pasurinë e sipërcituar, pasi kanë marrë prej z. S. G. edhe vlerën e shitjes për sipërfaqen prej 3.200 m².

Pasuria është regjistruar në ZVRPP-në Vlorë më datë 04.03.2010 dhe më datë 15.03.2010, në emër të familjes F. Xh., është lëshuar certifikata për vërtetim pronësie për pasurinë arë me sipërfaqe 3.200 m².

Më datë 17.03.2010, bashkëshorti i subjektit, z. B. V., me kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.03.2010, ka blerë nga F., Xh., S. dhe G. Xh., të përfaqësuar nga z. S. G., pasurinë tokë arë me sipërfaqe 3.200 m², në {***}, Vlorë. Në paragrafin e kontratës me emërtim “Çmimi dhe Likuidimi” parashikohet se: *Palët në kontratë kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së kësaj sipërfaqe toke arë vetëm për efekt tatimi të jetë 1.301.120 lekë. Pala blerëse z. B. V. e ka blerë këtë sipërfaqe tokë arë, me vlerën 320.000 lekë. Likuidimin e shumës së mësipërme, palët në kontratë e kanë realizuar jashtë zyrës [...] noteriale.*

Sipas formularit “Pasqyrë llogaritëse e tatimit për kalimin e së drejtës së pronësisë” të ZVRPP-së Vlorë, aplikuesi B. V. ka aplikuar për regjistrimin e pronësisë mbi pasurinë tokë arë me sipërfaqe 3.200 m², me aplikimin nr. {***}, datë 09.04.2010. Në këtë formular rezultojnë të jenë plotësuar rubrikat si vijon.

Vlera e kontratës aktuale të shitjes 1.301.120 lekë; vlera në blerje e pasurisë 451.200 lekë; tatimi për t’u paguar 84.992 lekë.

47.2.5. Për pasurinë “tokë bujqësore me sipërfaqe 2,500 m², ndodhur në {***}, Vlorë”:

Në datën 12.10.2009, L., F., A. dhe H. Xh., me anë të prokurës së posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.10.2009, kanë emëruar si përfaqësues të tyre ligjor, z. S. G., duke i dhënë të njëjtat të drejta si ato të pasqyruara në deklaratën noteriale të analizuar në paragrafin 47.2.1. të këtij vendimi. Në këtë prokurë të përfaqësuarit deklarojnë se nuk kanë asnjë të drejtë mbi pasurinë e sipërcituar, pasi kanë marrë prej z. S. G. edhe vlerën e shitjes.

Pasuria është regjistruar në ZVRPP-në Vlorë më datë 04.03.2010 dhe më datë 15.03.2010, në emër të familjes L. Xh., është lëshuar certifikata për vërtetim pronësie për pasurinë arë me sipërfaqe 2.500 m².

Më datë 16.03.2010, bashkëshorti i subjektit, z. B. V., me kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.03.2010, ka blerë nga z. L. Xh., znj. F. Xh., znj. A. Xh. dhe z. H. Xh., të përfaqësuar nga z. S. G., pasurinë tokë arë me sipërfaqe 2.500 m², në {***}, Vlorë. Në paragrafin e kontratës me emërtim “Çmimi dhe Likuidimi” parashikohet se: *Palët në kontratë kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së kësaj sipërfaqe toke arë të jetë vetëm për efekt tatimi 1.016.500 lekë. Pala blerëse z. B. V. e ka blerë këtë sipërfaqe tokë arë, me vlerën 150.000 lekë. Likuidimin e shumës së mësipërme prej 150.000 lekë, palët në kontratë e kanë realizuar jashtë zyrës [...] noteriale.*

Sipas formularit “Pasqyrë llogaritëse e tatimit për kalimin e së drejtës së pronësisë” të ZVRPP-së Vlorë, aplikuesi B. V. ka aplikuar për regjistrimin e pronësisë mbi pasurinë tokë arë me sipërfaqe 2.500 m², me aplikimin datë 09.04.2010. Në këtë formular rezultojnë të jenë plotësuar rubrikat si vijon.

Vlera në shitje e pasurisë 1.016.500 lekë; vlera në blerje e pasurisë 352.500 lekë; tatimi për t’u paguar 66.400 lekë.

47.3. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur:

47.3.1. Mandatarkëtimet bankare për shumat e paguara si detyrim tatimor për kalimin e së drejtës së pronësisë, për sipërfaqet e pasurive “tokë arë” të blera nga personi i lidhur, sipas

kontratave përkatëse të shitblerjes, nga rezultoi se vlerat e tatimit përkatës janë paguar nga z. B. V. dhe nga znj. Mirela Mishgjoni;

47.3.2. Deklaratë personale e noteres publike S. H., datë 06.05.2023, e cila deklaroi se ka hartuar kontratat noteriale nëpërmjet të cilave z. B. V. ka blerë tokat bujqësore në fshatin {***}, Vlorë. Noterja deklaroi se: “[...] vlera e blerjes për secilën prej këtyre pasurive është ajo e përcaktuar në kontratë. Në kohën e përpilimit të kontratave ka qenë në fuqi Udhëzimi nr. 9, datë 26.02.2008, i Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Drejtësisë “Për tatimin e kalimit të pronësisë së pasurisë së paluajtshme”, i ndryshuar, me udhëzimin nr. 21, datë 26.02.2009. Sipas këtij udhëzimi, [...], palët viheshin në dijeni për çmimin e referencës në atë zonë dhe zyra noteriale kishte detyrim që në kontratë të pasqyronte çmimin fiskal. [...] Kjo praktikë është ndjekur në kontratat e shitblerjes ku vlera e transaksionit ishte më e vogël se çmimi i referencës së zonës. Edhe në këtë rast, sqaroj se është zbatuar Udhëzimi nr. 9, datë 26.02.2008 [...], duke përcaktuar si vlerën reale të shitjes ashtu edhe çmimin minimal fiskal, si në të gjitha rastet e tjera, në të kundërt sipas nenit 11 të udhëzimit [...], zyra noteriale do të penalizohej administrativisht. Në zbatim të këtij udhëzimi është vepruar deri në shfuqizimin e tij. Deklaroj se në kontratat e mësipërme ku shtetasi B. V. ka cilësinë e blerësit, nuk ka abuzim me çmimet por referuar sa më sipër, në këto kontrata janë vendosur si çmimet reale të shitjes ashtu dhe çmimet minimale fiskale të përcaktuar në Udhëzimin nr. 9, datë 26.02.2008, i ndryshuar” .

Bashkëlidhur deklaratës, noteri ka vënë në dispozicion pesë kontrata shitblerje pasurie të paluajtshme, në të cilat përcaktohet çmimi për efekt fiskal dhe çmimi real i shitjes më i ulët se çmimi i referencës së zonës.

47.3.3. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.07.2023, e z. A. B., i cili ka deklaruar se z. B. V. bleu disa parcela të vogla dhe duke qenë se nuk mund të zhvillonte vetë aktivitetin e vreshtarisë ranë dakord që një pjesë të tokave të blera prej tij, ato në kufi me pronat e poseduara prej z. B., të cilat janë në total 6.700 m² t’ia jepte në përdorim për t’i mbjellë me rrush dhe në çdo sezon të vjeljes së rrushit e prodhimit të verës në mirëbesim t’i jepte 10% të gjithë sasisë së verës, mesatarisht 100 litra, të cilat i ka përdorur për konsum familjar. Sipas deklaruesit, investimi për mbjelljen e vreshtave, vjelljen e rrushit e të gjitha shërbimet që kryhen për këtë bimë janë financimi i tij nga të ardhurat që siguron nga shitja e rrushit e nënprodukteve të tij.

Sipas ekstraktit historik nga regjistri tregtar, për të dhënat e person fizik “A. B.”, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, rezultoi se ai është regjistruar në datën 19.12.2007, me fushë veprimtarie: “Prodhim, riprodhim dhe shumëzim të materialeve mbjellëse bimore (fidanë hardhie). Prodhim dhe tregtim me pakicë të verës dhe rakisë”.

47.3.4. Në përgjigje të kërkesës për informacion të drejtuar nga Komisioni, Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr. {***} prot., datë 12.03.2021, ka përcjellë listën e veprimeve noteriale të kryera, ndër të tjerë, edhe nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, referuar të dhënave të Regjistrat Noterial Shqiptar. Nga verifikimi i të dhënave të veprimeve noteriale të listuara në këtë regjistër, nuk evidentohen veprime të kryera mes z. B. V. dhe z. A. B..

48. Në analizë të pretendimeve të Komisioneres Publike dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, si dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, referuar situatës faktike të pasqyruar më sipër në këtë vendim, trupi gjykues vëren se z. S. G., kunati i subjektit të rivlerësimit, ka lidhur prokurë përfaqësimi me disa shtetas/anëtarë të familjes bujqësore, në të cilat ai autorizohej për lidhjen e kontratave të shitjes së pasurive të paluajtshme “tokë arë” në pronësi të tyre, gjithsej

pesë pasuri, me sipërfaqe të ndryshme, të ndodhura në fshatin {***}, Vlorë. Më tej, z. G. i ka shitur këto pasuri te bashkëshorti i subjektit, me anë të kontratave përkatëse të shitblerjes. Në secilën nga prokurat e lëshuara nga anëtarët e familjeve bujqësore për përfaqësuesin ligjor z. S. G. përcaktohet se pala shitëse nuk ka asnjë të drejtë mbi pasurinë për të cilën i kanë dhënë të drejtat përkatëse përfaqësuesit të tyre, pasi kanë marrë prej z. S. G. edhe vlerën e shitjes për sipërfaqen e tokës “arë”. Ky përcaktim është bërë edhe në prokurën e përfaqësimit të pasurisë “tokë arë” me sipërfaqe 3.200 m², në të cilin pala e përfaqësuar ka identifikuar apo cilësuar se cili do të ishte blerësi i ardhshëm, konkretisht z. B. V.. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, rezulton se pasuritë “tokë arë”, në momentin e lëshimit të prokurave të përfaqësimit, nuk kanë qenë të regjistruara në ZVRPP-në Vlorë, në emër të anëtarëve të familjeve bujqësore përkatëse. Në secilën prej prokurave të përfaqësimit, një nga tagrat e lëna z. G. në cilësinë e përfaqësuesit ishte paraqitja pranë çdo institucioni shtetëror për të kërkuar dokumente që lidhen me pasurinë deri në marrjen e certifikatës së pronësisë, si dhe marrja e certifikatës së pronësisë e, më tej, nënshkrimi i kontratës së shitjes e deri te kujdesia për regjistrimin e pasurisë në emër të blerësit. Në këto kushte, mes pronarëve të pasurive dhe z. G. nuk mund të lidhej një kontratë shitje për pasuritë në fjalë. E megjithatë në prokurat përkatëse të përfaqësimit të përfaqësuarit theksojnë se nuk kanë asnjë të drejtë mbi pasuritë “tokë arë”, pasi kanë marrë prej z. S. G. edhe vlerën e shitjes. Pavarësisht këtij fakti, në secilën prej prokurave të përfaqësimit nuk cilësohet se sa është çmimi që z. G. u ka paguar pronarëve të pasurive e, për pasojë, trupi gjykues çmoi se nëse ky është akti i vetëm që provon investimin e kryer prej tij, duke paguar çmimin e shitjes, ky çmim më së paku duhet të figuronte në këto akte. Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, edhe pse është pyetur në mënyrë specifike nga Komisioni⁵⁵, nuk ka depozituar asnjë akt, për të provuar çmimin real të shitjes së tokave bujqësore nga pronarët e tyre/anëtarët e familjes bujqësore përkatëse te z. G., i cili më vonë ia shiti bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

48.1. Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit paraqiti deklaratat noteriale të palëve të përfaqësuar në prokurat e përfaqësimit të lidhura me z. S. G., të hartuara në shkurt të vitit 2025, për efekt të zhvillimit të gjykimit të çështjes në Kolegj, në të cilat ata kanë deklaruar se meqenëse tokat ishin të paregjistruara dhe nuk ishin pajisur me certifikatë pronësie, kanë rënë dakord që z. G. të nënshkruante në emër të tyre dhe ata t'i shisnin parcelat e tokës për çmimin 50 lekë/m², duke mos paguar asnjë detyrim për regjistrimin dhe as pagesën e tatimit. Sipas deklaruesve, që në momentin e nënshkrimit të prokurës, paratë për tokën e shitur ua ka dhënë z. S. G.. Trupi gjykues, referuar jurisprudencës së Kolegjit⁵⁶, arsyetoi se deklaratat noteriale të tilla merren me rezervë në këtë proces, pasi janë kryer, jo vetëm për shkak të procesit të rivlerësimit, por edhe në një fazë të shtyrë të tij gjatë gjykimit në apel, çka krijon bindjen se janë konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit. Marrja me rezervë e deklaratave noteriale përforcohet sidomos kur nuk mbështeten nga prova të tjera të administruara në procesin e rivlerësimit.

48.2. Sa i përket faktit të ekzistencës në kontratat e shitblerjes së pasurive të paluajtshme të dy çmimeve të shitjes: çmimit të referencës dhe çmimit real të shitjes, deklaruar ky i fundit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, trupi gjykues vëren se gjatë hetimit administrativ, subjekti

⁵⁵ Në pyetësin nr. 3, në kërkesën nr. 6, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit: “Të na informoni se sa ka paguar bashkëshorti i motrës tuaj për blerjen e këtyre pasurive”.

⁵⁶ Vendimi nr. 6/2018 (JR), datë 12.09.2018; vendimi nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019; vendimi nr. 34/2019 (JR), datë 02.12.2019; vendimi nr. 29/2020 (JR), datë 09.11.2020; etj.

i rivlerësimit ka depozituar deklaratën personale të noteres publike S. H., datë 06.05.2023, e cila deklaroi se ka hartuar kontratat noteriale nëpërmjet të cilave bashkëshorti i subjektit ka blerë tokat bujqësore në fshatin {***}, Vlorë. Noterja publike ka deklaruar se vendosja në kontratë edhe e çmimit minimal fiskal të përcaktuar për zonën në të cilën ndodhej prona ka qenë një praktikë e ndjekur në kontratat e shitblerjes, ku vlera e transaksionit ishte më e vogël se çmimi i referencës së zonës, në të kundërt zyra noteriale do të penalizohej administrativisht. Në vijim të deklaratës, noterja ka paraqitur kontrata të lidhura nga individë me objekt shitblerje e pasurisë së paluajtshme, të redaktuara prej saj në të njëjtën periudhë kohore me kontratat e lidhura nga z. B. V., për blerjen e pasurive tokë “arë” në {***}, në të cilat rezultoi se çmimi i shitjes është më i ulët se çmimi i referencës dhe në kontratë janë vendosur të dy çmimet.

Në verifikim të këtij deklarimi të noteres, vërehet se në kohën e lidhjes së kontratave të shitblerjes mes pronarëve të pasurive tokë arë, përfaqësuar nga z. G. dhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, ka qenë në fuqi Udhëzimi nr. 9, datë 26.02.2008, i Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë “Për tatimin e kalimit të pronësisë së pasurisë së paluajtshme”, i ndryshuar, i cili në pikën 11 parashikonte se: “11. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për njohjen zyrtare të zyrave noteriale me këtë udhëzim, lidhur me respektimin e zbatimit të çmimeve minimale fiskale të përcaktuara. Mosrespektimi i çmimeve në kontratat e noterizuara të shitjeve të pasurisë së paluajtshme konsiderohen kundërvajtje administrative për zyrat e noterisë dhe penalizohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.”

Sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se me rëndësi për zgjidhjen e çështjes mbetet fakti se çmimi real i shitblerjes së pasurive, referuar vlerës së përcaktuar si të tillë në secilën prej kontratave, është shumë herë më i ulët se sa çmimi i referencës i përcaktuar nga autoritetet shtetërore. Konkretisht: referuar kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.03.2010, z. B. V. ka blerë pasurinë tokë arë me sipërfaqe 2.500 m², duke paguar çmimin prej 150.000 lekësh, ndërsa çmimi i shitjes së kësaj sipërfaqe “tokë arë” për efekt tatimi, i referuar në kontratë, ishte 1.016.500 lekë; referuar kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.03.2010, z. B. V. ka blerë pasurinë “tokë arë” me sipërfaqe 3.200 m², duke paguar çmimin prej 320.000 lekësh, ndërsa çmimi për efekt tatimi ishte 1.301.120 lekë; referuar kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.03.2010, çmimi i paguar nga z. B. V., për pasurinë “tokë arë” me sipërfaqe 1.000 m², ishte 60.000 lekë, ndërsa çmimi i shitjes për efekt tatimi ishte 406.600 lekë; referuar kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.04.2012, vlera e paguar nga z. B. V. për blerjen e pasurisë “tokë arë” me sipërfaqe 4.300 m², ishte 258.000 lekë, ndërsa çmimi i shitjes së kësaj sipërfaqe toke nga rivlerësimi ishte 1.748.380 lekë; referuar kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.04.2012, për pasurinë tokë arë me sipërfaqe 4.560 m², z. B. V. ka paguar çmimin prej 273.600 lekësh, ndërsa çmimi nga rivlerësimi për efekt tatimi ishte 1.894.756 lekë. Vlera e blerjes së këtyre pasurive nga z. B. V., sipas çmimit minimal fiskal do të ishte në shumën 6.367.356 lekë, ndërsa z. B.V. për blerjen e tyre ka paguar shumën prej 1.270.152 lekësh (duke përfshirë edhe totalin e detyrimeve tatimore të paguara në vlerën 209.152 lekë), e cila, gjithsesi, vlerësohet rreth pesë herë më e ulët sesa çmimi minimal fiskal për këto pasuri. Trupi gjykues vlerësoi se nëpërmjet prokurave të posaçme të lëshuara në emër të z. S. G. dhe kalimit të ky i fundit i gjithë të drejtave nga shitësit e këtyre pasurive, pa specifikuar çmimin e shitjes, është ndërtuar një mekanizëm shitjeje/blerjeje, i cili ka synuar përcaktimin e çmimeve fiktive në kontratat e shitblerjes së tyre nga personi i lidhur. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe: (i) vendosjen e një çmimi disa herë më të ulët se çmimi i referencës, përtej logjikës ekonomike për këto pasuri, i cili duket se ka pasur për qëllim mbulimin e mungesës së burimeve të ligjshme

të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për krijimin e tyre; si dhe (ii) dhënien në përdorim të këtyre pasurive “tokë arë” shtetasit A. B. për disa vite, për qëllime vreshtarie, përdorim i padeklaruar në deklaratat e interesave periodike private dhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, siç do të trajtohet më poshtë, në këtë vendim.

48.3. Në vijim të arsyetimit, në analizën financiare të kryer për këto pasuri, trupi gjykues, në ndryshim nga Komisioni, vlerën e tyre e përlllogariti referuar çmimit të referencës së tokës bujqësore “arë” në këtë zonë, në lekë/m² sipas legjislacionit në fuqi⁵⁷, çmim i referuar në kontratat përkatëse të shitjes së këtyre pasurive.

Në analizën financiare, duke mbajtur në konsideratë edhe arsyetimin dhe konkluzionin e arritur më sipër në këtë vendim, lidhur me të ardhurat e personit të lidhur nga aktiviteti si “ristorator” për periudhën 2005-2011, trupi gjykues, duke konsideruar vlerën e blerjes së pasurive “tokë arë” për vitin 2010 prej 2.724.220 lekësh, konfirmoi balancën negative të evidentuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në shumën (-) 2.265.425 lekë dhe për vitin 2012, duke konsideruar vlerën e blerjes së pasurive “tokë arë” prej 3.643.136 lekësh, konfirmoi balancën negative të evidentuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për këtë vit në shumën (-) 3.001.912 lekë. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme financiare për krijimin e këtyre pasurive, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

48.4. Nga verifikimi i të dhënave të veprimeve noteriale të listuara në Regjistrin Noterial Shqiptar, referuar të dhënave të përcjella nga Ministria e Drejtësisë në Komision, trupi gjykues vëren se nuk evidentohen veprime të kryera mes z. B. V. dhe z. A. B..

Z. A. B., në deklarin e tij para noterit publik, ka konfirmuar se ai ka në përdorim një pjesë të tokave “arë” në pronësi të z. B. V., për të zhvilluar aktivitetin e vreshtarisë, por nuk ka deklaruar kohën prej së cilës ai i ka në përdorim këto toka. Edhe subjekti i rivlerësimit, në deklarin e saj gjatë hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, nuk e ka saktësuar këtë moment. Nga hetimi administrativ i kryer në Komision, trupi gjykues konstatoi se: (i) z. A. B. është regjistruar si “Person Fizik”, me fushë veprimtarie “Prodhim, riprodhim dhe shumëzim të materialeve mbjellëse bimore (fidanë hardhie). Prodhim dhe tregtim me pakicë të verës dhe rakisë”, në datën 19.12.2007; (ii) tokat “arë” që i janë lënë në përdorim nga z. B. V., me sipërfaqe totale prej 6.700 m², janë në pronësi të këtij të fundit që nga muaji mars 2010; (iii) Ministria e Drejtësisë i ka përcjellë Komisionit veprimet noteriale të regjistruara në Regjistrin Noterial Shqiptar, duke filluar nga data 01.03.2013 e në vazhdim⁵⁸. Në vijim të këtyre fakteve, trupi gjykues vëren se periudha mars 2010 - mars 2013 mbetet e pambuluar me informacion nëse gjatë kësaj kohe, ashtu siç ka pretenduar edhe Komisionerja Publike në ankim, z. B. V. dhe z. A. B. mund të kenë lidhur ndonjë marrëveshje të shkruar me njëri-tjetrin, për përdorimin e tokave bujqësore nga z. B., me kundërshtpërbllim në para apo në natyrë dhe nëse është ky i fundit, në masën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit dhe z. B., në deklarin e dhëna gjatë hetimit në Komision, se në këmbim të pasurisë së lënë në përdorim,

⁵⁷ Çmimi i referencës për tokën bujqësore është përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 139, datë 13.02.2008, “Për miratimin e çmimeve të trojeve të përcaktuara në hartat përkatëse për qarqet e Fierit, të Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës”, për fshatin {***}, Vlorë, në vlerën 406,6 lekë/m², çmim ky i pandryshuar deri në vitin 2013, kur me miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 187, datë 06.03.2013, “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë”, çmimi u përcaktua në vlerën 390 lekë/m².

⁵⁸ Referuar shkresës së sipërcituar të Ministrisë së Drejtësisë, të dhënat e përcjella nga data 01.03.2013 lidhen me faktin se Regjistri Noterial Shqiptar është krijuar mbi bazën e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 304, datë 21.05.2014.

z. V. ka përfituar 10% të gjithë sasisë së verës së prodhuar në çdo sezon të vjeljes së rrushit e prodhimit të verës. Kjo marrëdhënie e krijuar ndërmjet z. V. dhe z. B., e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit dhe e konfirmuar nga z. B. si një marrëdhënie e paformalizuar me një kontratë të shkruar, në vlerësim të trupit gjykues, duket se plotëson kushtet e një marrëdhënie enfiteoze⁵⁹, në të cilën z. V. i ka dhënë në përdorim z. B. pasurinë e paluajtshme “tokë arë” në përdorim dhe ky i fundit e ka përmirësuar atë, pasi nga gjendja “djerrë” e ka mbjellë me vreshtari dhe në këmbim të përdorimit dhe përmirësimit të saj i jep z. V. një shpërblim periodik në natyrë, rreth 10% të sasisë vjetore të verës që prodhohet nga vreshtat. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të interesave, konstatohet se nga viti 2010, vit në të cilin personi i lidhur ka fituar pronësinë mbi tokat bujqësore me sipërfaqe totale prej 6.700 m² e në vijim, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar dhënien në përdorim të këtyre pasurive dhe as përfitimin e një shpërblimi në natyrë për këtë shkak. Një deklarami i tillë nuk është bërë as në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit. Në zbatim të nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, që referon në nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003, subjektet e rivlerësimit duhet të deklarojnë gjendjen e interesave private, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare që zotërojnë, deri në datën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit⁶⁰. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit duhet të pasqyrojë në deklaratën e rivlerësimit faktin e dhënies në përdorim të pasurive “tokë arë” z. A. B. nga bashkëshorti i saj, në zbatim të detyrimit të përcaktuar në nenin 4, shkronja “a” e ligjit nr. 9049/2003 dhe kërkesave të formularit të deklarimit sipas shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016⁶¹, sa i takon detyrimit për deklarami të të drejtave reale mbi pasuritë e paluajtshme. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i

⁵⁹ Sipas nenit 784 të Kodit Civil: “Enfiteoza është një kontratë, me të cilën një personi i jepet e drejta të përdorjë e të përmirësojë një pasuri të paluajtshme, kundrejt një shpërblimi periodik në të holla ose në natyrë”.

⁶⁰ Neni 4 i ligjit nr. 9049/2003 parashikon: “Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë:

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi 500.000 lekë;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;
- dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj;
- e) të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale;
- ë) licencat dhe patentat që sjellin të ardhura.
- f) dhuratat dhe trajtimet preferenciale, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale. Nuk deklarohen dhurata ose trajtim preferencial kur vlera e tyre është më e vogël se 10 000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe kur dy e më shumë dhurata ose trajtime preferenciale, të dhëna nga i njëjti person, së bashku, nuk e kalojnë këtë vlerë, gjatë së njëjtës periudhë deklarimi;
- g) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, përfshirë çdo lloj të ardhure, të krijuar nga kjo veprimtari ose ky angazhim;
- gj) interesa private të subjektit, që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga marrëdhëniet familjare apo të bashkëjetesës;
- h) çdo shpenzim i deklarueshëm, me vlerë mbi 500 000 (pesëqind mijë) lekë, i kryer gjatë vitit të deklarimit.

Interesat private të llojeve të tjera nga ato të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji mund të kërkojnë të deklarohen periodikisht, nëse kjo është e mundur dhe e përshatshme për nënlojë interesash brenda këtyre llojeve, të përcaktuara me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm”.

⁶¹ Formulari i deklarimit të pasurisë së rivlerësimit, në rubrikën “Deklarimi i pasurive”, ka si objekt deklarimi: Të gjitha pasuritë e akumuluar ndërmjet vite deri në datën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas nenit 3, pika 11 të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur.

rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting* për mosdeklarimin e faktit të përdorimit të këtyre pasurive nga z. A. B., në kundërshtim të parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

49. Komisionerja Publike, në ankim, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni, ka vlerësuar se *shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me konfliktin e interesit nuk janë bindëse, pasi mosreferimi në kërkesën e dorëheqjes të rrethanave të plota, lidhur me marrëdhënien me karakter pasuror mes shitësve të pasurive “tokë arë” dhe bashkëshortit të saj, më së paku, pamundëson vlerësimin e drejtë të titullarit, mbi situatën e mundshme të konfliktit të interesit.* Ky qëndrim i Komisioneres Publike u konfirmua edhe nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrimet dhe në konkluzionet përfundimtare.

49.1. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, kundërshtoi si të pabazuar pretendimin e mësipërm të Komisioneres Publike dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, duke parashtruar të njëjtat argumente si gjatë hetimit administrativ në Komision. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se me vendimin nr. {***}, datë 01.12.2018, ka gjykuar kërkesën e z. H. H. kundër z. A. (E.) H., me objekt: Lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes. Në datën 29.11.2018, datë në të cilën i është caktuar kjo çështje për gjykim, ka deklaruar dorëheqjen, e cila, me vendimin e datës 30.11.2018, nuk është pranuar nga kryetari i gjykatës. Kërkesa i është caktuar për gjykim në një ditë pushimi dhe sipas ligjit kjo kërkesë duhej gjykuar brenda 48 orëve. Po kështu, edhe në datën 01.12.2018, datë në të cilën ka shqyrtuar kërkesën, përsëri ka qenë ditë pushimi. Të dy palët ndërgjyqëse në këtë gjykim kanë qenë në cilësinë e shitësve në kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.04.2012. Pavarësisht këtij fakti, subjekti e ka gjykuar çështjen me paanësi dhe vendimi është i formës së prerë. Gjykimi i çështjes është zhvilluar disa vite pasi kushtet e marrëdhënies së interesit ishin vendosur jashtë çdo ndikimi të mundshëm të ndonjë interesi të subjektit. Rrethanat e përshkruara nuk mund të konsiderohen si shkaqe të rëndësishme njëanshmërie, në kuptim të nenit 72 të Kodit të Procedurës Penale, që do të sillnin detyrimin e saj për të hequr dorë nga shqyrtimi i çështjes gjyqësore dhe një qëndrim i tillë është mbajtur edhe në jurisprudencën e Kolegjit. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë në vëmendje të Kolegjit se edhe në rastin e gjykimit prej saj të kërkesës së shoqërisë “{***}” ShPK, me objekt lëshimin e urdhër ekzekutimit për kontratë kredie bankare, datë 07.12.2018, të lidhur ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK dhe z. S. Xh., pavarësisht se në kërkesën për dorëheqje ka përmendur faktin e marrëdhënies së shitblerjes mes z. Xh. dhe bashkëshortit të saj, dorëheqja nuk është pranuar nga kryetari i gjykatës, duke mos u konsideruar si një nga shkaqet e dorëheqjes së parashikuar në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile.

49.2. Nga hetimi administrativ i kryer në Komision, trupi gjykues konstatoi rrethanat faktike si vijon.

49.2.1. Sipas të dhënave të shkresës nr. {***} prot., datë 21.07.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me lëndë: “Kthim përgjigje”, drejtuar subjektit të rivlerësimit, nga verifikimi i kryer në sistemin ICMIS dhe në zyrën e arkivës së kësaj gjykate, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar çështje me shtetasit H. H. dhe S. Xh..

Referuar akteve të dosjes gjyqësore që i përket çështjes për të cilën subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendimin nr. {***}, datë 01.12.2018, me paditës H. H. dhe i paditur E. H., subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesën për dorëheqje nga çështja, në datën 29.11.2018. Në këtë kërkesë, subjekti ka argumentuar se *çështja nuk duhet të gjykohet nga ana e saj (seksioni familjar), por duhet të gjykohet nga të gjithë gjyqtarët e juridiksionit të përgjithshëm të shkallës*

së parë dhe duhet t'i nënshtrohen shortit elektronik. Me vendimin e datës 30.11.2018, Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka disponuar për mospranimin e kërkesës për dorëheqje të subjektit të rivlerësimit.

Referuar akteve të dosjes gjyqësore që i përket çështjes për të cilën subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendimin nr. {***}, datë 06.12.2021, me kërkesë shoqërinë “{***}” ShPK dhe objekt lëshim urdhër ekzekutimi, subjekti i rivlerësimit, në datën 22.11.2021, ka paraqitur kërkesën për dorëheqje nga çështja, duke parashtruar si arsye faktin se me kredimarrësin S. Xh., bashkëshorti i saj ka lidhur një kontratë shitblerje në vitin 2010. Me vendimin e datës 02.12.2021, Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka disponuar për mospranimin e kërkesës për dorëheqje.

50. Trupi gjykues analizoi pretendimet e Komisioneres Publike dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, si dhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit, në raport me konkluzionet e Komisionit, referuar fakteve të provuara gjatë hetimit dhe zbatimit të parashikimeve ligjore lidhur me to. Trupi gjykues vlerësoi se marrëdhënia e interesit mes bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe z. H. H. dhe z. E. H., së cilës i referohet Komisionerja Publike dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, që ka lindur si pasojë e veprimit juridik të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme “tokë bujqësore arë”, me anë të kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.04.2012, është një marrëdhënie e cila i ka dhënë efektet e saj dhe ka përfunduar në datën 10.05.2012, me regjistrimin e pronësisë mbi pasurinë “tokë bujqësore arë”, me sipërfaqe 4.560 m² në emër të z. B. V.. Nga hetimi i Komisionit, nuk rezultoi të ketë lindur ndonjë mosmarrëveshje mes palëve pjesëmarrëse në këtë kontratë shitblerjeje, e cila të ishte prezente në kohën e përfshirjes së subjektit të rivlerësimit në gjykimin në dhjetor 2018 të çështjes gjyqësore me objekt: “Lëshimin e urdhrit të mbrojtjes” dhe, si e tillë, nuk përmbush kriteret për ta vendosur subjektin e rivlerësimit në kushtet e parashikimit ligjor të ekzistencës së rrethanave konkrete, sipas së cilave vërtetohen arsye serioze njëanshmërie, rast ky për të cilin subjekti i rivlerësimit do duhej të deklaronte heqjen dorë nga gjykimi i çështjes, sipas përcaktimit të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile⁶². Për rrjedhojë, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisionerja Publike dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, trupi gjykues vlerësoi se gjykimi i kësaj çështjeje nga subjekti i rivlerësimit nuk është kryer në situatë konflikti interesi dhe ajo nuk ka pasur detyrim ligjor për të hequr dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, në kuadër të parashikimeve të dispozitës së sipërcituar të Kodit të Procedurës Civile dhe, për pasojë, as të cilësonte faktin e pjesëmarrjes së bashkëshortit të saj në kontratën e sipërcituar, në arsyet e paraqitjes së kërkesës për dorëheqje nga gjykimi i kësaj çështjeje në datën 29.11.2018.
51. Në përmbledhje të gjithë arsyetimit të mësipërm, lidhur me pasuritë “tokë bujqësore “arë”” në pronësi të personit të lidhur, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, duke mos deklaruar dhënien në përdorim të pasurive nga personi i lidhur, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e të njëjtit ligj.

⁶² Neni 72 i Kodit të Procedurës Civile, “Rastet e përjashtimit të gjyqtarit”, parashikon në pikën 1 se gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje kur: “Ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë gjykim”; dhe pika 6: “Në çdo rast tjetër kur vërtetohen sipas rrethanave konkrete arsye serioze njëanshmërie”.

52. Lidhur me pretendimin e Komisioneres Publike se *Komisioni nuk ka administruar akte të tjera në drejtim të vlerësimit të aktivitetit të një organizate jofitimprurëse, në të cilën bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit është në cilësinë e anëtarit themelues*, trupi gjykues konstatoi dhe analizoi si vijon.

52.1. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, aktet e administruara në dosjen e procesit të rivlerësimit, paraqesin situatën faktike, si më poshtë.

52.1.1. Në përgjigje të kërkesës për informacion të drejtuar nga Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 12.03.2021, Ministria e Drejtësisë ka përcjellë listën e veprimeve noteriale të kryera, ndër të tjerë, edhe nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, referuar të dhënave të Regjistrat Noterial Shqiptar.

52.1.2. Në vijim, noterja publike J. B., me shkresë të datës 02.08.2023, ka vënë në dispozicion të Komisionit: (a) vërtetim nënshkrimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.10.2013, të aktit të themelimit të shoqatës “{***}” (Për zhvillim kulturor, ekonomik dhe social) (në vijim shoqata “{***}”); (b) vërtetim nënshkrimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.01.2014, të vendimit të Asamblesë të shoqatës “{***}”. Një ndër shtetasit nënshkrues të këtyre akteve ishte dhe bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit B. V..

52.1.3. Komisioni ka vijuar hetimin, duke i kërkuar informacion Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm të Shkallës së Parë Tiranë, e cila, me shkresë nr. {***} prot., datë 17.10.2023, ka vënë në dispozicion dokumentacionin e kësaj shoqate, regjistruar me vendimin gjyqësor nr. {***}, datë 23.01.2014.

Referuar Aktit të Themelimit dhe Statutit të shoqatës “{***}”, me seli në Vlorë, qëllimi i aktivitetit të saj është: formimi i rinisë në universitete; barazia gjinore; zhvillimi i cilësisë në sistemin arsimor shkencor; sensibilizim, rehabilitim, integrim i fëmijëve dhe familjeve në nevojë për çështje të ndryshme sociale dhe arsimore; sensibilizim, riintegrim i komunitetit jo shumicë: romë, ashkali, egjiptianë, në jetën arsimore, edukative, shëndetësore dhe sociale; përmirësimi mjedisor si një e drejtë njerëzore; rritja e kapaciteteve në zëjtari dhe agro-kulturë; ruajtja e traditës shqiptare, në veçanti ajo e rajonit të jugut.

Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit është një nga anëtarët themelues të shoqatës, si dhe anëtar i Bordit Drejtues të saj. Drejtor ekzekutiv i shoqatës është znj. E. G., motra e subjektit të rivlerësimit.

52.1.4. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të kërkesave të drejtuara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ⁶³, ka shpjeguar: *Bashkëshorti nuk ka përfutur asnjë të ardhur nga “{***}”, shoqatë pa qëllim fitimi, pasi kjo shoqatë nuk ka zhvilluar asnjëherë aktivitet në kuadër të krijimit të saj. Fakt është që kjo shoqatë nuk është regjistruar në Administratën tatimore, nuk është pajisur me NIPT, sipas legjislacionit në fuqi, nuk ka ushtruar aktivitet e, për rrjedhojë, nuk ka krijuar të ardhura. Në bazë të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, është i detyrueshëm deklarimi i angazhimeve në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, vetëm nëse këto angazhime kanë sjellë të ardhura për subjektin, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en dhe fëmijët madhorë. Në rastin konkret, kjo shoqatë nuk është regjistruar në*

⁶³ Komisioni, në pyetësin nr. 7, i ka drejtuar subjektit të rivlerësimit, pyetjet: A ka përfutur të ardhura nga pjesëmarrja në Bordin e kësaj shoqate bashkëshorti juaj? Cila është arsyeja që nuk e keni deklaruar pjesëmarrjen e bashkëshortit tuaj në këtë organizatë jofitimprurëse në deklaratën e rivlerësimit, por edhe në deklaratat periodike?

administratën tatimore, nuk ka ushtruar aktivitet, nuk ka krijuar të ardhura dhe për këtë shkak kjo pjesëmarrje nuk është deklaruar në deklaratën e rivlerësimit apo në deklarimet periodike. Për të provuar deklarimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision:

52.1.5. Shkresë nr. {***} prot., datë 17.11.2023, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, me lëndë: “Kthim përgjigje”, drejtuar znj. E. G., sipas së cilës: *Nga të dhënat e sistemit C@TS, subjekti organizatë jofitimprurëse me emërtimin “{***}” nuk rezulton i regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë.*

52.1.6. Printim nga regjistri i organizatave jofitimprurëse që kanë regjistruar të dhënat e tyre në Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, nga i cili rezulton se shoqata “{***}” nuk rezulton e regjistruar në bazën e të dhënave të organizatave që veprojnë në Qarkun e Vlorës.

52.2. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni, pasi ka referuar hetimet e kryera, ka arritur në përfundimin se nuk rezultuan problematika në lidhje me procesin e rivlerësimit, për sa u konstatua nga hetimi.

52.3. Në ankim, Komisionerja Publike ka pretenduar se Komisioni nuk ka administruar akte të tjera, veç atyre të sipërcituara, në drejtim të vlerësimit të aktivitetit të shoqatës në fjalë. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime, konfirmoi qëndrimin e Komisioneres Publike në ankim, ndërsa në konkluzionet përfundimtare parashtroi se në përfundim të shqyrtimit gjyqësor nuk u provua që personi i lidhur të ketë realizuar të ardhura apo përfitime nga të qenit anëtar themelues i shoqatës “{***}”, për rrjedhojë nuk u evidentuan rrethana të tilla që do të ndikonin në procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

52.4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, nuk paraqiti argumente të tjera nga ato të parashtruara gjatë hetimit administrativ në Komision, duke pretenduar se shkak i ankimit është i paqartë dhe duket se është një konstatim deklarativ lidhur me veprimet e Komisionit, i pashoqëruar me një kërkesë konkrete.

52.5. Në analizë të pretendimit të Komisioneres Publike, në raport me rrethanat faktike si më sipërcituar, si dhe në vijim të qëndrimit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, trupi gjykues vëren se: (i) ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, nuk parashikon ndalesë për anëtarësimin apo qenien në pozicion drejtues në një organizatë jofitimprurëse të personit të lidhur me magjistratin; (ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar dhe as nuk ka pretenduar se ka përfituar të ardhura nga anëtarësimi i bashkëshortit të saj në shoqatën “{***}”; (iii) subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision, ka provuar se shoqata “{***}” nuk është regjistruar në organet tatimore dhe nuk provohet të ketë realizuar të ardhura, për pasojë nuk u provua që personi i lidhur si anëtar i Bordit Drejtues të kësaj shoqate të ketë përfituar të ardhura, për shkak të këtij pozicioni; (iv) në ndryshim nga sa ka konstatuar Komisionerja Publike, Komisioni ka administruar të dhëna lidhur me aktivitetin e shoqatës “{***}”. Në vlerësim të rrethanave të mësipërme, trupi gjykues arriti në përfundimin se është i drejtë konkluzioni i arritur prej Komisionit se nga rrethanat faktike të rezultuara nga hetimi administrativ nuk u gjtën problematika që të afektojnë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

53. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, të arritura nga analiza dhe vlerësimi për secilën pasuri, trupi gjykues, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, arriti në përfundimin se

subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, duke u gjendur në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

54. Trupi gjykues, në bazë të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është e pabesueshme për kriterin e vlerësimit të pasurisë e, për pasojë, gjendet e papërshtatshme për të vijuar detyrën. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmoi se vendimi nr. 754, datë 05.04.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i pabazuar në prova dhe në ligj dhe duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 754, datë 05.04.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Mishgjoni.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot më datë 03.04.2025.

ANËTAR	ANËTARE	ANËTARE
Sokol ÇOMO	Rezarta SCHUETZ	Mimoza TASI
<i>nënshkrimi</i>	<i>nënshkrimi</i>	<i>nënshkrimi</i>
 RELATORE		 KRYESUESE
Albana SHTYLLA		Natasha MULAJ
<i>nënshkrimi</i>		<i>nënshkrimi</i>